

Parlament Zaevi relativizon protagonizimin e Selës

Fq.3



RAPORTI I AVOKATIT TË POPULLIT

Gjykatat selektive

Fq.5



"IBRA GALAXY"


7 vende dhe 9 klube në 19 vite karrierë

Fq.21



Koha

www.koha.mk



Cila është e ardhmja e Rusisë?

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3330 · e premte 30 mars, 2018

4°C | 18°C

15 DEN

EDITORIAL

Gotat e derdhura të rajonit



Problemet e rajonit nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë të izoluar. Kjo u dëshmuar edhe para 19 viteve kur ndodhi eksodi biblik i popullatës kosovare, si pasojë e akteve hakmarrëse të forcave serbe pas bombardimeve të NATO-s. Alarmi për një llahtari ishte dhënë në gjithë botën. UÇK me forcat e saja të shpërndara anë e kënd Kosovës, nuk po mundte t'iu përgjigjej të gjitha kërkesave për ndihmë...

Fq.2

RAJON

Rrezik nga sulmet terroriste për Pashkë

Fq.12

GLOBI


Facebook mund t'i paguaj britanikëve 625 miliardë paund

Fq.13



SHKELJE FLAGRANTE NË RASTIN E VOGËLUSHIT ALMIRALIU

EDHE ZOJA PA LICENCË!



№	Emri dhe Prezimi/Nazimi në shtetësi	Adresa, telefonin dhe adresën elektronike të kontaktimit	Oblasta e licencimit	№ dhe datë e miratimit të licencës	Zabëllime
1	Zora Babinkostova	Vil. ACHIM (br.4-1/22) Gjorge, tel: 076/481-302 email: zbabinkostova@yahoo.com	Povungarije	07-3353/1, 20.12.2011	Sid 23.03.2010 se odzneni Licencata za veshat-ome na Zora Babinkostova vo period od 3 godini согласно Решение за одзнене на Лиценца за вешат-оме и Присуде од Регистрат, донесен од Министер за правда.

Në vend se të pranojë gabimin pas skandalit me mungesën e Licencës për ekspertizë të neuropsikiatrit Stefanovski, por edhe psikiatres Babinkostova, Prokuroria në përgjigjen drejtuar gazetës KOHA thotë se "Licencën për ekspertizë e ka Klinika universitare për psikiatri dhe ajo është relevante...", megjithëse ekspertizën ndaj vrasësit Boban Iliq e ka kryer vetë Stefanovski dhe Babinkostova

Fq.4

Ka hapësirë për rritje të tregtisë elektronike

Shkup, 29 mars - Bizneset në Maqedoni që ofrojnë shërbimet dhe prodhimet e tyre, duhet të rrisin dhe përmirësojnë ofertën për blerësit, duke u orientuar të shesin jo vetëm brenda por edhe jashtë kufijve të Maqedonisë. Shteti, nga ana tjetër, nevojitet që të krijojë lehtësime të mëtejshme dhe të eliminojë barrierat e ndryshme siç është vendosja e paypal (kartelë kredituese online) për pagesat direkte jashtë shtetit

etj. Sipas Shoqatës së Tregtisë elektronike të Maqedonisë, Maqedonia më mirë qëndron në raport me shtetet e tjera të rajonit duke u renditur në vendin e tretë lidhur me tregtinë elektronike, pas Kroacisë dhe Sllovenisë. Megjithatë me realizimin prej 105 milion euro të tregtisë elektronike ngecim mjaft pas shteteve evropiane. Bile edhe kësaj shume jo të vogël të tregtisë përmes internetit më shumë...

Fq.7



EDITORIAL

GOTAT E
DERDHURA
TË RAJONIT

Emin AZEMI

Problemet e rajonit nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë të izoluar. Kjo u dëshmuar edhe para 19 viteve kur ndodhi ekzodi bibliki i popullatës kosovare, si pasojë e akteve hakmarrëse të forcave serbe pas bombardimeve të NATO-s. Alarmi për një llahtari ishte dhënë në gjithë botën. UÇK me forcat e saja të shpërndara anë e kënd Kosovës, nuk po mundte t'iu përgjigjej të gjitha kërkesave për ndihmë. Shumë fëmijë, pleq e gra asnjëherë më parë nuk kishin menduar se një ditë do të duhej të merrni shpejt e shpejt pak gjëra, për të ikur kah sytë këmbët. Çdo vonesë mund t'iu kushton-te me jetë. Zaten, kjo ishte periudha kur në Kosovë u kryen masakrat dhe shëmtitë më makabre të forcave paramilitare serbe. Vaji i atyre që shihnin nga afër këto tmerre, këputej nga breshëria e automatikëve. Ata që arrinin të shpëtonin, quheshin me fat. Ish-te fat i madh Tetova, Shkup, Kërçova, Dibra, Gostivari ishin mbushur e stërmeshur me të ardhur të shumtë nga Kosova. Të dëbuarit kosovarë, që po i iknin shfarosjes serbe, në viset shqiptare në Maqedoni kishin gjetur mikpritjen e veçantë. Atyre iu kishin lehtësuar dhembjet aq shumë, sa që këtë mikpritje dhe humanitet të rrallë nuk do ta harrojnë kurrnjëherë.

Në Tetovë patën ardhur qindra intelektualë, studentë, shkollarë, bujq, por edhe të tjerë, të cilët njoftuan për golgotat e tyre shumë të mëdha gjatë udhëtimit të stërmundimshëm nga Kosova për në Maqedoni. Në mesin e tyre ndodhej edhe shkrimtari i shquar, Ramiz Kelmendi, i cili pat botuar disa shkrime në të cilat atë botë përshkruante mallin për Prishtinën dhe fatin e atyre që kishin ngelur ende në Kosovë. Shtypi raportonte për të ardhur të tjerë nga rajonet e Kaçanikut, ku ditëve të fundit ishin vra mbi 40 shqiptarë. Gjendje shumë e rëndë raportohej veçmas në fshatrat Ivajë, Kottlinë, Doganaj, Koxhaj, Duraj, Gabrricë, Stagovë, Gërllicë e Epërme, pastaj Rakaj i Ferizajt, Greme, Gaçkë. Nëpër këto vendbanimet nuk kishte mbetur njeri. Dëshmitarët okularë rrëfenin për shtëpitë e mbetura shkret, të plaçkitura dhe të djegurat barbarisht nga terroristët serbë. Ata flitnin gjithashtu edhe për masakra masive serbe mbi disa rajone të Kosovës. Në fshatin Kottlinë, barbaria serbe më 24 mars kishin masakruar 22 persona civilë shqiptarë. Këta së pari i kishin rrahur me shufra hekuri dhe i kishin gozhduar në kokë, e pastaj të masakruar mizorisht i kishin futur në një bunar të fshatit Kottlinë. Ndërkohë, banorët e këtushëm kishte afër një muaj që kishin braktisur vatrën e tyre, dhe ishin vendosur përkohësisht në Shkup, Tetovë dhe në vendbanimet tjera të Pollogut e Sharrit, por me shpresë të vazhdueshme se shumë shpejt ata do të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre. Bashkë me të ikurit nga Kosova, ato ditë të vështira, në Maqedoni kishin ardhur edhe disa gazetarë të huaj, të cilët raportonin mbi atë çka po ndodhte. Tetova dhe Shkup i ishin bërë epiqendra të këtyre operimeve profesionale gazetareske. Shumë prej ishin të interesuar që të shkojnë në Kosovë dhe të raportojnë për aktualitetin tepër tragjik atje.

Mikpritja e njerëzve tanë ishte treguesi më i mirë se ky popull kishte ardhmëri dhe askush, madje as ata që po mbillnin vdekje anë e kënd Kosovës, nuk do të mund të shkullnin nga zemra atdhedashurinë për këtë atdhe të robëruar.

Gazetaria e atyre ditëve dramatike ishte e mbarsur me barrën e rëndë të përgjegjësisë, sepse nga ajo varej se si dhe sa do të mund të alarmohej bota. Për fatin tonë të mirë, kjo gazetari atëherë ishte shumë mobile dhe e liruar nga çfarëdo ndikimi politik. Raportimi dhe informimi i drejt, i shpejt dhe i paanshëm ishte bërë kodeksi i vetëm i punës profesionale. Kjo kishte bërë që Ballkani, si fuqi baruti, të ngelë një gotë ujë që patjetër e kishte të derdhej nga lëkundjet dhe tronditjet që sillte koha.

MESAZH DREJTUAR SHQIPTARËVE TË KOSOVËS

"Së pari, e përgëzoj Policinë e Kosovës për shkathtësinë e saj profesionale që arriti të arrestojë kriminelin Gjuriç dhe ta sjellë atë në Prishtinë. Por unë nuk e kuptoj përse e kthyen në Serbi. Është dashur ta mbanin në burg të paktën një javë. Së dyti, kam një thirrje drejtuar Parlamentit të Kosovës:

Lista Serbe bëri shumë mirë që doli nga Parlamenti i Kosovës. Aty nuk ka vend për ta. Tani keni një rast të volitshëm për të mos i lejuar që të kthehen. Ata janë terroristë dhe nuk janë aty për të mirën e Kosovës. Ata janë kanceri i Kosovës dhe tani që janë larguar, le të kthehen në Serbi te shtëpitë e tyre. Ata janë dërguar në Parlamentin e Kosovës nga mentorët e tyre terroristë, Vuçiç-Putin. Janë dërguar për t'i futur kancerin Kosovës. Nuk kanë vend aty. Sa më shpejt që ta largohen, aq më mirë. Merreni me mend sikur ne, bijtë e viteve 60-70, të shkonim në Tiranë për t'u këshilluar me Enver Hoxhën, a thua se do të dilnim nga burgju ndonjëherë? Kurse këta terroristë serbë shkojnë dhe këshillohen me Vuçiçin dhe Putinin në Beograd. Marrin këshillat e tyre të veprimit dhe kthehen në Parlamentin e Kosovës. T'u besosh atyre dhe t'i mbash në Parlament është veçse çmenduri. Së treti, ftoj krerët e të gjitha partive politike të Kosovës që të bashkohen e të veprojnë së bashku. Nuk është koha për përçarje e për lakmi pushteti. Rusia dhe Serbia ju kanë shpallur luftë. Duhet që edhe ju të vini këtu në Washington për këshillime me vendin tuaj mik. Por terroristët e Listës Serbe mos i lejoni më aty. Përqafime vëllazërore", ka shkruar në profiling etij në Facebook, veterani i "Zëerit të Amerikës", gazetari Shaqir Salihu.

NGACMUESIT SEKSUAL JANË GJITHANDEJ

"Megjithatë, para se të flasim për fenomenin e ngacmimeve seksuale në UP, besoj se duhet të flasim për fenomenin e ngacmimeve seksuale kudo në shoqërinë tonë. Dhe ndryshe nga shoqëritë perëndimore, ku viktima mund të jenë edhe meshkujt, në shoqërinë tonë lirisht mund të themi se viktimitave të këtij terrori pothuajse gjithmonë janë vajzat dhe gratë. Ato dalin në rrugë dhe ngacmohen seksualisht. Shtrëngohen fort që të përballen me një armatë burrash e djemsh të frustruar seksualisht që ngacmojnë vajza e gra kudo në rrugë. Me taksistët. Me kamarierët. Me nënpunësit administrativë në banka, sportele pagesash. Me kondukerët. Me pensionistët që enden shesheve. Me të gjithë dhe s'po e them vetëm që të bëj sa më shumë prej tyre, por se jam dëshmitar që ngacmuesit seksual janë gjithandej, madje edhe në mesin e disa njerëzve që njoh vet. Por këtu nuk mbaron tragjedia. Një grua mund të përballojë një ditë të tillë. Tragjedia mbaron me konkretizimin e aktit seksual nga një ngacmues që është i veshur me pushtet. Pra një burrë që e kushtëzon një grua me favore seksuale. Për shembull, siç bëjnë disa profesorë në UP, të cilët i kushtëzojnë studentet me favore seksuale për t'i kaluar në provim, ose për t'i bërë asistente, ose thjesht për t'u dhënë atyre një status social në mesin e studentëve tjerë, duke kaluar kohë me to. Por kjo praktikë e favoreve seksuale nuk është vetëm karakteristikë e UP-së. E shohim edhe në institucionet më të larta. Thënë thjesht, shpesh në vendin tonë që një grua të ngjitet majave të karrierës duhet të ofroj seks për t'i kaluar disa pengesa që mund t'i paraqiten gjatë rrugës. Këtë ia zë për të madhe disa prej feministëve të rrjeteve sociale, të cilët këto viktima të shfrytëzimit seksual na i paraqesin si storie suksesi, si gra shembull, kur në të vërtetë ato janë vetëm viktima të agresionit seksual mashkullor", ka shkruar në profiling e saj në Facebook, gazetaria nga Prishtina, Kaltrina Ademi.

MEDIACitate

"SERBIA
SHTIRET
SE ËSHTË
ME EUROPËN,
POR FLIRTON
ME RUSINË"

"Në Serbi mbretëron një situatë skizofrene, në një anë pohojmë se jemi në rrugë europiane e në tjetrën europiane e Vuçiç flet me Putinin e Rusicë dhe Llukashenkon e Bjellorusisë. Ne nuk jemi normalë. Këtu gjerat nuk mund të shpjegohen racionalisht. Presidenti i Rusicë me siguri ka të drejtë kur flet për raportet midis Moskës e Beogradit, meqë Serbia është jo vetëm partner kyç, por i vetmi partner i Rusicë në Europë. 65 për qind e shkëmbimit tregtar të Serbisë me jashtë bëhet me BE-në, 25 për qind me vendet e CEFTA-s që janë në rrugë për në BE, kurse shkëmbimet me Rusicë arrijnë maksimalisht 7 për qind. Investimet më të mëdha në Serbi vijnë nga Perëndimi dhe nga Japonia, por po t'i pyesësh qytetarët ata do të thonë se Rusia është donatori kryesor i Serbisë. Askujt nuk i intereson se cili është realiteti dhe ky realitet nuk përputhet me atë që mendojnë njerëzit dhe më atë që u servitet. Tashmë është e qartë SHBA-ja është përfshirë në dialogun mes Kosovës e Serbisë, ndërsa Serbia po përpiqet ta përfshijë edhe Rusicë, kështu që vetëmsa po e komplikon situatën dhe po i shtyn negociatat. Ne jemi të sëmurë. Nuk jemi normalë. Siç thotë, Millan Knezheviq "ne themi se uji është i terur ndërsa guri i butë".
(Kryeredaktori i të përjavshmes së Beogradit, NIN, dhe gazetari i njohur serb Millan Çulibërk, Televizioni N1)

NËSE NUK E
KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË KANUNI I MALEVE?

Kanuni i Maleve është variant i veçantë i normave të pashkruara të së drejtës zakonore të shqiptarëve, që ka vepruar në disa zona të tjera të Malësisë së Shqipërisë së Veriut, si në Shkrel, Kastrat, Hot, Kelmend, Grudë, Trepsh, Kuç e deri në Malësinë e Gjakovës, në Malësinë e Madhe, në fushën e Kosovës etj. Mbeturinat e

Kanunit të Maleve janë mbledhur nga tradita popullore, por nuk janë kodifikuar. Përgjithësisht Kanuni i Maleve ka norma të njëjta me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Mirëpo për shkak të zhvillimit të pabarabartë ekonomiko-shoqëror të krahinave ku vepron, ka edhe veçori lokale.

Për gjitha rastet në Maqedoni, sidomos për raste të këtilla, duke aluduar në "rastin e Almir Aliut", kryeministri Zaev tha se duhet të ketë vendime të qarta dhe transparente, për të cilat nuk duhet të ketë dyshime

DETAJE NGA PYETJET E DEPUTETËVE

ZAEVI RELATIVIZON PROTAGONIZIMIN E SELËS



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 29 mars - Të enjten gjatë një brifingu të zakonshëm mujor me gazetarë, Kryetari i Parlamentit Talat Xhaferi tha se nuk do të nënshkruaj dekretin në Ligjin për Gjuhët në vend të presidentit Gjorge Ivanov.

PO ANALIZOHEN OPSIONET PËR LIGJIN E GJUHËVE

"Presidenti ka obligim kushtetues ta nënshkruajë ligjin dhe për këtë unë nuk do të vendos nënshkrim në vend të tjetërkujt", tha Talata Xhaferi. Ai shtoi se Presidenti është i obliguar që ta nënshkruajë ligjin për gjuhët, për arsye se atë e kanë votuar për herë të dytë më shumë se gjysma e deputetëve. Megjithatë, kryeparlamentari Xhaferi tha se janë analizuar të gjitha opsionet për dalje nga situata aktuale, por pa dhënë detaje konkrete. Ai përmendi faktin se kushtetuat nuk jep afat tek Presidenti kur duhet ta nënshkruajë ligjin, ndonëse këtë e ka për obligim dhe detyrim kushtetues. Kryetari Xhaferi ishte optimist se opozita do të kthehet në seancë plenare dhe komisione deri në fund të javës së ardhshme, megjithëse sipas tij, Parlamenti ka kushte të punojë edhe pa ata, por pjesëmarrja e VMRO-së është e preferuar.

"Argumenti i VMRO-së lidhet me deputetët e paraburgosur për ngjarjet e 27 prillit. Gjykata Supreme javën e kaluar i liron nga burgu dhe iu shqiptoi masën e arrestit shtëpiak. Kjo nënkupton se ai argument është eliminuar dhe opozita nuk ka arsye tjetër për mospjesëmarrje në seanca", tha Talat Xhaferi.

RASTI I ALMIRIT NUK DUHET TË NA NDAJË POLITIKISHT E ETNIKISHT

Sipas traditës, në parlament të enjten pati edhe seancë të veçantë kushtuar pyetjeve të deputetëve. Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetit Fadil Zendeli për rikualifikimit të veprës penale për rastin e Almirit të vogël, kryeministri Zaev tha se ky rast nuk duhet të lejohet të ndikojë në ndarjet ndëretnike. "Nuk duhet të lejohet që rasti me Almirin të vogël të jetë arsye për ndarje politike, etnike ose çfarë do ndarje tjetër në shtet. Qeveria mbetet në qëndrimin se ven-

dimet gjyqësore janë të pavarura dhe se nuk dëshirojmë të ndërhyjmë në vendime të tilla. Është shumë e rëndësishme që me opinionin të ndahen të gjitha detajet. Gjitha palët e përfshira duhet të jenë të qarta, të zëshme dhe të kujdesshme, pasi dhimbja është e madhe tek të gjithë dhe besoj se për gjitha rastet në Maqedoni, sidomos për raste të këtilla duhet të ketë vendime të qarta dhe transparente, për të cilat nuk duhet të ketë dyshime", tha Zaev.

ZBARDHJA E "RASTI ALFAT", MPB NUK KA KOMPETENCA

Në seancën për pyetje të deputetëve që u mbajt pa prezencën e deputetëve të VMRO-së, kishte pyetja edhe për rastin "Alfa", nga deputeti tjetër i Lëvizjes BESA, Nexhmedin Kahremani. Ai pyeti ministrin e punëve të brendshme nëse do të punohet në drejtim të zbardhjes së këtij rasti meqë siç tha deputeti Nexhmedin Kahremani njeriu i pafajshëm qëndron

në burg. Në përgjigjen e tij ministri Oliver Spasovski tha se ministria që ai drejton nuk ka kompetencë por sipas tij nëse ka prova të reja me ato duhet të merret prokuroria.

"Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kompetencë në rastet e përfunduara gjyqësore por nëse ka prova me ato duhet të merret Prokurori publik kompetent. Nëse na kërkohet ne do të ndërmarrim masa plotësuese për këtë rast", tha Oliver Spasovski.

Në pyetjet tjera drejtuar kryeministrit Zoran Zaev deputeti i Aleancë për shqiptarët Syrija Rashidi pyeti se a apo punohet mjaftueshëm për reformat në gjyqësor dhe tjera nëse ka trajtim selektiv të rastit të 17 prillit në Parlament, kur sipas tij, etiketohet më shumë kryeministri e jo protagonistin kryesor i rrahjes deri në vdekje Ziadin Sela.

Fillimisht kryeministri Zoran Zaev relativizoi protagonizimin e Ziadin Selës se vetëm ai është rrahur por tha se ka qenë përveç atij edhe deputetë tjerë të LSDM-

së dhe BDI-së. Ndërkaq për reformat Kryeministri Zoran Zaev tha se është i kënaqur nga proceset për reforma të përgjithshme në vend, duke i përfshirë edhe reformat në gjyqësor duke qenë i bindur njëkohësisht se Maqedonia do të ketë gjyqësor të pavarur.

ZAEV SHPRESON NË GJYQËSOR TË PAVARUR

Duke u përgjigjur në pyetje të tjera në seancën për pyetje të deputetëve, kryeministri Zaev tha se në pjesën e gjyqësorit tashmë punojnë grupe punuese në reforma dhe shprehu bindje se do të krijojnë legjislacion serioz dhe do t'i implementojnë reformat në gjyqësor. "Jam i kënaqur se si nisën proceset në reformat e përgjithshme në Maqedoni. Do të bëjmë gjithçka dhe vazhdojmë të bëjmë gjithçka të kemi mirëkuptim të gjerë edhe për qëndrimet e opozitës, e cila jep shpresë dhe shansë se reformat janë në interes nacional. Jam i bindur se pjesëmarrja e

opozitës në dialogun për ligjet reformuese dhe mundësia për votim të opozitës për këto ligje do të jenë garancia më e mirë për implementim të suksesshëm të vendimeve ligjore", theksoi kryeministri Zoran Zaev.

Pyetje për Kryeministrin dhe ministrat kishte dhe deputeti rom Amdi Bajram, në lidhje më të se mungojnë furnizimet me barna në barnatore dhe punësimet e romëve në MPB. Amdi Bajram pyeti kryeministrin Zaevin se a ka menduar të punësojë këshilltar nga nacionaliteti rom në Kabinetin e tij. Nga ana tjetër Zaev u përgjigj se gjatë prillit ka ndërmend ta plotësoj vendin e zbrazur - Këshilltar për çështje rome.

"Unë njoh shumë rom kualitativ dhe besoj se do të motivohen dhe konkurrojnë. Shpresoj në kuadro kualitative, që të mundën romët të luftojnë për çështjet e tyre", u përgjigj Zaev. Në momentin që kryeministri vazhdoi të përgjigjet lidhur me mungesat e barnave Nënkyetari i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, Goran Misovski i ndërpreu fjalën Kryeministrit Zoran Zaev. "Në këtë pyetje u përgjigj ministri për shëndetësi dhe deputeti tha se është i kënaqur nga përgjigjja. Kërkoj ndjesë, por nuk mundemi ta shkelim rregulloren", ishte arsyetimi i nënkryetarit Goran Misovski. Zaev e ndërpreu fjalimin dhe u ulë në vendin e tij, që shkaktoi edhe reagim të deputetit Bajram, që shprehu edhe kënaqësi nga përgjigjja e kryeministrit dhe por jo edhe kënaqësi nga nënkryetari i Parlamentit për faktin që e ndërpreu atë.

SHÇERBAK: DËBIMI, HAP ARMIQËSOR I NDIKUAR NGA JASHTË

Vendimi i autoriteteve të Maqedonisë që të dëbojnë diplomat rus shkaktoi ndjenjë e keqardhjes. Ky vendim ka karakter të pabazë dhe është pa precedent për tërë historinë e marrëdhënieve mes Rusisë dhe Maqedonisë, deklaroi ambasadori rus Oleg Shçerbak pas vendimit të MPJ-së që të dëbojë diplomat rus. "Përfaqësuesit në Shkup vendosën ta ndër marrin këtë hap armiqësor në drejtim të shtetit tonë nën ndikim nga jashtë, por kjo nuk i liron autoritetet e Maqedonisë nga pasojat negative në lidhje me marrëdhëniet bilaterale", tha Shçerbak. Ai theksoi se ky vendim i përshpejtuar ndeshet me qëndrimet



zyrtare deklarative për zhvillim të raporteve konstruktive dhe të përbashkëta me Rusinë. Në lidhje me atë se çfarë hapa do të ndër marrë Rusia si përgjigje për dëbimin e diplomatit rus nga ana e Maqedonisë, Shçerbak tha se Rusia ka traditë të vjetër në diplomaci dhe se nuk ka traditë të shpejtojë në vendimet dhe hapat që do t'i ndër marrë. "Në diplomaci dëbimi i diplomatit është hap serioz dhe armiqësor dhe me kohë do ta kthejmë përgjigjen tonë. Por, kjo përgjigje do të jetë adekuate dhe mirë e paramenduar nga të gjitha anët", theksoi Shçerbak.

PYETJET E GAZETËS KOHA DËRGUARA NË PROKURORI

1. Pasi u konstatua se ekspertiza neuropsikiatrike e ekspertit ligjor Branislav Stefanovski nuk është valide, respektivisht i njëjti nuk disponon licencë përkatëse, a do të inicioni procedurë për përgjegjësi nga prokurorja Suzana Kusigerska, e cila ka qenë e obliguar të punojë në bazë të Ligjit dhe të prezantojë dëshmi valide ligjore, dhe jo kësilloj ekspertize të falsifikuara, me të cilën u liruara vrasësi?

2. Në kuadër të kësaj ekspertize të Branislav Stefanovskit, prokurorja Kusigerska a ka qenë e detyruar ta siguron dhe të prezantonte në gjykatë, një kopje të licencës së tij si dëshmi se bëhet faj ekspertize valide-ligjore. Po ose jo?

3. Kush e mban përgjegjësinë për ligjshmërinë e provave të prezantuar nga prokuroria në një proces gjyqësor?

4. Për shkak se i gjithë dokumentacioni në këtë lëndë ishte i shqyrtuar, siç theksonte edhe kryeprokurori Jovevski, nga të gjitha nivelet e prokurorive publike, duke filluar nga themeloret, pastaj ajo e lartë dhe më pas republikania, ky skandal me dëshmitë të falsifikuara (ekspertizë jo valide), kush tjetër duhet të mbajë përgjegjësi që këso far ekspertë e kanë shqyrtuar gjithë këtë dokumentacion dhe nuk i kanë hasur dëshmitë jo ligjore?

5. Po ashtu, edhe ekspertiza e psikiatres Zoja Babinkostova është jo valide, për arsye se edhe ajo nuk ka disponuar me licencë valide gjatë kohës kur e ka përpiluar ekspertizën e saj. Edhe këtë lëshim ekspertë e juaj nuk kanë arritur të vërejnë?

6. Kryeprokurori Jovevski deklaronte se janë respektuar të gjithë normat ligjore në këtë lëndë dhe se rikualifikimi i veprës nga "vrasje" në vepër penale "aksident trafik me pasojë vdekje", është mbështetur në dëshmi relevante. Tash, cili është qëndrimi i kryeprokurorit, pasi u zbulua falsifikimi i madh i dëshmive, pas të cilit qëndronin ai dhe kolegji i tërë i prokurorëve?

7. Këtë skandal të cilin në vend se prokurorët tuaj, e zbuluan gazetarët, a është dëshmi e mjaftueshme se në Prokuroritë e vendit vepronin njëanshëm dhe në mënyrë joprofesionale?

8. Kryeprokurori Jovevski, a ndjen më së paku ndonjë përgjegjësi morale drejtë opinionit dhe drejtë familjes së vogëlushit të ndjerë, për shkak se vendimin e tij, i bazuar në dëshmi të falsifikuara, vrasësi i Almirit është lënë në liri?

SHKELJE FLAGRANTE NË RASTIN E VOGËLUSHIT ALMIRI ALIU

EDHE ZOJA PA LICENCË?

Në vend se të pranojë gabimin pas skandalit me mungesën e Licencës për ekspertizë të neuropsikiatrit Stefanovski, por edhe psikiatres Babinkostova, Prokuroria në përgjigjen drejtuar gazetës KOHA thotë se "Licencën për ekspertizë e ka Klinika universitare për psikiatri dhe ajo është relevante...", megjithëse ekspertizën ndaj vrasësit Boban Iliq e ka kryer vetë Stefanovski dhe Babinkostova

Koha


Omer XHAFERI

Shkup, 29 mars - Dy nga tre ekspertët ligjor që e kanë kontrolluar gjendjen psikike të vrasësit Boban Iliq, nuk kanë pasur licencë për kryerjen e ekspertizave. Ngjashëm si kolegu i saj, neuropsikiatri Branislav Stefanovski, edhe psikiatrica Zoja Babinkostova duket se nuk ka pasur licencë punë për realizimin e ekspertizave ligjore me palë.

Në bazë të një vendimi të nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë, Bilal Saliji, thuhet se psikiatres Zoja Babinkostova, i merret licenca e punës dhe e njëjta fshihet nga Regjistri i ekspertëve ligjor. Në arsyetimin e këtij vendimi të Ministrisë së Drejtësisë, thuhet se personi ekspertë, në këtë rast psikiatrica Zoja Babinkostova (ndryshe e njohur si psikiatre e cila e ka kontrolluar vrasësin Boban Iliq), nuk e ka paguar anëtarësinë vjetore për vitin 2015, 2016 dhe 2017 në Odën e ekspertëve ligjor.

"Në bazë të raportit të dorëzuar deri te Ministria e Drejtësisë nga ana e Odës së ekspertëve ligjor për mbajtjen e evidencës për pagesën e anëtarësisë vjetore, Ministri i Drejtësisë vendosi t'ia marrë Licencën për ekspertizë personit Zoja Babinkostova, eksperte e sferës së psikiatrisë, për shkak se e njëjta nuk ka paguar anëtarësinë vjetore për periudhë 2015, 2016 dhe 2017", thuhet në vendimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Megjithatë, në një deklaratë për gazetën KOHA, psikiatrica Babinkostova thotë të mos ketë njohuri se Ministria e Drejtësisë i ka marrë licencën, ndërsa nuk është përgjigjur nëse ka paguar ose jo anëtarësinë në Odën e ekspertëve ligjor, që si, që sipas Rregullores së këtij institucioni, është njëri ndër kushtet që një ekspert të sigurojë licencën.



përgjigjur vetëm në një - madje duke u munduar t'i ikë përgjegjësisë me falsifikimin e ekspertizës, konkretisht pranimin e dëshmisë të ekspertit pa licencë.

"Ju njoftojmë se Prokuroria Themelore e Kumanovës, herën e dytë Urdhëresën për ekspertizë e ka dorëzuar deri te Institucioni Publik i Shëndetit, Klinika universitare për psikiatri në Shkup, e cila si institucion disponon me licencën përkatëse për kryerjen e ekspertizave, në pajtim me nenin 5 të Ligjit për ekspertizë ligjore. Kjo nënkupton se ekspertizën e kryen institucioni kompetent i licencuar konform ligjit, dhe jo personi fizik. Prokuroria ka vlerësuar se institucioni i cili në pajtim me Ligjin disponon licencë është relevante për kryerjen e ekspertizës dhe e njëjtat në këtë rast nuk është kontestuar në procedurë gjyqësor nga asnjë palë e lëndës", thuhet në përgjigjen e vetme nga tetë pyetjet e drejtuar në adresë të Prokurorisë. Nga kjo përgjigje, del se Prokuroria tanimë dëshiron të tërhiqet nga ekspertiza pa licencë e Stefanovskit, duke u thirrë në Licencën e institucionit, përkatësisht të Klinikës Universitare për Psikiatri, megjithëse ekspertizën ndaj Boban Iliqit e ka kryer vet Stefanovski dhe jo Klinika.

MUNGESA E LICENCËS, PËRGJEGJËS PROKURORI I RASTIT

Për skandalin në fjalë, konkretisht mungesën e licencës të neuropsikiatrit kryesor, ka reaguar edhe Avokati i Popullit. Në një deklaratë para gazetarëve, Memeti ka thënë se, me dëshminë e ekspertit neuropsikiatrik pa licencë, vërtetohet se e gjithë procedura e rastit të Almir Aliut është kundërligjore. "Meqë ekspertiza neuropsikiatrike mbi të akuzuarin Boban Iliq është kryer në mungesë të licencës nga personi ek-

ZOJA BABINKOSTOVA

Unë nuk kam njohuri se më është marrë licenca për kryerjen e ekspertizave. Ndërsa faktin se a kam pasur unë licencë gjatë kryerjes së ekspertizës mbi personin Boban Iliq, ju lutemi drejtohuni në Ministrinë e Drejtësisë. Po më kërkoni jashtë orarit të punës

spt, ajo në procesin e mëtutjeshëm shumëçka mundet të ndikojë. Përveç këtij lëshimi procedural, ekzistojnë edhe shkelja tjera të procedurë gjyqësore në rastin e Almir Aliut. Vlerësoj se duhet të presim që publikimet dhe njoftimet se ekspertiza në fjalë është kryer pa licencë adekuate, sa është e saktë një gjë e tillë dhe me siguri - nëse vërtetohet një fakti i tillë, atëherë faji nuk duhet të kërkohet diku tjetër, por te prokurorja e rastit. Detyrë e tyre ka qenë legjitimitimi i personit ekspertë pas caktimit të tij paraprak. Prokurori është dashur ta shikojë dhe vërtetojë nëse personi ekspert i plotëson kushtet formale për kryerjen e një ekspertize të tillë. Kjo paraqet një pengesë dhe shkelje shumë të madhe", tha Memeti.

Ndryshe, ditë më parë, televizioni Alsat-M raportoi se edhe ekspertiza neuropsikiatrike në rastin e Almir Aliut është bërë nga ekspert ligjor pa licencë. Branislav Stefanovski ishte caktuar për ekspert në këtë rast, katër muaj pasi i kishte skaduar afati i licencës. Dokumentet e siguruar nga ky televizion tregojnë se licenca e Stefanovskit kishte skaduar para se të ndodhte vrasja e Almir Aliut më 25 qershor të vitit 2016, në Kumanovë, ku vrasësi Boban Iliq i shoqëruar nga vëllai dhe e dashura e tij, e shtypën për vdekje vogëlushin 4-vjeçar Almir Aliu.

RAPORTI I AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2017

GJYKATAT SELEKTIVE



Ndarja e drejtësisë me dy dy kute assesi të largohet nga gjykatat e vendit. Për të disatën herë, kjo konstatohet edhe nga Raportet vjetore të Avokatit të Popullit. Situatë e njëjtë ishte edhe vitin e kaluar, që sipas Ixhet Memetit, gjykatësit në të shumtën e rasteve nuk punojnë në rritjen e besueshmërisë të qytetarët

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 29 mars - Drejtësia selektive gjithnjë e më e pranishme në sistemin gjyqësor të Maqedonisë. Ky konstatim i Avokatit të Popullit është shpalosur gjatë prezantimit të Raportit të punës për vitin 2017, ku mes tjerash thuhet se pushteti gjyqësor dhe prokuroria vazhdojnë të jenë joefikase, respektivisht të njëjtat nuk punojnë në rritjen e besueshmërisë të qytetarët. Fusha apo numri më i madh i ankesave të parashtruar deri te zyra e Ombudsmanit, gjatë vitit të kaluar, ka qenë drejtpërdrejtë e lidhur me veprimet e gjykatave. Puna me këso lloj lënde, siç theksoi Ombudsmani, Ixhet Memeti, ka vërtetuar se qytetarët nuk kanë besim te gjykatat dhe se këto organe të drejtësisë më shumë kohë humbin në kompletimin e lëndëve sesa në zgjidhjen e tyre.

"Ne si zyrë e Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2017 pengesat më të mëdha i kemi hasur nga pushteti i gjyqësorit. Përderisa kemi tentuar t'i zbatojmë kompetencat e reja ligjore e që lidhen me veprimin tonë si 'Mik i Gjykatës', që nënkupton autorizim për të marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës, me të drejtë të dhënies së propozimeve dhe mendimeve të cilat gjykata duhet t'i merr parasysh. Mirëpo, në disa raste ku ne kemi kërkuar pjesëmarrje në këto procedura, një gjë e tillë nuk na është mundur, me arsyetim se

PËRMES OMBUDSMANIT DO TË PËRFUNDOJË KONTROLLI I JASHTËM NDAJ POLICISË

Realisht i pavarur prej kompetencave dhe ndikimit të policisë, me metodologjinë transparente për kontroll të opinionit dhe autorizimeve të sjellë vendime të obligueshme ligjore, janë bazat në të cilat duhet të mbështetet mekanizmi i jashtëm për kontroll të punës së policisë. Mekanizmat ekzistuese për kontroll të punës së policisë nuk janë as të pavarura, as efikase, theksuan pjesëmarrësit në sesionin e parë të Grupit punues 4 - Drejtësi, liri dhe siguri e Konventës kombëtare për Bashkimin Evropian në Republikën e Maqedonisë me temë "Vendosja e mekanizmit të jashtëm për kontroll të punës së policisë". "Raporti i KE-së prej vitit 2016 e zbardh këtë çështje si diçka në të cilën duhet të punohet duke e pasur parasysh se Sektori aktual për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde të brendshme ka kompetencë jashtëzakonisht të rëndësishme, por është pjesë e skemës organizative të MPB-së dhe me definicion nuk është trup i pavarur", thotë profesori, Tërpe Stojanovski.

Avokati i Popullit në seancë gjyqësore mund të merr pjesë vetëm si publikë dhe se një veprim i këtillë nuk është i përcaktuar me ligjet procedurale", tha Ombudsmani, Memeti. Në zyrën e Ombudsmanit, gjatë vitit të kaluar janë shqyrtuar mbi 4 mijë ankesa.

Mbi 3000 të dhëna në raport janë dorëzuar vetëm në vitin 2017. Shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut, siç tha Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, është konstatuar në mbi 1 mijë raste, ku për 970 lëndë institucionet e ndryshme shtetëror i kanë pranuar rekomandimet dhe intervenimet e tyre. Kështu, nëse bëhet krahasimi me vitin 2016, zyra e Avokatit të Popullit ka konstatuar se për rreth 6 për

qind është zvogëluar numri i shkeljeve të lirive dhe të drejtave të njeriut. Memeti shprehu keqardhje për gjendjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sipas tij, edhe gjatë vitit 2017 polica ka vepruar në mënyrë jo profesionale, duke zbatuar standarde të dyfishta në punë, me çka i ka vërtetuar vërejtjet shumëvjeçare të këtij institucioni, se MPB-ja është thellë e partizuar. Prokuroria Publike, sipas analizave të Avokatit të Popullit, vitin e kaluar nuk ka treguar qëllime serioze për zbulimin dhe ndëshkimin përkatës të kryerësve të veprave penale. "Pas paraqitjes së pesë kërkesave, për përcaktim të përgjegjësisë penale kundër nëpunësve të policisë, për rastet në të cilët ne vepruam me kompetencë. Në këtë rast vetëm një kallëzim penal i parashtruar nga ana jonë, prokurori publike e ka iniciuar para Gjykatave si akuzë. Prokurorisë i rekomandoj të veprojë në mënyrë profesionale dhe objektive konform kompetencave, gjegjësisht mos të ndërmer hapa selektive, të dëm të besimit të qytetarëve në funksionimin e institucioneve", tha Memeti.

Ndryshe, në raportin e Avokatit të Popullit thuhet se gjatë vitit 2017, është vërejtur një nivel më i lartë i bashkëpunimit me pushtetin qendror, gjegjësisht diktatet ministore siç janë ajo e Shëndetësisë, Financave, Punëve të Brendshme, Drejtësisë e kështu me radhë.

KËSHILLI PËR ZBATIMIN E REFORMAVE MBLIDHET PËR HERË TË PARË

Të mërkurën, në Qeverinë e Maqedonisë, u zhvillua takimi i parë i Këshillit për implementimin e Strategjisë për reforma 2017-2020. Siç është e ditur, me këtë Këshill do të kryesoj vetë kryeministri Zoran Zaev, ndërsa pjesa dërmuese e anëtarëve tjerë u bënë të ditur në këtë seancë konstituive. Kështu, krahas Lubomir Jovevskit dhe Katica Janevës, pjesë e këtij Këshilli do të jetë edhe Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, prokurori i Prokurorisë Republikane, Xhelal Bajrami, kryetari i Shoqatës së Gjykatësve të Maqedonisë, Xhemali Saiti, avokati Ibrahim Bajrami dhe kryetarët e Gjykatave Themelore të Shkupit, Gostivarit, Shtipit dhe instanca tjera të larta gjyqësore në vend. Detyrë primare e këtij Këshilli do të jetë që në periudhën që vijon, të zbatohen reformat në sistemin gjyqësor, respektivisht miratimi i më shumë propozime-ligjeve, duke filluar nga Gjykata, Këshilli Gjyqësor, Akademia për gjykatës dhe prokurorët, Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, e ardhmja e Prokurorisë Speciale Publike e kështu me radhë.

KRONIKË

Gjashtë persona sulmojnë dy të rinj

Dy 22 vjeçarë me iniciale E.M dhe A.L nga Tetova, të mërkurën mbrëma rreth orës 21.50 minuta kanë denoncuar dhunë fizike të cilën një orë përpara denoncimit ndaj tyre e kanë kryer gjashtë persona të moshës nga 18 deri në 20 vjet. Dy tetovarët kanë ndaluar veturën e tyre përpara një objekti hotelierik në udhëkryqin e rrugëve "Bllagoja Toska", dhe rrugës 107 në Tetovë dhe pa asnjë arsye menjëherë pas kësaj janë sulmuar fizikisht nga gjashtë personat në fjalë, të cilët disa herë i kanë goditur me boksa hekurri, grushte dhe shkelma, duke ju shkakuar lëndime të dukshme, dhe pasi që i kanë shtrirë në tokë menjëherë e kanë lëshuar vendin e ngjarjes. Të sulmuarit E.M dhe A.L të cilët paraprakisht kishin pasur disa mosmarrëveshje me njërin nga sulmuesit janë drejtuar për ndihmë mjekësore në spitalin klinik të Tetovës dhe në denoncimin e këtij rasti kanë dorëzuar edhe dokumentacion adekuat medicinal që vërteton lëndime e marra nga sulmi fizik ndaj tyre. Po punohet në zbardhjen e plotë të këtij sulmi fizik si dhe në zbulimin e të përfshirëve në këtë sulm, njofton përmes një kumtese me shkrim Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Vidhet edhe një veturë në Gostivar

Deri më tani persona të panjohur mes datës 27 dhe 28 të këtij muaj pa u vërejtur nga askush, i kanë marrë veturën 67-vjeçarit me iniciale N.Ç nga Gostivari të cilën e ka parkuar në rrugën "Koco Zozi" në Gostivar. Vetura e tipit "Opel Astra" me targa të Gostivarit ka pasur çelësat në bravë të derës dhe brenda sajë ka pasur mjete të ndryshme pune. Vlera e përgjithshme e veturës dhe mjeteve që kanë qenë brenda veturës së vjedhur vlerësohet që jetë rreth 100 mijë denarë. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për gjetjen e veturës si dhe zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje, njofton policia.

Paditet ish-kryetari i Sveti Nikoles

Policia parashtrou padi penale kundër R.GJ. (45) nga Sveti Nikole për shkak të ekzistimit të dyshimit për vepër të kryer penale "keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit", kundër personit juridik "Vin-im" SHPKNJP Vinicë, S.T. (51) nga Vinica dhe S.D. (55) nga Vinica për shkak të ekzistimit të dyshimit për vepër të kryer penale "ndërtim pa leje". Siç kumtoi MPB, më 20 maj të vitit 2010 i paraqituri i parë, si kryetar i komunës së Sveti Nikoles, solli dhe zbatoi vendim për furnizim publik për ndërtim të rreshtit të epërm të sipërfaqes rrugore dhe rikonstruimit dhe përfundimit të ndërtimit të rrugëve në Sveti Nikole për shumë prej 6.500.000 denarëve. Vendimi ishte sjellur pa u përpunuar paraprakisht projekt themelor dhe pa miratimin për ndërtim, si dhe pa ndryshim të planit të hollësishëm urbanistik. Procedurën për furnizim publik e zbatoi me sasi fiktive nga pozitat në matje-llogaritje dhe me vendim të Komisionit për furnizime publike për kryesin ishte zgjedhur personi i paraqitur i dytë juridik, në të cilin person përgjegjës ishte e paraqitura e tretë. Pas kësaj, S.T. përmes personit të paraqitur juridik ka filluar me kryerjen e punëve ndërtimore dhe së bashku me S.D., si kryes i mbikëqyrjes, gjatë dhe pas punëve të kryera ndërtimore përgatitën gjendje përfunduese për pagesë. Edhe në këtë rast, procedurën për furnizime publike e zbatoi me sasi fiktive nga pozitat në matje-përllogaritje, ndërkaq me vendim të Komisionit për furnizime publike për kryes ishte zgjedhur SHN "Izgrev inzhenering" SHPKNJP Veles.

Propozim-ligji për arsim të lartë e ka të pamundur të zgjidhë problemet thelbësore në arsim, pasi edhe ky si gjithë të tjerët - është përgatitur në mungesë të analizave të mirëfillta, debatit të mirëfilltë dhe konsultimit me palët e interesit, thonë njohësit e çështjeve arsimore në Maqedoni

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 29 mars - Sfidat me të cilat përballet arsimi janë shumë të gjera dhe shpeshherë të pa kapërcyeshme nga ligjet, të cilat nxirren në emrin e reformave. Kësisoj, edhe Propozim-ligji për arsim të lartë është para përgjegjësisë të ofrojë zgjidhje nëse jo për të gjitha për shumicën prej problemeve me të cilat ballafaqohet arsimi i lartë në Maqedoni. Kjo është njëra prej porosive që doli nga Tryeza e rumbullakët "E ardhmja në arsim mbi themelet e reformave" organizuar nga organizoi Unioni Studentor Shqiptarë. Por, prof. dr. Avzi Mustafa thotë se "problemi është se mungon debati i mirëfilltë, se universitetet janë të politizuara" ose ende më keq "sepse politizimi, nepotizmi dhe problem të ngjashme janë të fundit në listë. po ti krahasojmë me nivelin në të cilin ka zbritur kriteret akademike", pohon profesori tjetër universitar Gadaf Rexhepi.

Pavarësisht të gjithave, deputetja Gjilimsere Kasapi thotë se ka ende vend për ndryshime. Në cilësinë e anëtares të Komisionit për reforma në arsim, ajo ka ftuar për javën e ardhshme USSH-në të debatojnë në Parlament rreth Propozim-ligjit për arsim të lartë. "Ditën e mërkurë ose të enjten, përfaqësues të Unionit do të vini në debatin që do të zhvillohet rreth Ligjit për arsim të lartë dhe kërkoj që aty ta jepni mendimin e juaj. Kur do të ngrini zërin drejtpërsëdrejti, kështu sikurse bëni tani, besoni se do ta arrini edhe rezultatin dhe suksese

TRYEZË E RRUMBULLAKËT "E ARDHMJA NË ARSIM MBI THEMELET E REFORMAVE"

LIGJET E ARSIMIN, SI "SHTËPIA PA SHKALLË" E PASHIQIT



NDRYSHIME LIGJORE PËR LEHTËSIM TË PLOTËSIMIT TË DITARIT ELEKTRONIK

Në ligjet për arsim fillor dhe të mesëm do të bëhen ndryshime ligjore të cilat do t'i referohen asaj se ditari elektronik dhe në letër nuk duhet të jenë me përmbajtje të njëjtë në kuptim të të gjitha komponentëve që i përmbajnë. Është fakt se komponentët të caktuara të cilat i përmbajnë ditari elektronik janë të panevojshme dhe nuk u interesojë prindërve për t'i lexuar, e as ndërkaq i shikojnë. Këtë e theksoi ministria e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, e cila tha se nga ana tjetër aspekte të caktuara të cilat janë të përbashkëta për tërë shkollën apo ndërkaq janë të përbashkëta për të gjitha shkollat do të jenë përmes mënyrës teknike të bëra automatikisht që

të futen në ditarin elektronik në mënyrë që arsimtari të mos ketë nevojë t'i fusë. "Një pjesë do të mbetet e cila do të plotësohet, e ajo është prezenca dhe notat që i marrin nxënësit", tha Deskoska, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes Tatiana Lalçevska nga LSDM. Lidhur me ndryshimet e ligjit për arsim fillor dhe të mesëm theksoi se po shqyrtojnë kur do të formohet fondi i orëve të mësimdhënësve një pjesë nga fondi i orëve t'u njihet mësimdhënësve të caktuar të cilët do të jenë të angazhuar për udhëheqjen e ditarit elektronik në nivel të shkollës. Sipas saj, në këtë mënyrë do të bëhet baraspeshë e obligimeve dhe mësimdhënësit do të jenë më pak të angazhuar.

sin". Këtë ftesë Kasapi, deputete e radhëve të LSDMS-së ua drejtoi publikisht studentëve gjatë Tryezës së rumbullakët që ata organizuan në kuadër të aktivitetëve "Java studentore". Propozim-ligji, sipas saj, ka shumë ndryshime interesante të cilat do ta fuqizojnë autonominë e universiteteve, do të shtojnë aktivizimin e studentëve në forma të ndryshme dhe do të risin pjesëmarrjen e tyre në organet vendimarrëse. Do të ketë ndryshime edhe në drejtim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë, tha ajo edhe pse problematike po sipas saj mbe-

sin financat. "Kam kërkuar personalisht prej ministres të Arsimit, Renata Deskovskës që të kërkon më tepër financa për reforma, sepse pa para nuk mund të bëhet asgjë, nuk mund të ofrohen kushte më të mira në shkollë", u shpreh deputetja. Por, kritika për mungesën e debatit dhe mënyrës se si nxirren ligjet drejtoi profesor Mustafa. Teksa përgëzoi studentët për organizimin e debateve mbi problemet në arsim, ai tha se debate të këtilla do të duhej të organizonin edhe institucionet e thirrura pikërisht për këtë punë. "Nuk di që deri tani diku

sh tjetër përpos studentëve të ketë diskutuar mbi arsimin. Nuk kanë organizuar debate as Ministria, as Qeveria dhe as universitetet", u shpreh ai. Në analogji me anekdotën për serbin Nikolla Pashiqi, i cili u bë politikan, sepse u tërhoq nga profesioni i arkitektit për shkak se kishte harruar shkallët në projektimin e një shtëpie mjaft të bukur, edhe Ligji i ri për arsim të lartë që pritet të nxitet së shpejti në Maqedoni sipas profesor Mustafës është si puna e "shtëpisë së Pashiqit", e bukur por brenda pa shkallë. "Nxjerrin Ligje, por nuk bëjnë analiza, nuk konsul-

tohen me ekspertë dhe as me grupet e interesit", shpjegoi ai.

Prof.dr.Gadaf Rexhepi ngriti si problemin më shqetësues lehtësinë me të cilën në Maqedoni merren thirrjet akademike dhe titujt shkencor. "Propozim-ligji i mundëson secilit të jetë profesor. Është shumë e lehtë në jesh profesor në Maqedoni. Mund ti dëshmoj secilit se me një muaj punë mund të marrësh cilin titull. qoftë prof. ordinar, qoftë prof. inordinar, qoftë docent. Sepse, të duhen maksimumi gjashtë punime që cilat mund ti botosh ku të kesh qejf, në Prishtinë, Tiranë ose Prilep. Niveli i kraterëve për të bërë karrierë akademike është jashtëzakonisht i ulët". Ky është shqetësimi që Rexhepi tha se dëshironte ta ndante me ministren Deskovaka për të cilën thotë është e politizuar, gjithashtu. Një prej argumenteve me të cilën mbështet këtë konstatim është ndryshimi i neneve që rregullon çështjen e organizimit të studimeve të doktoraturës. "Kur u nxor varianti i parë i Propozim-ligjit kërkohej që këtë të drejtë ta kenë vetëm universitetet e ranguar në pesë vendet e para në Maqedoni. Me ndryshimet që përsuan, u ndryshua edhe ky nen i cili lejon që studimet e doktoraturës të organizojnë tanimë jo pesë universitetet e ranguar më mirë por shtatë universitetet. Dhe, e gjithë kjo që të përfshihet edhe Universiteti 'Kolegji Amerikan' ku ministria Deskovska ka interesa private", akuzoi profesori Rexhepi. I ftuar për pjesëmarrje në panelin e diskutimeve ishte edhe zëvendësiministri i Arsimit, Arbër Ademi, por që sipas drejtuesve të USSH-së, nuk e ka parë të arsyeshme ti vendos studentët në agjendën e angazhimeve të tij, për çka edhe mungoi në tryezën organizuar nga USSH-ja.

ULEN ÇMIMET E ILAÇEVE

Shkup, 29 mars - Janë ulur çmimet maksimale të 336 ilaçeve gjenerike dhe 222 origjinore (inovative). Ulja e çmimeve maksimale sjell edhe deri në uljen e çmimeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të ilaçeve të cilat do të vlejnjë nga 1 prilli. Këtë dje në konferencë për shtyp e theksoi ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili tha se ulen çmimet për 40 deri në 50 për qind nga ilaçet gjenerike dhe inovative. Me këtë ulje të çmimeve, theksoi, janë përf-

shirë të gjitha grupet e ilaçeve nga lista pozitive. "Kursimi tek ilaçet gjenerike në nivel vjetor arrin 993.000 euro, ndërsa tek ilaçet origjinore arrin 1.388.600 euro ose gjithsej 2.381.600 euro. Për dallim në vitin 2016, kursimi i përgjithshëm tek ilaçet inovative dhe gjenerike ka arritur 1.126.000 euro, ndërsa në vitin 2017 kursimi ka arritur 398.315", ka thënë Filipçe dhe shtoi se bëhet fjalë për kursimin më të madh deri më tani me të cilin qytetarët do të marrin

ilaçe më të lira dhe mundësi për kurim me ilaçe të reja dhe zgjerim të listës pozitive të ilaçeve. Ai theksoi se njëkohësisht me uljen e çmimeve të ilaçeve nga lista spitalore do të mundësohet rritja e cilësisë së mbrojtjes shëndetësore. "Ministria e Shëndetësisë edhe në të ardhmen do të vazhdojë ta shpërblejë metodologjinë për çmimet e ilaçeve si masë racionale me qëllim të ndjekjes së politikës së çmimeve të ilaçeve në interes të qytetarëve", shtoi ministri



Filipçe. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve tha se me uljen e çmimeve të ilaçeve me këtë kursim të madh prej mbi dy milionë euro do të mundësohen

ilaçe më të lira, ndërsa më tej me pjesën e kursimeve do të sigurohet buxheti, siç sigurojnë mjete shtesë, që të zgjerohet lista pozitive e ilaçeve.

Qeveria të mos shpejtojë me rritjen e tatimeve

Shkup, 29 mars - Qeveria të mos shpejtojë me rritjen e tatimit, sepse at hok zgjidhja e tillë mund të jetë fatale, veçanërisht për TIK industrinë, apelon MASIT. Duhet të bisedohet, por edhe të merren parasysh shembujt nga vendet të cilat kanë tatim të sheshtë me çka stimulohet e a.q. ekonomia ligjore, kundrejt asaj jo-ligjore, gjegjësisht nxitet pagesa e rregullt të taksave. Sipas MASIT, vendosja eventuale e 18 për qind të tatimit për këtë periudhë mbi një mijë euro që parasheh Ministria e Financave, do të thotë presion nga TIK sektorit dhe rrjedhë shtesë e kuadrit. "At hok rritja e tatimit nuk do të ndihmojë shumë, e as nuk paraqet zgjidhje shtesë madje mund negativisht të ndikojë, veçanërisht në industrinë tonë. Duhet të bisedojmë që të dëgjohet qëndrimi ynë dhe të gjejmë zgjidhje komparative me vendet tjera rreth dhe në botë", deklaroi kryetari i Bordit drejtues të MASIT, Goran Popovski para Asamblesë së rregullt vjetore në të cilën MASIT shënon 18 vjet të ekzistimit. Popovski theksoi se Oda ka shumë propozime, ndërsa njëri prej tyre është që MASIT të përjashtohet nga dispozitat e përgjithshme dhe ligjet sepse është industri specifike e cila gjeneron vlerë të shtuar përmes teknologjive të reja, zhvillimit teknologjik dhe rritjes së eksportit. "Nuk guxojmë ta shtypim TIK industrinë, sepse edhe ashtu është e dukshme rrjedha e kuadrove. E kanë shumë të lehtë për të gjetur punë dhe të largohen prej këtu", tha Popovski. Edhe drejtoresha ekzekutive e MASIT-it Anita Nikova paralajmëroi se duhet të bëhet shumë kujdes me rritjen e tatimeve. "Të mos vijmë në situatë që të kthehemi në ato kohëra kur mund të gjindej mënyrë më e lirë si të paguhen taksat. Tani pothuajse nuk ka ndërmarrje nga TIK sektori e cila paguan mjete shtesë në dorë", potencoi Nikova. Apel i MASIT është që Qeveria të tregojë dëgjim shtesë dhe gatishmëri për bashkëpunim. Sugjerimi i Odës është që edhe Maqedonia të ndalojë të shitet si vend me fuqi më të lirë të punës, por të tentojë të promovojë dhe plasojë prodhime personale.

Duhet të punohet në shkathtësitë digjitale të popullatës apo përdorimit të shërbimeve të ndryshme elektronike dhe kjo të shoqërohet me rritjen e vetëdijes për përfitimet nga blerjet elektronike

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 29 mars - Bizneset në Maqedoni që ofrojnë shërbimet dhe prodhimet e tyre, duhet të rrisin dhe përmirësojnë ofertën për blerësit, duke u orientuar të shesin jo vetëm brenda por edhe jashtë kufijve të Maqedonisë. Shteti, nga ana tjetër, nevojitet që të krijojë lehtësime të mëtejshme dhe të eliminojë barrierat e ndryshme siç është vendosja e paypal (kartelë kredituese online) për pagesat direkte jashtë shtetit etj.

TREGTARËT E JASHTËM MË TË INTERESUAR

Sipas Shoqatës së Tregtisë elektronike të Maqedonisë, Maqedonia më mirë qëndron në raport me shtetet e tjera të rajonit duke u renditur në vendin e tretë lidhur me tregtinë elektronike, pas Kroacisë dhe Sllovenisë. Megjithatë me realizimin prej 105 milion euro të tregtisë elektronike ngecim mjaft pas shteteve evropiane. Bile edhe kësaj shume jo të vogël të tregtisë përmes internetit më shumë ja shohin hajrin tregtarët e jashtëm siç është Ali Ekspres, për shkak se vetëm afër 30 milion euro janë fitimet e tregtarëve vendor, ndërsa pjesa tjetër e kulaçit u takon tregtarëve që punojnë jashtë Maqedonisë.

Vlerësohet se në të ardhmen nevojitet të përshpejtohet ky biznes që ka perspektivë të madhe për shkak se në Maqedoni ekzistojnë kushtet e nevojshme si mbulimi i madh i popullatës me internet, çdo 0.9 banor në shtet posedon kartelë, kemi rregullativë të duhur dhe dërgim të mirë të dërgesave postare.

"Kompanitë vendore nga Maqedonia duhet të rrisin ofertën e tyre për prodhimet dhe shërbimet që ofrojnë përmes internetit si për

SHITBLERJET ONLINE NË MAQEDONI

KA HAPËSIRË PËR RITJE TË TREGTISË ELEKTRONIKE



TREGTIA ELEKTRONIKE STIMULON EKONOMINË VENDORE

"Tregtia elektronike duhet të mbështetet dhe përkrahet për shkak se ajo paraqet tregti pa kesh që sjell benefite të shumta për ekonominë vendore, duke filluar nga rritja e eksportit me shitjen e prodhimeve që ofrojnë tregtarët tanë jashtë shtetit, zvogëlon ekonominë informale e kështu me radhë", thotë guvernatori Dimitar Bogov.

blerësit brenda shtetit ashtu edhe për ata jashtë shtetit. Gjithashtu duhet të punohet në shkathtësitë digjitale të popullatës apo përdorimit të shërbimeve të ndryshme

elektronike si dhe nevojitet të rritet edhe vetëdija për përfitimet nga blerjet elektronike", thotë Nina Angellovska nga Shoqata e tregtisë elektronike të Maqedonisë.

Edhe nga Banka Popullore e Maqedonisë thonë se Maqedonia ka hapësirë për rritje të tregtisë elektronike.

"Tregtia elektronike duhet të mbështetet dhe përkrahet për shkak se ajo paraqet tregti pa kesh që sjell benefite të shumta për ekonominë vendore, duke filluar nga rritja e eksportit me shitjen e prodhimeve që ofrojnë tregtarët tanë jashtë shtetit, zvogëlon ekonominë informale e kështu me radhë", thotë guvernatori Dimitar Bogov.

POTENCIAL SERIOZ PËR TREGTINË ELEKTRONIKE NË MAQEDONI

Në ndërkohë ekspertët e marketingut vlerësojnë se gjeneratat e reja po i ndërrojnë shprehitë dhe për momentin ekziston potencial serioz për tregtinë elektronike në Maqedoni që të përjetojë ekspansion në vitet e ardhshme.

"Nevojitet që kompanitë të përgatisin strategji serioze për tu prezentuar në tregun vendor, me informacione që direkt janë të fituara nga vetë konsumatorët me pjesëmarrje më të madhe të personave të moshës 19-54 vjeç pasi ato janë indi kryesor konsumator në çdo shoqëri", thotë Sergej Zafirovski menaxher për hulumtim të tregjeve.

Ndryshe, ekspertët e Teknologjisë informatike thotë se internet shitoret sjellin mjaft përfitime siç janë krahasimi më i lehtë i çmimeve, mos pritja rend, qasja në çdo kohë dhe nga çdo vend, gjegjësisht zgjidhje e madhe e produkteve në shitoret që punojnë 24 orë. Mirëpo krahas gjërave pozitive ekzistojnë edhe gjërat negative të blerjes në internet siç janë mungesa e kontaktit personal, pamundësia të provohet prodhimi para blerjes etj. Për dallim prej shitoreve normale, në këtë rast bëhet fjalë për mungesë të aspektit social, ekzistojnë shumë prodhime që blerësit dëshirojnë ti prekin, ti ndjejnë, tu marrin erë, që si luks nuk ekziston tek blerjet elektronike.

KONKURSI PËR BLERJEN E KOMPOZIMEVE KLASIKE DO TË PËRSËRITET

Shkup, 29 mars - Ministria e Kulturës kumtoi se Konkursi për blerjen e kompozimeve klasike për vitin 2017, që vitin e kaluar ishte publikuar në shtypin ditor, anulohet për shkak të lëshimeve administrative në implementimin e tij dhe se do të përsëritet, ndërsa të drejtë pjesëmarrjeje do të kenë edhe aplikuesit nga konkursi i anuluar. Kumtesa nga Ministria e Kulturës është përgjigje ndaj reagimit të sotëm të Lidhjes

së Kompozitorëve të Maqedonisë - LIKOMA, e cila kërkoi që të respektohen rezultatet nga konkursi për blerje të cilat ishin publikuar më 18 janar dhe të njëjtën ditë ishin tërhequr nga ueb-faqja e Ministrisë. "Konkursi ka zgjatuar deri më 31 tetor të vitit 2017. Në pikën 10 qëndron se pas Konkursit do të silllet vendim në afat prej 45 ditëve, ndërsa për Konkursin vendim do të silllet në përputhje me Ligjin për Kulturë. Re-

zultatet nga Konkursi për çdo kategori të veçantë do të publikohen kah fundi i dhjetorit të vitit 2017. Në Konkurs qëndron se fletëparaqitjet dorëzohen nën shifra që të mos zbulohet identiteti i autorëve deri në zgjedhjen e kompozimeve më të mira", kumtoi Ministria. Sqaron edhe se në përputhje me Ligjin e kulturës, ministri vendos për Konkursin me propozim të Komisionit, me sjelljen e vendimeve,

ndërsa rezultatet pastaj publikohen në ueb-faqen e Ministrisë. Komisioni për shqyrtim të fletëparaqitjeve nga Konkursi i ka shqyrtuar fletëparaqitjet dhe ka përgatitur procesverbal në të cilin i ka përmbledhur rezultatet nga evoluimi i bërë i fletëparaqitjeve të dorëzuara. Më 18 janar pas dorëzimit të propozim - listës së rezultateve nga ana e komisionit, ato janë publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Kulturës.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 21/2018

për punësimin e 6 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës “për vendet e punës në vijim:

<p>1. UPR0101B03000 Ndhmës-udhëheqësi i sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar I realizues(ë)</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat politike - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatesisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 31.331,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>	<p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 23.257,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>	<p>për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.</p> <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, kinezologji ose shkencat politike - me ose pa përvojë pune <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 20.987,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>
<p>2. UPR0101V01000 Këshilltar për negociata dhe integritet dhe programet e Bashkimit, Njësia për negociata dhe integritet dhe programet e Bashkimit Evropian, Sektori për Bashkim Evropian I realizues(ë)</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike ose shkencat ekonomike - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>	<p>4. UPR0101V04000 Bashkëpunor i ri për programimin e monitorimit dhe vlerësimin e IPA, Njësia për programim, monitoring dhe vlerësim të IPA, Sektori për Unionin Evropian I realizues(ë)</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat politike - me ose pa përvojë pune <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 20.987,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>	<p>6. UPR0101V04000 Bashkëpunor i ri për analizë të planifikimit strategjik, Njësia për planifikim strategjik dhe analizë I realizues(ë)</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, turizëm dhe hoteleri ose shkencat organizuese dhe menaxhim(menaxhment) - me ose pa përvojë pune <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësime strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) <p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30 <p>- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30</p> <p>Rroga neto: 20.987,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.</p> <p>Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.</p> <p>Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.</p> <p>Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.</p> <p>Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.</p> <p>Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.</p> <p>Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.</p> <p>Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.</p>
<p>3. UPR0101V02000 Këshilltar për çështje normative juridike në arsim dhe shkencë, Njësia për çështje normative-juridike në veprimtari, Sektori për çështje normative juridike I realizues(ë)</p>	<p>5. UPR0101V04000 Bashkëpunor i ri për furnizime publike, Njësia për koordinimin e furnizimeve publike, Sektori për çështje organizuese të Ministrisë I realizues(ë)</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese 	

Donacion për Qendrën për trajnim të MPB-së

Shkup, 29 mars - Donacion në pajisje nga OSBE-ja për Ministrinë e Punëve të Brendshme sot është dorëzuar në Qendrën për trajnim të MPB-së. Vlera e përgjithshme e donacionit është rreth 44.000 euro. "Donacioni i sotëm për nevojat e njësisë të organizuara pranë MBP-së, nuk është i pari, ndërkaq që besoj - as i fundit, në portofolin tonë të partneritetit. Në të vërtetë, ne së bashku bëjmë dhe po bëjmë shumë hapa të rëndësishëm në standardizimin, sendërtimin profesional dhe zhvillimin e shërbimit policor", tha gjatë pranim-dorëzimit të donacionit ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Ne, tha ai, si kryesi aktuale e konsiderojmë dhe çdo ditë promovojmë si bazik konceptin e policisë në shërbim të qytetarëve, si servis i tyre, që [tërësisht, pa rezerva, do të jetë e kahëzuar në realizimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave qytetare në domenin e obligimeve dhe kompetencave policore. Ambasadorja Nina Soumalainen, siç kumtoi MPB, tha se vite të tëra Misioni i OSBE-së e mbështetë MPB-në në përfundimin e kapaciteteve institucionale. "Ne si mision ndërmorë edhe disa nisma për afrim të policisë drejt qytetarëve. Në atë pikëpamje do të përmendja zyrat për pranim. Ajo është gjëja e parë që qytetarët e shohin gjatë hyrjes në stacionin policor", tha Soumalainen. Misioni i OSBE-së, shtoi, e mbështetë pajisjen e katër zyrave në stacionet policore në Ohër, Tetovë, Bit Pazar dhe Kumanovë, tha ambasadorja Soumalainen, e cila i shprehi falënderim kryesisht të MPB-së për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm.

Fazliu tha se ka filluar një projekt ideor për rregullimin e Qendrës së Tetovës. "Kemi premtuar edhe gjatë fushatës së Qendra e Tetovës do të duhet të ketë pamje tjetër. Ne jemi duke përpiluar edhe projekt ideor dhe më pas të fillojmë me realizimin e tij", sqarojnë nga Komuna e Tetovës

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 29 mars - Së shpejti pritet të largohen lodrat e fëmijëve, të cilat me vite kanë uzurpuar qendrën e qytetit të Tetovës. Në kuadër të projektit "Qyteti yt - hapësira yte", sheshi i qytetit të Tetovës do të pastrohet plotësisht nga veturat e fëmijëve me bateri që funksionojnë në hapësirë publike. Këto lodra do të zhvendoset në një vend të ri, në përputhje me të gjitha procedurat ligjore të qendrës sportive pranë fushave të tenisit, kanë thënë nga komuna e Tetovës. Zëdhënësi i Komunës së Tetovës, Armend Fazliu, thotë se ky hap është në kuadër të vazhdimin të aksionit për pastrimin e hapësirave publike. "Në kuadër të planit aksional për lirin e hapësirave publike, trotuareve, dhe hapësirave për këmbësorë, Komuna e Tetovës do të veprojë për dislokimin e veturave në Qendrën e qytetit 'Iliria', dhe të njëjtët subjekte pas konkursit publik nga ana e Sektorit për veprimtari Komunale, do të pajisen me leje për shfrytëzim të hapësirës publike në afërsi të qendrës Sportive të qytetit", deklaroi Armend Fazliu, zëdhënësi i Komunës së Tetovës. Nga Komuna e Tetovës nënvizuan se deri më tani, shfrytëzuesit e hapësirës në qendër kanë vepruar në bazë ligjore. "Ata subjekte në qendër kanë operuar në bazë të lejeve që janë dhënë nga sektori për veprimtari komunale. Ata kanë konkurruar dhe kanë marrë leje edhe për aspektin social. Në këtë mandat të ri, kemi vizion të ri për qytetin dhe për zhvillimin e qytetit në atë pjesë, është marrë vendim që të dislokohen të njëjtat. Nuk ka qenë esenca që të pengojmë qytetarët të përfitojnë nga bizneset e tyre, por këtë e bëjmë për shkak të lirit të hapësirave publike dhe kemi dhënë një alternativë që është në afërsi të Qendrës sportive enkas për këtë veprimtari. Shpallja do të bëhet së shpejti nga ana e sektorit përkatës dhe të gjithë ata

VAZHDON LIRIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE



DISLOKOHEN LOJËRAT PËR FËMIJË

që janë të interesuar të konkurrojnë mund të marrin leje", deklaroi Fazliu. Ai tha se ka filluar një projekt ideor për rregullimin e Qendrës së Tetovës. "Neve kemi premtuar edhe gjatë fushatës së qendra e Tetovës do të duhet të ketë pamje tjetër. Ne jemi duke përpiluar edhe projekt ideor dhe më pas të fillojmë me realizimin e tij", sqarojnë nga Komuna e Tetovës. Gjithashtu, është planifikuar të reduktohet hapësira rreth vendit për lodrat e fëmijëve, e cila ka për dekada të tëra ka mbetur e lënë anash. Në konkursin e Komunës së Tetovës thuhet se shfrytëzimi i sipërfaqes publike të sheshit në Tetovë pa aktvendim nga organi kompetent i Komunës, inspektorati komunal pranë Komunës së Tetovës në pajtim me kompetencat e saja do të merr masa përkatëse inspektuese sipas

dispozitave ligjore të cilat e rregullojnë këtë materie. "Aktvendimi për shfrytëzimin e sipërfaqes publike të Qendrës sportive afër klubit për tenis në Tetovë, për vendosjen apo huazimin e lojërave të fëmijëve, ka të bëjë për periudhën nga data një prilli deri më 30 shtator, kurse çmimi për shfrytëzimin e hapësirës për metër katrorë është 10 denarë në ditë. Secili person mund të huazojë maksimum 6 metër katrorë. Hapësira për vendosjen - huazimin e lojërave të fëmijëve, do të jepet sipas parimit i pari që vjen, i pari shërbehet", qëndron në shpalljen publike të komunës së Tetovës lidhur me dhënien e lejes për shfrytëzim të hapësirës në afërsi të qendrës sportive ku edhe janë duke u zhvilluar punët për adaptimin e së njëjtës për këtë veprimtari.

Për një javë, rreth 700 të infektuar nga gripi

Shkup, 29 mars - Gjatë javës së kaluar (prej 19 mars deri më 25 mars), në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 693 të infektuar prej gripit, që është ulje për 47 për qind në krahasim me javën para kësaj kur u regjistruan 1.304 të infektuar prej gripit. Lidhur me javën e 12-të të sezonit të kaluar e cila karakterizohej me fillim të

hershëm dhe kulm të aktivitetit, këtë sezon numri i të infektuarve është rritur për 10 herë. Incidenca e regjistruar këtë javë është nën kufirin javor të aktivitetit të ulët (sezonal) të virusit të gripit. Javën e kaluar numri më i madh i të infektuarve - 466 janë paraqitur në grup moshën e të rriturve prej 15-64 vjeç, ndërsa incidencë më të

lartë prej 45,6 në 100.000 banorë janë regjistruar te fëmijët në moshën prej 0-4 vjeç. Numri më i madh i të infektuarve - 131 janë paraqitur në rajonin e Qendrës të Shëndetit Publik Strumicë, ndërsa incidencë më të lartë prej 292,5 në 100.000 banorë janë regjistruar në rajonin e Njësisë rajonale Shën Nikollë.

Në sezonin 2017/2018 janë paraqitur 23.097 raste të gripit, Numri i rasteve të regjistruara është më i vogël për 34 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë nga sezoni i kaluar (34.725). Vlerësohet qarkullimi i përbashkët i Influcencës të virusit A dhe Influcencës të virusit B në vend me dominim të virusit.

KOMUNA E GOSTIVARIT I DREJTOHET INSTITUCIONEVE



Taravari ndërpret fushatën "E vërteta për BDI"

Shkup, 29 mars - Fushata e Komunës së Gostivarit "E vërteta për BDI-në" është ndërprerë për t'u lënë hapësirë organeve kompetente të veprojnë në përputhje me shkeljet e konstatuara. Kështu ka deklaruar zëdhënësi i komunës së Gostivarit, Jasin Demiri, duke vënë në dukje se kanë në dispozicion dëshmi të reja për keqpërdorime. "Të gjitha shkeljet dhe abuzimet të cilat i kemi konstatuar gjatë kon-

trolleve të brendshme, respektivisht për të gjitha rastet ku ekzistojnë dyshime të bazuara për kundërvajtje apo vepër të kryer penale, i kemi denoncuar para organeve kompetente, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë financiare, Prokurorinë Publike", theksoi Demiri. Komuna ka kërkuar kontroll nga revizioni shtetëror, si edhe nga Inspektorati i punës dhe Inspektorati shtetëror i arsimit që të bëjnë

kontrolle të jashtëzakonshme me qëllim që e vërteta të dalë në shesh dhe për çdo keqpërdorim të kërkohet përgjegjësi. "Komuna e Gostivarit do të vazhdojë me kontrolle të brendshme për punën e udhëheqësisë komunale në mandatet e shkuara, duke mos anashkaluar edhe punën e administratës komunale në këtë mandat. Pra, askush nuk do të mund t'i ikë përgjegjësisë për shkak se askush

nuk mund të jetë mbi ligjin. Nuk ekziston njeriu për shtetin, por shteti ekziston për njeriun", ka thënë zëdhënësi Demiri. Fushata u nis në fillim të muajit janar ku kreu i komunës së Gostivarit, Arben Taravari, paralajmëroi se do të denoncojë të gjitha abuzimet e bëra nga ana e ish udhëheqësisë së komunës së Gostivarit dhe ato që i ka konstatuar revizioni i brendshëm.

Rivitalizimi i Kodrës së Diellit, mision i pamundshëm!



Nga
Mislim ZENDELI

Që një zonë malore të merr epitetin Qendër Turistike Dimërore, duhet t'i plotësojë disa parakushte: Mes tjerash të ketë ditë me diell, borë të qëndrueshme, arritshmëri të lehtë, afërsi me aeroportet dhe nyjet kyçe të komunikacionit rrugor dhe atij hekurudhor, shtigje për të gjitha llojet e sporteve dimërore, si dhe infrastrukturë hoteliere-turistike, mundësi për zgjerim të shtigjeve dhe hapësira të tjera të nevojshme. Me këto dhe shumëçka tjetër posedon Qendra turistike Kodra e Diellit, qendër kjo për shumëçka e pakrahueshme me qendrat simotra në Maqedoni dhe më gjërë. Ka kohë që në opinion shtrohen dilemat nga këndvështrimet e ndryshme për mundësinë e rikthimit të shkëlqimit të njërave prej qendrave më të njohura turistike dimërore jo vetëm në Maqedoni por në Ballkan e më gjërë. Duke parë se si me dekada po shkatrohet edhe ajo pjesë e mbetur e infrastrukturës turistike, dashamirët dhe simpatizuesit e kësaj qendre formuan një shoqatë "enkase" për këtë qëllim, me një mesazh mjaft të qartë "Ta mbrojmë Kodrën e Diellit".

Të rinj dhe pleq anëtarë të kësaj shoqate dhe shumë të tjerë, kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për të ndërgjegjësuar popullatën dhe institucionet përkatëse, me qëllim të gjetjes së rrugës së duhur për rivitalizimin e kësaj qendre dhe rikthimin e shkëlqimit të saj, por, fatkeqësisht të gjithë u anashkaluan nga faktori politik shqiptar, i cili ka për detyrë të ngrit çështje të tilla në organet dhe institucionet më të larta shtetërore. Megjithatë për arsye të panjohura kërkesat dashamirëse të kësaj shoqate, vazhdimisht kanë hasur në vesh të shurdhër apo janë neglizhuar. Që të kuptohet esenca e problemit në fjalë, do të nisemi nga definimi i nocioneve kyçe. Rivitalizimi paraqet një proces të ngritjes dhe zhvillimit të potencialeve turistike, të cilat një kohë të gjatë kanë realizuar qarkullime të solide turistike. Ky proces nënkupton përdorimin dhe vitalizimin e të gjitha mjeteve qoftë të atyre organizative, financiare, politike, ekonomike, sociale dhe të tjera, në drejtim të realizimit të një "cam backu" apo një jete të re të kësaj qendre, të falur nga natyra por të lënë pas dore nga njeriu.

Pra intenca e të gjitha përpjekjeve që kanë bërë aktivistët e shoqatës së lartpërmendur dhe shumë entuziastë të Malit Sharr është përdorimi i të gjitha mundësive dhe mjeteve, për rikthimin e e Kodrës së Diellit në po-



ziten e merituar nëtregun turistik. Pra, kemi të bëjmë me një çështje komplekse që kërkon angazhim dhe organizim të nivelit më të lartë apo një projekt gjithëpërfshirës, në të cilin do të kyçen parasë gjithash universitetet, respektivisht ekspertët e fushës së turizmit, të cilët në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe ato lokale me organizatat e shoqatave e sektorit civil, dhe veçmas me banorët e fshatrave që i përkasin hapësirës gjeografike dhe ndarjes teritoriale, të bashkëprojnë për t'i dhënë impuls kësaj fushe të zhvillimit. Në këtë projekt fillimisht duhet të analizohen faktorët që kanë çuar në këtë gjendje, ambienti politik, ekonomik, social dhe kulturor, që më pastaj të jepjen rekomandime dhe forma të veprimit aksional.

Jo rastësisht e theksova politikën,

sepse mendoj se aty është nyja gordiane e problemit. Le të jem i gabuar, por politika diskriminuese që bëhet ndaj gjithë asaj që është shqiptare është pjesë e injorimit respektivisht "lënies në harresë" të Kodrës së Diellit. Politikbërësit maqedonas të të gjitha ngjyrave tentuan me çdo kusht ta injorojnë këtë "parajs" të turizmit dimëror. Inatet shkuan deri në atë shkallë sa që tentuan me çdo kusht të investojnë dhe të ngrisin qendra të reja dimërore atje ku nuk kishte parakushte klimaterike, reliefe, strukturore e as kushte hapësinore, etj. E tillë ishte iniciativa e ndërtimit të qendrës dimërore sportive "Kozhuf" afër Strumicës, e cila fundosi shumta të mëdha financiare. Sjellja anashkaluese kundrejt investimeve që duhet bërë edhe në rajonet ku jetojnë shqiptarët, pra edhe

Politikbërësit maqedonas të të gjitha ngjyrave tentuan me çdo kusht ta injorojnë këtë "parajs" të turizmit dimëror. Inatet shkuan deri në atë shkallë sa që tentuan me çdo kusht të investojnë dhe të ngrisin qendra të reja dimërore atje ku nuk kishte parakushte klimaterike, reliefe, strukturore e as kushte hapësinore, etj




në Qendrën Turistike dimërore e verore Kodra e Diellit, daton që nga shturja e ish Jugosllavisë. Janë të njohura faktet se që nga 1985 e këndeje në këtë qendër, nuk është "ngulur" as edhe një gozhdë siç thotë populli.

Nga ana tjetër, Qendra dimërore "Zare Lazarevski" në Mavrovë konkurrenca të sforcuar i saj, përmes ndarjes teritoriale iu shkëput komunës së Gostivarit, shumë shpejtë iu fal një koncesioneri — maqedonas emigrant nga Australia me qëllim që dilet nga "rrethi i rezikshëm i shqiptarëve". Dihet mirëfilli se në këtë qendër pas investimeve të bëra është ngritur një infrastrukturë përkatëse, që mundëson ardhjen e vizitorëve vendor dhe turistëve të huaj. Atë madje e ndihmuan edhe në forma të tjera, si bie fjala me akordimin e kredive të volitshme. Megjithatë si për "inat" edhe sot e kësaj dite, përkundër ndihmave financiare dhe promovimeve të shumta që bëhen me qëllim të drejtimit të klientellës kah kjo qendër, përsëri nuk po arrihen dot rezultatet e dëshiruara.

Nga ana tjetër partitë politike shqiptare në pushtet por edhe ato në opozitë, nga neglizhenca apo mosinteresi, as që kanë dashtur të merren me këtë temë. Edhe pse qendrat e vendosjes për krijimin e strategjive, prioriteteve dhe investimeve në fushën e turizmit dimëror e anashka-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 29 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

lojnë Kodren e Diellit, përsëri natyra e ka falur këtë vend të bekuar, me të gjitha parakushtet e nevojshme si një qender të mirëfillt turistike dimërore.

Që të lëvizin gjërat nga zeroja, është e domosdoshme të ndërmerren aktivitete për zhvillimin e modelit të revitalizimit të Kodrës së Diellit. Ky organizim gjithëpërfshirës mund të jetë në formë të një programi të veprimit të të gjitha subjekteve të interesuara për rivitalizimin e kesaj qendre, e që konsiston në:

- Inicimin eçështjes së transferimit të pronësisë komunës së Tetovës, të cilës i takon gjeografikisht Kodra e Diellit;

- Promovimin e zhvillimit dhe integritet të turizmit katër stinor, me të gjitha produktet turistike;

- Ndalimin e menjëhershëm të shkatërrimit të objekteve të infrastrukturës ekzistuese dhe të mjedisit;

- Ndalimin sa më të shpejtë të ndërtimeve të egra në rajonin e vikend shtëpizave;

- Përpilimin e një plani hapësiror të qendrës dhe rrethinave të saj;

- Analizimin e mundësisë të dhënies me koncesion një investitor të huaj apo vendas me kontrata konkrete zhvillimore;

- Riformulim i destinacionit turistik Kodra e Diellit dhe promovimi i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, i bazuar në pasuritë natyrore të kësaj zone, që nënkupton, mbrojtje të mjedisit, zhvillim ekonomik dhe punësim për banorët e lokalitetit. Kjo do të ndalon dhe emigrimin e popullatës nga këto zona;

- Marrjen e iniciativës për trajnimin dhe zhvillim të burimeve njerëzore, të cilat janë të lidhura me profilet e kërkuara, siç janë gastronomët, blegtarët, bletarët, kopshtarët dhe të ngjashëm;

- Trajnim të popullatës lokale për thithjen e mjeteve për projekte që financohen nga fondet e ndryshme të BE;

- Zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve integrale turistike në rajon në veçanti në tregun turistik shqiptar, duke krijuar një destinacion turistik unik kombëtar;

- Përmirësimin dhe renovimin e infrastrukturës për turizëm dhe rindërtim i shtigjeve të skijimit, çiklizëm, alpinizëm etj.

Bashkërenditja e veprimtarive të të gjitha subjekteve shtetërore, rajonale e komunale, arsimore dhe ekonomike, është nevojë e domosdoshme dhe imediate për realizimin e qëllimeve të lartshënuara, ndërkaq mbështetja nga faktori politik shqiptar si domosdoshmëri, as që diskutohet. Preferohet që kësaj t'i paraprijnë debatet shkencore, me qëllim të bërjes publike të problemit në fjalë.

(Autori është profesor universitar)

Kur shqiptarët bëjnë “dy dëbime, në një ditë”



Nga Alfred PEZA

Ehëna e 26 marsit 2018 do të mbahet ndoshta mend më gjatë se çë menjëherë sot, po të kemi parasysh se Shqipëria dhe Kosova, Tiranë dhe Prishtina kanë bërë dy dëbime në një ditë, të pamenduara më parë. Sigurisht nuk është rastësi që kanë qenë në të njëjtën ditë, pothuajse në të njëjtën kohë, pavarësisht se njëra në ambientet e ministrisë së Jashtme të Shqipërisë dhe tjera në Mitrovicën e Veriut, në Kosovë.

Shqipëria ka njoftuar dëbimin e dy përfaqësuesve të rëndësishëm diplomatikë, të ambasadës së Republikës Ruse. Ndërsa policia e Kosovës arrestoi dhe më pas dëboi shefin e zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë Marko Gjuric, i cili bashkë me sekretarin e përgjithshëm të presidentit të Serbisë, Nikola Selaković, hynë në Mitrovicë jashtë rrugëve të ligjshme. Për ministrin e Jashtëm të Shqipërisë Ditmir Bushati vendimi është një veprim i koordinuar me partnerët tanë të NATO, në përgjigje të zhvillimeve të fundit sidomos për rastin e bërë publik në Britaninë e Madhe, ku u sulmua me shumë gjasë, me lëndë helmuese ushtarake një ish agjent i shërbimeve sekrete ruse, bashkë me vajzën e tij. Për Bushatin nuk është rastësi që në Ballkanin Perëndimor kanë ndodhur disa ngjarje, dhe sot për sot kemi pozicionime

edhe të vendeve që janë apo që aspirojnë të jenë anëtarë të BE, përkundrejt thirrjeve që kanë ardhur nga SHBA apo Mbretëria e Bashkuar, për një rreshtim në kampe mbi bazën e disa vlerave të cilat ne i mbrojmë dhe duhet t'i promovojmë.

Avokat Ngjela e shpjegoi këtë zhvillim me teorinë e Kantit, i cili thotë se “po ndodhi njëherë është rast, kur përsëritet është raport”. Për të e gjitha çka ndodhi ka lidhje të drejtpërdrejtë: Ka filluar eskaloni për sqarimin e plotë të çështjes shqiptare dhe për të ndaluar çdo veprim subversiv të Moskës, Beogradit dhe Athinës. Këtu është luftë e nxehtë. Është interesi i dy fuqive, Uashingtonit dhe Moskës dhe sigurisht që do fitojë Uashingtoni”. Të gjitha këto mund të na orientojnë drejt asaj se çfarë ka ndodhur në të vërtetë.

Ndaj duhet të pranojmë se për shqiptarët kjo ditë është shumë e rëndësishme. E para, sepse treguam që të dyja shtetet shqiptare në Ballkan ishin të sinkronizuar jo vetëm mes vete, por edhe me të gjithë aleatët e tjerë perëndimorë në Europë dhe SHBA.

E dyta, ky nuk ishte një akt lufte kundër Rusisë apo Serbisë, por një demonstrim i qartë i përkatësisë sonë perëndimore, si pjesë e saj dhe e aleancës natyrale me të. E tre-

ta, ky rreshtim i shqiptarëve në Ballkan, në planin ndërkombëtar, shënon edhe një vijë të qartë për rreshtimin e brendshëm të forcave, rrymave dhe orientimeve pro perëndimore, apo antimperëndimore. E për rrjedhojë pro orientimit strategjik kombëtar shqiptar, apo kundër tij, për sot e në të ardhmen. E katërta, është ndoshta hera e parë pas 1990 që Shqipëria ndërmerr një veprim kaq të fortë kundër një fuqie botërore si Rusia, pa patur frikën e pasojave që mund të sjellë ajo, pavarësisht kostove. E njëjta gjë edhe për policinë e Kosovës, e cila e ndërmori veprimin në atë pjesë të territorit të shtetit të Kosovës, i cili “de facto” në terren kontrollohet nga serbët. Çka tregon se qeveria e Kosovës ka potenciale për kontrollin e gjithë hapësirës së saj territoriale nesër, sigurisht me mbështetjen e aleatëve. Dhe e fundit, fundit politika ndërkombëtare dhe qenia ose jo aktor ose faktor i saj sado minor, është akt. Shqiptarët nuk kanë nguruar që ta bëjnë aktin e tyre. Një akt i munguar deri dje, që tregon se sot e tutje, raporti ynë me perëndimin, por edhe me Rusinë dhe aleatët e saj, nuk do të jetë më si më parë. Për mirë apo për keq, kjo mbetet për tu parë. E sigurt është se jemi rreshtuar në anën e duhur të historisë.

(Alpenews.al)

Bashkë kundër Rusisë



Nga Robert SCHWARTZ

As lidhjet ekonomike dhe politike tradicionale të ngushta me Rusinë nuk patën efekt. Shumica e vendeve europianolindore u renditën në aferën Skripal pas Britanisë së Madhe e perëndimit duke dëbuar kështu diplomatë rusë. Nëse në vendet perëndimore përmendet solidariteti me Britaninë e Madhe si argument, në vende si Shqipëria, Ukraina apo Republika e Moldavisë ky dëbim është më shumë rezultat i një pragmatizmi politik. Megjithatë ky hap i këtyre vendeve nuk të habit edhe aq shumë. Shqipëria që për afro gati dhjetë vjet është anëtare e NATO-s kërkon aktualisht të negociojë për anëtarësim në BE.

Kështu ky është një rast i mirë për këtë vend të veprojë si europiane e bindur. Në një kohë që si Shqipëria, ashtu edhe Maqedonia apo Rumania, tradicionalisht kanë mbajtur qëndrime kundër rusëve. Tek dy ish-republikat sovjetike, Ukraina dhe Moldavia qëndrimi kundër Rusisë është më i thellë. Aneksimi i Krimesë, agresioni rus në lindjen ukrainase si edhe prezenca e vazhdueshme ruse në rajonin e shkëputur moldav të Transnistrisë luajnë një rol të rëndësishëm në dëbimin e diplomatëve rusë.

Hije mbi këtë aksion hedh fakti që BE

megjithatë nuk u paraqit unike, dhe vende si Austria, Bullgaria, Greqia tregohen të rezervuara me dëbimin. Por megjithë rezervat e pak vendeve, shtetet demokratike si në Perëndim ashtu edhe Lindje të Europës dalin të bashkuara ndaj sjelljes agresive prej vitesh të Rusisë.

Numri i ndryshëm i diplomatëve të dëbuar nuk duhet parë si dobësi. Një diplomat apo 60, jo shifra por simbolika e aktit ka efekt në politikën ndërkombëtare. Këtë e kanë kuptuar edhe vende si Italia apo Hungaria qeveritë e të cilave kanë reaguar deri më tani miqësisht ndaj Rusisë.

Po Austria? Qeveria e re i referohet neutralitetit të republikës së alpeve dhe funksionit fisnik të urëlidhës në diplomacinë ndërkombëtare. Vjena tërhoqi vetëm ambasadorin e saj në Moskë.

Mbetet Bullgaria, krenare që këtë gjysmë viti është presidente e radhës në BE dhe që

Me dëbimin e diplomatëve rusë edhe vendet lindore, anëtare ose jo anëtare të BE-së janë rreshtuar pas vendeve perëndimore e Britanisë së Madhe. Por jo të gjitha vendet europiane



mund të prezantohej nga ana e saj më europiane. Por me qëndrimin kundër dëbimit të diplomatëve, Sofja ka devijuar nga arritja e këtij qëllimi. Lidhjet tradicionale me Moskën duken më të forta se solidariteti europian. Për një president të radhës në BE jo sinjali më i mirë. Tek grupi i vogël i refuzuesve bën pjesë edhe Greqia. As këtu nuk e ka dobësuar lidhjen e ngushtë me Rusinë, ombrella financiare e shpëtimit të BE. Athina sërish tregoi, se xhonglon pa problem me alternativat. Por edhe xhonglerit më të mirë i shpëton diçka.

Me interes priten masat, me të cilat kërcënon Moska. Varet nga Rusia dhe presidenti i por-sazgjedhur rus, Vladimir Putin nëse shkallëzimi do të vazhdojë. Një pjesëmarrje e Rusisë në zbardhjen e skandalit me gaz helmues me siguri është zgjidhja më e mirë se sa mbyllja e Institutit Kulturor Britanik. (DW)

Të shmangeni nga situatat kur tërhiqni vëmendje si jeni amerikan. Rishikoni planet rreth sigurisë suaj personale: Kriminelët dhe terroristët mund të monitorojnë lëvizjet tuaja. Ndryshoni rrugën dhe kohën e lëvizjes që të jeni cak më i paparashikueshëm.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, ka paralajmëruar qytetarët amerikan për rrezik të shtuar të sulmeve terroriste në Kosovë gjatë festave katolike dhe ortodokse.

Në njoftim thuhet se qytetarët amerikan duhet të tregojnë kujdes për shkak se ekstremistët përqendrohen në vendet turistike.

"Departamenti i Shtetit dëshiron të paralajmërojë qytetarët amerikanë për rrezikun e shtuar të sulmeve terroriste në Kosovë, veçanërisht gjatë stinëve të festave. Qytetarët amerikanë duhet të

NJOFTIM I AMBASADËS SË SHBA NË KOSOVË

RREZIK NGA SULMET TERRORISTE PËR PASHKË



njoftimin e ambasadës amerikane në Prishtinë.

Më tej kjo ambasadë ka dhënë disa udhëzime lidhur me kujdesin që duhet të kenë qytetarët në këto ngjare.

Udhëzimet e plota nga SHBA: "Mos tërhiqni vëmendje: Të jeni në dijeni për profilin tuaj në publik dhe të shmangeni nga situatat kur tërhiqni vëmendje si jeni amerikan.

tregojnë kujdes në festimet e festës dhe në ngjarjet rreth festimeve katolike dhe ortodokse të Pashkëve".

"Ekstremistët vazhdojnë të përqendrohen në vendet turistike, qendrat tregtare, bare [kafene], shtëpitë e adhurimit dhe objektivat e tjera. Ju lutemi të ushtroni vigjilencë shtesë në këto vende dhe vende të ngjashme", thuhet në

– Rishikoni planet rreth sigurisë suaj personale: Kriminelët dhe terroristët mund të monitorojnë lëvizjet tuaja. Ndryshoni rrugën dhe kohën e lëvizjes që të jeni cak më i paparashikueshëm.

– Keni kujdes nga ajo që rrethoheni: Identifikoni lokacionet dhe dalje emergjente ose shërbime të sigurisë Gjykatën Kushtetuese

Gjykatën Kushtetuese Gjykatën Kushtetuese Gjykatën Kushtetuese Gjykatën Kushtetuese Gjykatën Kushtetuese në zona publike.

– Shmanguni turmave/demonstratave: Nëse jeni në zona ku mbledhen turma (festime, demonstrata, etj) provoni që të largoheni nga aty, apo së paku, kaloni në cep të turmës, aty ku nga mund të largoheni më lehtë nëse është e nevojshme.

– Jeni vigjilent në lokacionet e frekuentuara nga turistët.

– Monitoroni informacionet e fundit nëpër media lokale. Shikoni mediat sociale, TV dhe paralajmërimet në radio, apo institucione si Ambasada e SHBA-së ose Konsullata më e afërt", njofton ambasada Amerikane në Kosovë.



Taksa e "Rrugës së Kombit", Rama fajëson Berishën

Debati për tarifën në "Rrugën e Kombit" është zhvendosur në sallën e Kuvendit të Shqipërisë ku kryeministri Edi Rama ka dhënë sqarimet e tij, ku bëri të ditur se banorët e zonës nuk do të përjashtohen nga ky tarifim. Ai tha se tarifimi i rrugës e ka zanafillën nga viti 2010, nga ish kryeministri i PD-së, Sali Berisha i cili sipas tij është shprehur se qeveria nuk e mirëmban dot rrugën.

"Vendimarrja për të vendosur jo taksë, se nuk është taksë, është tarifë për përdoruesit, e rrugës së Kombit e ka zanafillën në vitin 2010. Në atë kohë kryeministri i kohës ka marrë iniciativën për të hapur këtë proces. Ka thënë publikisht si rrallë në karrierën e tij atë që sot si gjithmonë në karrierën e tij e mohan. Ne e ndërtuam për ta mirëmbajtur, nuk e mirëmbajmë dot", ka thënë Rama.

Në anën tjetër, ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj në mbledhjen e Qeverisë ka folur për taksën rrugore të vendosur në "Rrugën e Kombit". Për Lekajn, një taksë e tillë është e papranueshme. Ai ka thënë se për këtë i ka shkruar letër homologut të tij shqiptar. Lekaj ka bërë të ditur se ka kërkuar që të ketë bisedime me Qeverinë e Shqipërisë për këtë taksë.



Negociata serioze mbi Kosovën po zhvillohen në SHBA

Në Amerikë po zhvillohen "negociata serioze mbi mundësinë e zgjidhjes së çështjes së Kosovës", në të cilat është përfshi ish-ambasadori Amerikan në Serbi, Kameron Manter, shkruan sot gazeta beogradase "Danas", transmeton gazeta KOHA. "Neogociata paralele prapa perdeve nuk janë të pëleqyera nga BE, e cila po ndërmjetëson në Bruksel, dhe kundër kësaj është kryesisht Gjermania", saktëson gazeta duke u thirrë në burime anonime. "Danas" përkujton se ambasadori Manter ka formuar organizatën "Lindje-Perëndim" dhe gjatë hapjes së saj vitin e kaluar kishte inicuar "dialogun e brendshëm në Serbi" mbi Kosovën.

Ndërkaq, nga burime diplomatike, gazeta "Danas" merr vesh se kishte qenë iniciativa e Federica Mogherinit për të udhëtuar me urgjencë të martën në Beograd, me ç'rast takoi presidentin Serb, Aleksandar Vuçiq, një ditë pas zhvillimeve dramatike në veriun e Kosovës, transmeton gazeta KOHA.

Demarkacioni, Vetëvendosje i drejtohet Gjykatës Kushtetuese



Deputeti i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese projektligjin për Demarkacionin.

Ai tha se deputetët e kanë shkelur këtë vendim që është antikushtetues dhe që është delimitim në vend të demarkimit.

Sipas tij gjyqësori është i kapur dhe Gjykata Kushtetuese nuk bën përjashtim nga gjendja e përgjithshme, por se sipas tij si deputetë duan që vazhdimisht t'i përmirësojnë institucionet e vendit. "Ne shpresojmë se ashtu sikurse ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese për 'Zajednicën', shpresojmë që edhe për demarkacionin të gjejë ato shkelje", tha Konjufca.

ARRESTOHEN DREJTUESIT E LOEGJEVE TURKE

Haradinaj sqaron arsyet

Policia e Kosovës sot ka arrestuar pesë drejtues të kolegjit "Mehmet Akif" në Prishtinë dhe Gjakovë përkatësisht të Mustafa Erdem, Yusuf Karabina, Kahraman Demirez, Cihen Ozkan dhe Hasan Gunakan, por që ende nuk janë konfirmuar arsyet e arrestimit. Lidhur këtë Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj theksoi se arsyeja e ndalimit të udhëheqësve të shkollës Mehmet Akif ka të bëjë me mos respektim të procedurave të qëndrimit në Kosovë. "Këto janë ndalime. Kam kërkuar informacion nga Policia dhe nga institucionet tjera. Arsyeja e ndalimit është se mënyra e qëndrimit, është e pade-



finuar. Për të huajt që vijnë në Kosovë janë disa procedura për qëndrim dhe jemi të detyruar t'i zbatojmë ndaj të gjithëve", tha Haradinaj. Ai ka shtuar se beson që kjo është arsyeja e arrestimit, por është zotuar se do të interesohet më shumë rreth kësaj çështje.

"Sa di unë arsyeja e ndalimit është vetëm kjo, pra është mungesë e respektimit të procedurave në Kosovë. Nuk besoj që ka të bëjë me aspekte të tjera dhe do të interesohem më tutje për këtë temë", tha Haradinaj. Kolegji "Mehmet Akif" ka njoftuar se sot në

mëngjes është arrestuar drejtori i institucioneve "Gulistan" Mustafa Erdem dhe zëvendesi i tij Yusuf Karabina, drejtori Kahraman Demirez, Cihen Ozkan dhe Hasan H. Gunakan. Lidhur me këto arrestime Policia e Kosovës për rtv21.tv ka konfirmuar se është në realizim të një operacioni policor, por nuk kanë dhënë detaje tjera. Jo zyrtarisht mesohet se ky aksion është duke u bërë për arrestimin e përkrahësve të klerikut turk në mërgim, Fetullah Gylenit. Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, e fajëson Gylenin për orkestrimin e përpjekjes për grushtshtet në Turqi, në vitin 2016.



Zjarr në një burg të Venezuelës, 68 të vdekur

Të paktën 68 persona e kanë humbur jetën si pasojë e zjarrit i cili shpërtheu në burgun brenda një stacioni policor në rajonin Carabobo në Venezuelë. Prokurori shtetëror, Tarek William Saab, konfirmoi se në zjarrin i cili shpërtheu në burg, jetën e kanë

humbur të paktën 68 persona. Zjarrin i kishte paraprirë një rebelim i personave të cilët po mbahehin në burgun brenda stacionit policor dhe siç njoftohet, në mesin e të vdekurve janë edhe dy gra të cilat ishin dërguar në paraburgim natën e kobshme të zjarrit. Stacio-

ni policor ndodhet në qytetin Valencia, 160 kilometra nga kryeqyteti Caracas. Aktualisht po kryhen hetime, në të cilat janë përfshirë katër prokurorë. Burime lokale thonë se me gjasë, zjarri është shkaktuar nga ndezja e dyshekëve të krevateve.

Ekonomia e Turqisë rritet për 7.4 për qind në 2017

Instituti Statistikave të Turqisë (TÜİK), ka njoftuar se ekonomia e Turqisë ka shënuar rritje për 7.4 për qind në vitin 2017. Instituti Statistikave të Turqisë (TÜİK) ka shpallur rezultatet e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të përlogaritura me metodën e prodhimit për vitin 2017. Sipas kësaj, tekta ekonomia e Turqisë ka treguar rritje me 7.4 për qind vitin e kaluar thuhet se rritja në tremujorin e fundit të vitit ka qenë 7.3 për qind. Sipas metodës së prodhimit, me çmimet aktuale PBB-ja u rrit me 19 për qind në vitin 2017 krahasuar me vitin e kaluar. Në analizën e aktivitetëve që përbëjnë PBB-në, në vitin 2017, vlera e shtuar e sektorit të bujqësisë u rrit me 4.7 për qind, sektori industrial me 9.2 për qind dhe sektori i ndërtimit me 8.9 për qind. Gjithashtu vlera e shtuar nga sektori i shërbimeve, i cili përbëhet nga aktivitetet e shërbimeve të tregtisë, transportit, akomodimit dhe ato ushqimore shënuan rritje me 10.7 për qind. Vlera e PBB-së për kokë banori, me çmimet aktuale në 2017 u llogaritën si 38.660 lira turke (10.597 dollarë). Kjo vlerë, në vitin 2016 ishte përcaktuar si 32.676 lira turke (10.807 dollarë). Edhe ekonomistët, të cilët morën pjesë në "Anketimin e Pritshmërisë së Rritjes" të AA Finance, kishin parashikuar një normë mesatare rritjeje prej 7.3 për qind deri në fund të vitit 2017.

Kur është fjala për të ardhmen e Rusisë, Dmitri Oreshkin është pesimist. Ai thotë se rusët mund të presin të ketë pak, ose aspak ndryshim, ndërsa Putini vazhdon ta udhëheqë vendin sipas modelit të tij. Ç'do të ndodhë në vitin 2024, kur ai të mos ketë më mundësi të kandidojë për postin e presidentit?

Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale të 18 marsit në Rusi, sollën pak surpriza si për rusët, edhe për Perëndimin. Presidenti Vladimir Putin do të vazhdojë ta drejtojë vendin në 6 vjetët e ardhshëm. Por ndërsa Kremli këmbëngul se zgjedhjet ishin të drejta dhe transparente, një numër analistësh për Rusinë kanë shprehur shqetësim dhe parashikojnë një krizë vazhdimësie në vitin 2024.

Me zgjedhjet e 18 marsit, Vladimir Putin e ruajti pushtetin në Rusi; ai do ta udhëheqë vendin edhe për 6 vite të tjera. Sekretari i Shtypit i zotit Putin, Dmitry Peskov, thotë se rezultatet flasin vetë: "Zgjedhjet e 18 marsit treguan se shoqëria jonë është plotësisht e konsoliduar. Ajo nuk është e tillë për shkak të sulmeve nga dikush, por në sajë të planeve për zhvillimin e vendit në të ardhmen, gjë që e tregoi edhe rezultati i zgjedhjeve". Shumë analistë nuk e shohin kështu këtë çështje. Mes tyre, disa studiues rusë të shkencave politike me pikëpamje progresive, që u intervistuan nga shërbi-

CILA DO TË JETË E ARDHMJA E RUSISË?



mi rus i Zërit të Amerikës. Mes tyre, është Dmitry Oreshkin: "Putini fitoi. Por cili është shqetësimi? Zgjedhjet i ngjanë atyre të periudhës sovjetike. Pikësepari, nuk pati alternativa të besueshme ndaj Putinit. Edhe në votimet sovjetike, kishte vetëm një emër në fletën e votimit. Së dyti, elektorati u çua në votime. Njerëzit nuk mund të marrin mbi vete rrezikun për të patur një qëndrim të tyrin politik. Bosët e tyre u thonë se duhet të shkojnë në votime, dhe ata shkojnë..."

Një tjetër analiste, Ekaterina Schulmann, mendon se zgjedhjet mund të mos kenë qenë të drejta: "Një nga skandalet paszgjedhore

është deklarata e Ministrit të Brendshëm rus Sergey Shoigu, se 99 për qind e ushtarakëve dhe familjeve të tyre votuan dhe 89 për qind e tyre mbështetën komandantin e përgjithshëm të Rusisë. Kjo është çmenduri, sepse ushtarakët votojnë në të njëjtat qendra votimi si njerëzit e tjerë, (me përjashtim të atyre që ndodhen në baza jashtë vendit). Nuk ka asnjë mënyrë të mësohet se për kë kanë votuar ata. Kjo e bën deklaratën e ministrit ose spekulative, ose provon se janë bërë mashtrimet". Kur është fjala për të ardhmen e Rusisë, Dmitri Oreshkin është pesimist. Ai thotë se rusët mund të presin të ketë pak, ose

aspek ndryshim, ndërsa Putini vazhdon ta udhëheqë vendin sipas modelit të tij. Ç'do të ndodhë në vitin 2024, kur ai të mos ketë më mundësi të kandidojë për postin e presidentit?

"Kush do të jetë pasuesi i Putinit? Ai vetë. Nuk e dimë se në çfarë roli, si kryeministër, apo si udhëheqësi i një shteti të ri, por ai ka për ta patur të vështirë të largohet nga pushteti dhe çdo vit ka për të qenë edhe më e vështirë", thotë Oreshkin. Studiuesi Oreshkin thotë se cilitdo që do të vijë në pushtet pas Putinit, do t'i duhet të gjejë mënyra për të kënaqur elitat dhe për t'i qëndruar besnik paraardhësit të tij. (voa)

FACEBOOK MUND T'I PAGUAJ BRITANIKËVE 625 MILIARDË PAUND

Gazeta britanike The Sun ka zbuluar se shtetasve të Mbretërisë së Bashkuar që përdorin Facebook, kompania mund të jetë e detyruar t'u paguajë më shumë se 12,500 paund secili, e gjitha kjo falë gabimeve të fundit me privatësinë e përdoruesve, që sollin edhe rënien e aksioneve në bursa. Ekspertët më të lartë ligjorë në Mbretërinë e Bashkuar kanë detajuar se si Facebook mund të duhet të paguajë

shuma të mëdha kompensimi, me një profesor të drejtësisë që sugjeron se "gjoha" mund të shkojë deri në 625 miliardë paund. Duke folur për The Sun, Dr Maureen Mapp tha: "Ka rreth 50 milionë përdorues të Facebook, të dhënat e të cilëve janë përdorur padrejtësisht". Duke supozuar se secili prej tyre do të sjellë një kërkesë për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shkelja e të dhënave... çdo individ mund t'i

jepej deri në 12,500 paund dëmshpërblim", shpjegoi profesori i Shkollës së Drejtësisë në Universitetin e Birmingham. "Në total, shuma që mund të jepet nga gjykatat mund të jetë 625 miliardë paund-50 milionë shumëzuar me £12,500 paund". Pretendimet e Dr. Mapp bazohen tek një rast ligjor i vitit 2015, ku gjashtë britanikë, të cilët ishin sulmuar nga telefoni nga gazeta Mirror, morën 12,500 paund

dëmshpërblim secili - thjesht për shkak se u ndienë të shqetësuar. Nëse Facebook vërtetë paditej me £625 miliardë, kjo do të shkatërronte firmën e Zuckerberg, e cila ka një vlerë prej 317 miliardë paund. Avokati Barda beson se shifra e dëmshpërblimit do të jetë shumë më e ulët, sepse duke u hakuar nga telefoni është "më shumë shqetësues", sesa dhënia e lejes nga Facebook për përdorimin e të dhënave

tuaja private. "Unë mendoj se një shifër shumë më realiste është 500 paund për secilin që paraqet kërkesë për dëmshpërblim", tha ai. "Shuma e kompensimit do të varet nga niveli i shqetësimit të pësuar, por Facebook mund të ballafaqohet me pretendime deri në 500 euro për përdoruesit e Facebook, nëse këta përdorues do jenë në gjendje të demonstrojnë shqetësimin e tyre.



МАКЕДОНСКИ ШУМИ
во партнерство со природата

www.mkdsumi.com.mk

Ул. "Трпо Нанов" Бр.128; 1000 Скопје; Р. Македонија
Тел: ++389 (0)2 2581080 Факс: ++389 (0)2 2581824

Në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2013, 69/2013, 27/2014, 42/2014, 178/2014, 180/2014, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18), Vendimin e Këshillit drejtues të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup nr. 02-230/4 të datës 09.03.2018 dhe nenit 35 të Statutit të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup, Drejtori i NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup publikon

SHPALLJE nr. 01/2018

PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS AFARISTE përmes ankandit elektronik

1. LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është dhënie me QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE – (për herë të parë) që janë në pronësi të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup.

Hapësirat afariste nga pasqyra tabelore jepen për periudhë prej 5 vjet me mundësi për vazhdim të marrëveshjes.

2. TË DHËNA PËR MJETIN E PATUNDSHËM I CILI JEPET ME QIRA

Numri rendor	Numri i PK, KK dhe Lista pronësore	Objekti afarist Përshkrim, adresa	Sipërfaqja e brendshme e përgjithshme m ²	Vlera e përgjithshme e vlerësuar e hapësirës afariste (në denarë)	Çmimi fillestar për qiranë mujore (në denarë, pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës 2% e vlerës së përgjithshme të vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha dhe data e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1.	PK 1688 KK Ginovc LP 883	Adresa: Ara e madhe Ndërtesa 3 – hyrja 1 dhe 2 – 805m2 Ndërtesa 6 – hyrja 1 – 11 m2 Ndërtesa 7 - hyrja 1 – 10 m2	826 m2	3.973.269,00 den	19.865,00 den	79.465,00 den	10 ditë nga dita e shpalljes	12.04.2018 në ora 10.30

Qiraja paguhet në denarë.

Qiraja në marrëveshje për qira do të shprehet në neto shumë – pa TVSH. Tatimi i vlerës së shtuar shprehet në faturë të posaçme.

Qiramarrësi është i obliguar qiranë ta paguajë para kohe, më së voni në ditën e 5-të muajt, pavarësisht të pranimit të faturës. Për pagesë të vonuar të qirasë do të llogaritet interesi ligjor për vonesë.

Mos pagesa e 2 (dy) qirave të njëpasnjëshme mujore, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies në qira, paraqet bazë për aktivizimin e mjeteve për siguri dhe bazë për anulim të marrëveshjes nga ana e NP Pyjet e Maqedonisë Shkup.

3. TË DREJTË PËR Pjesëmarrje

1. **Persona fizik:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Persona juridik:** personi lokal juridik, personi juridik në pronësi të përzier, personi fizik në pronësi të përzier, personi juridik i themeluar nga personi i huaj fizik dhe juridik, i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, persona të huaj juridik rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe persona juridik shtetas të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Objekti afarist jepet me qira dhe i njëjti mund të vizitohet çdo ditë pune prej ora 12.00 deri në ora 15.00 me paralajmërim paraprak dhe prezencë të përfunduar nga NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup.

4. KUSHTET PËR Pjesëmarrje në ankandin publik elektronik:

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrorë **Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, e cila dërgohet përmes rrugës elektronike për secilën hapësirë afariste veç e veç dhe duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë**, në pajtim me kushtet e Shpalljes, me shtojcat në vijim:

1. Fletëparaqitje të plotësuar dhe nënshkruar personalisht nga parashtruesi në të cilën janë dhënë të dhënat e përgjithshme të ofertuesit (emri, mbiemri, adresa e saktë, cilat dokumente dorëzohen me fletëparaqitjen), në pajtim me kushtet e Shpalljes;

2. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumë prej -----(2% e shumës së vlerësuar) me afat prej 60 ditë nga dita e ankandit publik ----(të shënohet numri rendor i pasqyrës tabelore dhe dresa se ku gjendet objekti afarist). Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

3. Deklaratë të vërtetuara në **NOTER** se në çfarëdo baze nuk ka të papaguara obligime ndaj NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup

4. Vërtetim se nuk është hapur procedurë për falimentim ose likuidim.

5. Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar masë për sigurim: ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

6. Dëshmi për identitet

- Për personat fizik certifikatë të shtetësisë, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Për personat juridik gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, (nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj të dorëzohet dokument përkatës ku ofertuesi është regjistruar të dhënë nga organi kompetent ose deklaraturë në noter të vërtetuar tek organi kompetent – me përklthim).

7. E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do ti dërgohen emri përdorues dhe shifra për qasje në internet faqen në të cilën do të realizohet ankandit publik elektronik.;

Dokumentet me numrat rendor 1, 3, 4, 5 dhe 6 duhet të skanohen në një PDF dokument dhe i njëjti duhet të ngarkohet gjatë paraqitjes edhe atë në pjesën "Deklarata".

Garancia bankare (dokumenti me numër rendor 2) duhet të skanohet në PDF dokument dhe të ngarkohet gjatë paraqitjes edhe atë në pjesën "Garancia bankare".

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

Krahas ngarkimit të këtyre dokumenteve përmes formës elektronike, patjetër dokumentet me numër rendor 2 (Garancia bankare – në origjinal) dhe dokumentet me numër rendor 1,3,4,5 dhe 6 – (në original ose kopje të vërtetuara në noter) të dorëzohen edhe deri në NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, në rr. Pero Nakov nr. 128 Shkup (MZT), më së voni deri në ditën e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjes.

8. AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrohen më së voni në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes, gjegjësisht duke filluar prej më 30.03.2018 deri më 08.04.2018 deri në ora 23,59 përmes formës elektronike në internet adresën www.deloven-prostor.mk.

Ankandit publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik fillon në internet faqen me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar për qira mujore të objektit afarist dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve, për secilin objekt veç e veç.

VËREJTJE:

1. Personi fizik, subjekti juridik dhe themeluesi i subjektit juridik, i cili në çfarëdo baze ka pagesa të pabaralizuara ndaj NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, nuk mund të marr cilësinë e qiramarrësit të NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup.

PROCEDURA

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni vërteton kompletimin e dokumentacionit në pajtim me kushtet e shpalljes, sipas së cilës informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.

2. Parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në afat prej 3 ditëve nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes u dërgon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar u dërgon lajmërim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

3. Parashtruesit e fletëparaqitjeve të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar për pjesëmarrje në ankandin publik në pajtim me shpalljen, në ditën e realizimit të ankandit publik regjistrohen në internet faqen e shënuar në shpallje me emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, pas së cilës kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.

4. Ankandi publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

5. Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se pas shpalljes është paraqitur edhe vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në shpallje.

6. Ankandi publik fillon me prezantimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandi publik mund të llogaritet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës nëse në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afati përfundimtar për përfundimtar të ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të ketë ofertë të re të dhënë.

7. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk pranohet oferta, gjegjësisht, nuk është dhënë çmimi më i lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar i hapësirës afariste ulet për 2% pas së cilës pjesëmarrësit në ankandin publik sërish kanë mundësi të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste.

8. Nëse me kalimin e dy minutave të fundit të pesë minutave të dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë të re.

9. Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga çmimi i përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste gjatë ankandit mund të bëhet më së shumti deri në 30% nga vlera e përcaktuar e tregut të hapësirës afariste, pavarësisht se sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik.

10. Pas përfundimit të ankandit publik, sistemi elektronik vet gjenerohet (përpilon) procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet deri tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik në mënyrë elektronike.

11. Nëse bëhet fjalë për publikim për herë të dytë, shumica e përgjithshme e vlerësuar e qirasë mujore të hapësirës afariste mund të ulet më së shumti deri në 30% nëse në ankandin publik paraqitet vetëm një pjesëmarrës i interesuar, gjegjësisht deri në 50% nëse paraqiten dy ose më shumë pjesëmarrës.

12. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri tek Komisioni, e cila vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës.

13. Për ofertues më të volitshëm llogaritet pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ka ofruar çmim të fundit më të lartë të përgjithshëm, e cila paraqet çmim më të lartë të qirasë së hapësirës afariste.

14. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të procedurës për ankandin publik duhet të sigurojë depozitë të të hollave ose garanci bankare për sigurimin e obligimeve në shumë prej 3 (tre) qirave mujore, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do ti shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankandin publik për tjetërsim ose për dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

15. Tatimi i vlerës së shtuar për shumën e qirasë mujore bien në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

16. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në momentin e lidhjes së Marrëveshjes për qira.

17. Marrëveshja për qira të hapësirës afariste lidhet për kohë të caktuar për 5 (pesë) vjet në gjendje të parë me mundësi për vazhdim dhe solemnizohet në Noter me harxhime të ofertuesit më të volitshëm dhe i njëjti do të ketë cilësinë e dokumentit ekzekutiv.

18. Nëse me faj (ndërprerje, anulim ose mënyrë tjetër) të qiramarrësit vjen deri tek ndërprerja e kësaj Marrëveshje para kalimit të afatit për të cilin është lidhur, qiramarrësi është i obliguar në afat prej 8 ditëve të ndërprerjes së Marrëveshjes ti paguajë qiradhenësit penale për ndërprerje të parakohshme të Marrëveshjes me kompensim të dëmit në shumë prej 3 (tre) qirave mujore.

Informatat më të detajuara mund të merren në selinë e NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, rr. Pero Nakov nr. 128 Shkup.

Personat për kontakt:

Lazar Lazarov tel. 071/229-468

Lazar.lazarov@mkdsumi.com.mk

Suzana Dimovska tel. 070/273-366

Suzana.dimovska@mkdsumi.com.mk

Komisioni për realizimin e procedurës për dhënie me qira të hapësirës afariste përmes ankandit publik elektronik

Koha, e premte 30 mars, 2018



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up 1 nr. 08-131
29.03.2018
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 2, nenit 82 paragrafi 1 alineja 5 dhe nenit 83 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17), ndërsa në lidhje me nenin 62 paragrafi 6 i të njëjtit ligj, nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim dhe emetim televiziv nr. 01-5774/1 të datës 21.11.2014 me ndryshim dhe plotësim nr. 01-3336/1 të datës 08.05.2015, nenit 51 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), nenit 14 të Ligjit për kontestet administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/06 dhe 150/10), duke vepruar në bazë të Propozimit Up 1 nr. 08-131 të datës 16.03.2018, për ngritje të procedurës për marrje të lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë nr. 08-1052 të datës 29.09.2015, ndërsa në pajtim me Konkluzionin nr. 02-1476/2 të datës 29.03.2018, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 19-të të mbajtur më datë 29.03.2018 ka sjellë:

VENDIM

Për marrje të lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë

1. MERRET leja për emetim televiziv, nr. 08-1052 e datës 29.09.2015 e Shoqërisë tregtare Duke patur parasysh se SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë nuk ju përgjigji as kësaj kërkesë radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, për shkak të mosplotësimit të obligimit nga neni 62 të Agjencisë, më datë 13.02.2018 deri te radiodifuzeri i theksuar është dërguar edhe letra e tretë - paragrafi 6 i Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17) dhe nenit 22 të Rregullores kërkuar ta parashtrojë menjëherë pas pranimit të letrës dhe se nëse nuk vepron në bazë të saj, për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim Agjencia do të ngriejë procedurë për marrje të lejes për emetim televiziv.

2. Vendimi publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në ueb faqen e Agjencisë nën mbikëqirje administrative, i cili bëhet për punën e publikuesve medial nga aspekti i harmonizimit të dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra gazetë ditore në gjuhën e komunitetit që nuk është shumicë, punës së tyre me kushtet e caktuara me Ligjin për media, Ligjin për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale dhe dispozitat e sjella në bazë të tij (neni 29 paragrafi 1 i Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale).

3. Ky Vendim është përfundimtar.

Arsyetimet

Shoqëria tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, është posedues i lejes për emetim televiziv, nr. 08-1052 të datës 29.09.2015, për emetim përmes rrjetit publik elektronik komunikues i cili nuk shfrytëzohet resurs të kufizuar, në nivel rajonal, për rajonin e D4 - Boskia (Radovish, Konçe, Vasilevë, Bosilovë, Strumicë, Novo Sellë, Vallandovë, Bogdanci, Dojran, Gjevgjeli), programi televiziv me format kryesisht të përgjithshëm argëtesë, në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 62 paragrafi 6 i Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, për sigurimin e emetimit televiziv ose radio emetimit krahas kushteve dhe obligimeve të përkrahura në këtë ligj, radiodifuzeri duhet të përmbushë kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike varësisht nga formati programor, të dhënë në akti nënligjor të sjellë nga ana e Agjencisë.

Në nenin 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim dhe emetim televiziv nr. 01-5774/1 të datës 21.11.2014, me ndryshim dhe plotësim nr. 01-3336/1 të datës 08.05.2015, numri dhe struktura e personave të punësuar për televizion në nivel rajonal, me përjashtim të rajonit D7, duhet të jetë së paku 10 (djetë), prej të cilëve 5 (pesë) me përgatitje sipërore profesionale (PSP), të punësuar si gazetarë.

Në lidhje me kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në rregulloren e lartpërmendur më datë 18.12.2017, nga ana e një personi fizik anorim, shërbimi profesional i Agjencisë është informuar përmes telefonit se televizioni rajonal TV Telekom A1 i cili emeton program në rajonin radiodifuziv D4 - Boskia (Radovish, Konçe, Vasilevë, Bosilovë, Strumicë, Novo Sellë, Vallandovë, Bogdanci, Dojran, Gjevgjeli) se një periudhë të caktuar kohore nuk përmbushë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në rregulloren e cituar. Për të theksuar nga ana e personit të punësuar në Shërbimin profesional të Agjencisë është përpiluar Shënimi zyrtar nr. 03-5597/1 të datës 19.12.2017.

Me atë rast, Agjencia për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale më datë 19.12.2017, ka dërguar letër - Kërkesë të dhëna nr. 03-5597/2, me çka ka kërkuar nga SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të shënimit të parashtrojë dokumente (në original ose kopje të vërtetuar në noter) prej çka do të mund të konstatohet se radiodifuzeri përmbushë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren. Në Agjenci është dorëzuar fletë kthimi nga Posta e Maqedonisë se letra është pranuar në mënyrë të rregullt më datë 25.12.2017, ashtu që afati për parashkrimin e dokumenteve ka kaluar më datë 01.01.2018.

Duke paritur parasysh se deri në Agjenci nuk është parashtruar dokumentacioni i kërkuar, më datë 15.01.2018, Agjencia sërish ka dërguar letër - Kërkesë të dhënash nr. 03-377/1 deri te SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, me të cilën letër nga radiodifuzeri sërish është kërkuar të parashtrojë dokumentet e kërkuara më herët, edhe atë në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të kësaj letre. Në Agjenci është dorëzuar fletë kthimi nga Posta e Maqedonisë se letra është pranuar në mënyrë të rregullt më datë 17.01.2018, ashtu që afati për parashkrimin e dokumenteve ka kaluar më datë 24.01.2018.

Udhëzim për mjet juridik: Vendimi për marrje të lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë është vendimtar. Kundër vendimit për marrje të lejes, Shoqëria tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë ka të drejtë të parashtrojë padi deri tek gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të tij.

Në lidhje me procedurën e ngritur për marrjen e lejes të SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, nr. 08-1052 të datës 29.09.2015, ndërsa në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, Agjencia ka parashtruar Lajmërim deri tek radiodifuzeri i theksuar (Up1 nr. 08-131 të datës 20.03.2018), ku është paralajmëruar se nëse nuk parashtroi dokumentacionin e kërkuar nga i cili mund të konstatohet se përmbushë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren e cituar, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Propozimit të Drejtorit të Agjencisë, Up1 nr. 08-131 të datës 16.03.2018, do të sjellë Vendim për marrje të lejes së saj për emetim televiziv, pas çka në pajtim me nenin 85 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, radiodifuzeri do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Lajmërimi Up1 nr. 08-131 të datës 20.03.2018, është dërguar deri tek SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, në formë me shkrim përmes "Postës së Maqedonisë" Shkup. Gjithashtu, Lajmërimi i theksuar është dërguar deri te SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë edhe në formë elektronike më datë 20.03.2018, në adresën elektronike të radiodifuzerit i regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Me datë 28.03.2018, nga ana e personit të punësuar në Shërbimin profesional të Agjencisë për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, radiodifuzeri do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve. SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Propozimit Up1 nr. 08-131 të datës 16.03.2018, nga ana e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur obligimin e paraprirë me nenin 62 paragrafi 6 Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale dhe nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim dhe emetim televiziv (nr. 01-5774/1 të datës 21.11.2014).

Në pajtim me nenin 83 paragrafi 3 i Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, Këshilli i obligohet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit të Drejtorit për ngritje të procedurës për marrje të lejes, të sjellë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Duke paritur parasysh faktin se poseduesi i lejes nr. 08-1052 të datës 29.09.2015 - SHTR Telekom A1 SHPKNJ Strumicë dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Propozimit Up1 nr. 08-131 të datës 16.03.2018, nga ana e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur obligimin e paraprirë me nenin 62 paragrafi 6 Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale dhe nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim dhe emetim televiziv nr. 01-5774/1 të datës 21.11.2014 me ndryshim dhe plotësim nr. 01-3336/1 të datës 08.05.2015, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi 1 alineja 5 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, ndërsa në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë nr. 02-1476/2 të datës 29.03.2018, ka sjellë Vendim me çka merret leja nr. 08-1052 e datës 29.09.2015 për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive Telekom A1 SHPKNJ Strumicë, për shkak se poseduesi i lejes nuk ka përmbushur faktin e paraprirë në nenin 62 paragrafi 6 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale dhe nenin 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për radio emetim dhe emetim televiziv nr. 01-5774/1 të datës 21.11.2014 me ndryshime dhe plotësim nr. 01-3336/1 të datës 08.05.2015, gjegjësisht për shkak se pas dhënies së lejes janë paraqitur rethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes të kryejë veprimtarinë.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale, Vendimi për marrje të lejes për emetim televiziv ose radio emetim është vendimtar, ndërsa kundër të njëjtes poseduesi i lejes ka të drejtë të parashtrojë padi deri tek gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të asaj që është theksuar më lart është sjellë Vendimi si në dispozitivin. Agjencia për shërbime mediatake audio dhe audiovizuale Kryetari i Këshillit Llazo PETRUSHEVSKI, s. r.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në bazë të pikës 2 nga pjesa IV e Programit për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe inkurajimin e eficientës së energjisë për familjet për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 17/2018), Ministria e Ekonomisë

shpall

SHPALLJE PUBLIKE

Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blera dhe të instaluar në shtëpitë për vitin 2018

1. Përshkrimi i thirrjes publike

1.1 Ministria e Ekonomisë me qëllim të stimulimit të shfrytëzimit të masës për zëvendësim të dritareve PVC ose alumini në Republikën e Maqedonisë, blerësve të dritareve PVC ose alumini dhe instalimit të duhur, të cilët do ti blejnë dhe do ti instalojnë në shtëpitë e tyre pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje, përfundimisht me 31 gusht të vitit 2018, do ju sigurohet kthimi i një pjese të mjeteve të shpenzuara për blerjen e dritareve PVC ose alumini deri në 50%, por jo më shumë se 500 euro në kundërvlerë të denarit, deri në shfrytëzimin e mjeteve të parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për këtë qëllim, me kusht që blerësi të mos ketë shfrytëzuar të drejtën për kompensim të një pjese të mjeteve për blerjen dhe instalimin e dritareve të PVC ose alumini në shtëpinë e tij në bazë të shpalljes së mëparshme publike të Ministrisë së ekonomisë të shpallur në vitin 2017.

2. Kërkesa për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në këtë shpallje publike, kanë të gjithë blerësit të cilët kanë blerë dhe kanë instaluar në shtëpitë e tyre dritare PVC ose alumini pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje përfundimisht me 31 gusht të vitit 2018 dhe të cilët do të dorëzojnë formularin për kërkesë për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim.

2.2 Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe dëshmi se kushtet nga pjesa 2.1 të kësaj shpalljeje janë plotësuar, kërkuari duhet të dorëzon në Ministrinë e ekonomisë dokumentet si në vijim:

- 1. Formularin e plotësuar për kërkesë i cili mund të ngrihet në arkivin e Ministrisë së ekonomisë apo të sigurohet përmes faqes së internetit të ministrisë: www.economy.gov.mk,
2. Dëshmia në original se është kryer blerja e dritareve PVC ose alumini edhe atë
- llogaria fiskale, apo
- fatura me certifikatën nga banka afariste për pagesën e realizuar për produktin ose shërbimin, të lëshuara pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje.
3. Fotografi me ngjyra nga çdo dritare druri që zëvendësohet në shtëpi dhe fotografi me ngjyra nga çdo dritare PVC ose alumini që është instaluar në shtëpi (para dhe pas).

Nëse blerësi dorëzon dëshmitë origjinale për shpenzimet e bëra për blerjen dhe instalimin e dritareve PVC ose alumini (llogaria fiskale apo fatura me certifikatën nga banka afariste pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje), këto do ti merren parasysh gjatë përcaktimit të kompensimit të pjesës së shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blera dhe të instaluar në shtëpitë.

Një person mund të dorëzojë vetëm një kërkesë për marrjen e kompensimit. Nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të parapara për këtë qëllim, do të miratohet pagesa për kompensimin e pjesës së shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blerë dhe të instaluar në shtëpitë, nëse vërtetohet se me blerjen gjegjësisht instalimin e të njëjtave janë zëvendësuar dritare të drurit.

Dhënia e kompensimit do te realizohen ne bazë te principit „ai që arrin i pari shërbehet i pari”.

2.3 Me kërkesën duhet qe kërkuari ti dorëzoj edhe dokumentet si në vijim:

- Kopje nga letërnjoftimi i kërkuarit
- Të dhëna nga llogaria e transaksionit të kërkuarit dhe
2.4 Blerësi i dritareve PVC ose alumini, kërkesën për shfrytëzimin e të drejtës për kompensimin e pjesës së shpenzimeve, së bashku me dokumentacionin e duhur, duhet të dorëzojë në ZARFË TË MBYLLUR në Ministrinë e Ekonomisë në adresën "Jurij Gagarin nr. 15" me postë apo në Arkivin e Ministrisë së ekonomisë çdo ditë pune prej orës 9:30 deri në 15:00
2.5 Në këtë zarf duhet të qëndroj: SHPALLJA PËR KOMPENSIMIN E PJESËS SË SHPENZIMEVE PËR DRITARE PVC OSE ALUMINI TË BLERË DHE TË INSTALUARA NË SHTËPITË PËR VITIN 2018, EMRI MBIEMRI DHE ADRESA E KËRKUESIT.
2.6 Të gjithë personat që aplikojnë për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blera dhe të instaluar në shtëpitë, duhet të azhurnojnë të dhënat e tyre personale në sistemin e-taksave (e-PDD) në faqen e internetit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike.
2.7 Ministria e ekonomisë mban të drejtën të kryej vizita në amvisërive të cilat kanë dorëzuar kërkesë..

3. Mënyra e realizimit të drejtës për kompensim

- 3.1 Për zbatimin e aktiviteteve për realizimin e masës për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blerë dhe të instaluar në shtëpitë, ministri i ekonomisë do të formoj Komision e cili do të përbëhet nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre.
3.2 Komisioni do të ketë për qëllim të vërtetuar plotësimin e kushteve për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blerë dhe të instaluar në shtëpitë në vitin 2018 nga dokumentacioni i dorëzuar dhe do të propozojë Ministrinë të ekonomisë miratimin e vendimeve për pagesën e kompensimit të caktuar.
3.3 Personat të cilët kanë parashtruar kërkesë, por të cilët nuk kanë dokumentacionin e rregullt dhe komplet nga pika 2.2 të kësaj shpalljeje nuk do të mund të realizojnë të drejtën për kompensim.
3.4 Pagesa mjeteve për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për dritare PVC ose alumini të blerë dhe të instaluar në shtëpitë në vitin 2018 do të kryhet në bazë të vendimit të ministrit të ekonomisë deri në shfrytëzimin e mjeteve të parapara për këtë qëllim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.
3.5 Në momentin kur të gjitha mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për këtë qëllim do të shfrytëzohen, Ministria e ekonomisë do të publikoj njoftim në faqen e internetit të ministrisë.
3.6 Lista e kërkuarve të cilët do të realizojnë të drejtën për kompensim do të shpallen në faqen e internetit të Ministrisë së ekonomisë më se voni deri më 31 tetor të vitit 2018.

Në bazë të nenit 2 pika 2 dhe pika 10, nenit 4, nenit 46-49 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunave (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/15, 106/15, 153/15, 190/16 dhe 21/18) ndërsa në bazë të Vendimit për shitje të mjeteve të tundshme nr. 44-1331/1 të datës 06.03.2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/18) dhe Raportit për vlerësim nr. 1236-2017 të përpiluar nga Vizija T - SHPKNJ Shkup, Komisioni për mjete të patundshme dhe të tundshme pranë Shtëpisë shtetërore të studentëve "Shkup" - Shkup publikon

SHPALLJE NR. 01/18

Për shitjen e mjeteve të tundshme përmes ankandit publik elektronik

1. LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është shitja e mjeteve të tundshme – elemente metalike:

- Mbetje të hekurit -23.500 kg.
- Mbetje llamarinë – 20.000 kg.
- Mbetje alumini – 5.000 kg.

2. ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i mjeteve të tundshme për ankand publik për 1 kilogram të materialit mbeturinë pa TVSH është:

- Mbetje të hekurit - 9,00 denarë
- Mbetje llamarinë - 6,00 denarë
- Mbetje alumini - 53,00 denarë

Në çmim nuk janë përfshirë transporti dhe prerja (kasacioni).

Garancia bankare për seriozitet të ofertës është në shumë prej 2% të shumës së vlerësuar.

3. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Ankandi publik elektronik i materialit mbeturinë do të mbahet më datë 16.04.2018 në:

- Hekur – ora 09:00
- Lamarinë – ora 11:00
- Alumin –ora 12:00

Të drejtë për pjesëmarrje në ankand publik elektronik kanë të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike të vendit dhe të huaja që mund të kenë të drejtë e pronësisë të mjeteve të tundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilat i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

4. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Subjektet e interesuara fizike dhe juridike parashtrajnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankand publik (në formë elektronike) në ueb faqen **e-ukcil.finance.gov.mk**, e kompletuar me dëshmitë në vijim:

Fletëparaqitje të plotësuar dhe të nënshkruar personalisht nga parashtruesi në të cilën janë të shënuara të dhënat e përgjithshme të ofertuesit (emri dhe mbiemri/emri i plotë, adresa e saktë, e-mail adresa e parashtruesit të fletëparaqitjes përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankand publik, gjegjësisht do të dorëohen emri përdorues dhe fjalëkalim për qasje në internet faqen në të cilën do të mbahet ankand publik elektronik)

Garancia bankare për seriozitet të ofertës (e cila krahas dorëzimit elektronik duhet të dorëzohet edhe në original në arkivin e Shtëpisë, në rr. "Mitropolit Teodosij Golloganov" 26-b, Shkup)

Dëshmi për identitetin për subjektet juridike: -gjendja aktuale nga Regjistri qendror i RM (për subjektet e vendit juridike)

-certifikatë nga regjistrimi prej regjistrit përkatës në shtetin prej nga vjen (për subjektet e huaja juridike)

Leje për deponim, trajtim dhe përpunim të mbeturinave të dhënë nga ministria.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankand publik elektronik për çka do të informohen përmes mënyrës elektronike.

5. AFATI PËR DORËZIMIN E FLETËPARAQITJES

Shpallja zgjatë 10 (dhjetë) ditë kalendarike duke konsideruar nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe në internet faqen. Komisioni parashtrues të cilët në mënyrë të rregullt janë paraqitur në sistemin për ankand elektronik, me të komplet dokumentet të bashkëngjitura, në afat prej tre ditëve pas kalimit të kohëzgjatjes së shpalljes, do tu dorëzojë emër përdorues dhe fjalëkalim për pjesëmarrje në ankand publik. Mjetet e tundshme lëndë e ankandit publik elektronik do të mund të shihen shtëpinë e studentëve **Goce Dellçev**, në rr. "M. Teodosij Golloganov" pn në Shkup më datë **05.04.2018** në ora **10:00**.

6. KUSHTET E POSAÇME
Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar që të mënjojë mjetet e tundshme në afat prej 30 ditëve nga lidhja e Marrëveshjes.

7. PROCEDURA

Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se në lidhje me Shpalljen është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në Shpallje.

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të mjetit të patundshëm dhe realizohet përmes ankandit. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund të pranojnë, gjegjësisht irisin çmimin e mjetit të patundshëm.

Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re.

Për ofertues më i volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankand publik i cili ka ofruar çmimin e fundit i cili paraqet çmimin më të lartë për blerje të mjeteve të tundshme.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën për ankand publik në afat prej 3 ditëve nga mbajtja e ankandit publik të dërgojnë deri tek komisioni, i cili në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës vendosë në lidhje me ankesën përmes vendimit.

Kundër Vendimit të komisionit mund të parashtrohet ankesë deri tek Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative në shkallë të dytë.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të procedurës për ankand publik është i obliguar të paguajë mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar për mjetet e tundshme dhe në afat prej 15 ditëve të punës pas pagesës së realizuar lidhet Marrëveshje për shitblerje të mjeteve të patundshme.

Obligimi për pagesë të tatimit të qarkullimit bie në barrë të blerësit.

Pas lidhjes së marrëveshjes blerësi në afat prej 30 ditëve të njëjtin e dorëzon në noter për realizim të solemnizimit. Solemnizimi i Marrëveshjes bie në barrë të blerësit.

Komisioni për mjetet e patundshme dhe të tundshme në Shtëpinë shtetërore të studentëve "Shkup" - Shkup.

KOMUNA E GOSTIVARIT

ОПШТИНА ГОСТИВАР

GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk

info@gostivari.gov.mk

tel. +389 (0) 42 213 511

fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 23-1673/71

29.03.2018 vit

Gostivar

Në bazë të nenit 35 alinea (3) të Ligjit për planifikim hapësiror dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M È R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë të përfshirë në hapësirën e Propozim **Planit Detal Urbanistik (PDU) për Bllok 1** - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

PREZANTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Rreth Propozim **Planit Detal Urbanistik (PDU) për Bllokun 1** - Komuna e Gostivarit për periudhën e planit **2016-2021**, sipërfaqja e përfshirjes (**24.760 Ha**), që kufizohet në mes rrugëve:

- **Nga ana veriore me rrugën servisore "Goce Dellçev",**
- **Nga ana jugore me rrugën "Ivo Lolla Ribar",**
- **Nga ana lindore me rrugën "Beliçica", dhe**
- **Nga ana perëndimore me bul. "VII. Gjnoski".**

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. **04.04.2018 (e mërkurë) në ora 12:00.**

Propozim **Planit Detal Urbanistik (PDU) për Bllok 1** - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 5 ditë pune, edhe atë prej **04.04.2018** deri më **11.04.2018**, çdo ditë pune prej orës **08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit, si dhe në sistemin e-urbanizem, ndërsa në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë nga zona konkrete e përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrajnë vërejtje me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizem.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari



SHOQËRIA AKSIONARE PËR NDËRTIM DHE EKONOMIZIM ME HAPËSIRË BANESORE DHE ME HAPËSIRË AFARISTE ME RËNDËSI PËR REPUBLIKËN - SHKUP



rr. Orce Nikollov nr. 138, Shkup, fahu postal 474 tel: 3111-387

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup publikon:

Shpallje publike Për nevojën e punësimit të punëtorit

Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup ka nevojë për punësim të 1 punëtor për kohë të pacaktuar për vendin e punës "**Vozitës**" në Sektorin për punë juridike dhe të përgjithshme në Filialin Shkup të shoqërisë aksionare.

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 24.900,00 denarë

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në pajtim me ligjin si dhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës së Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup edhe atë:

-të kenë të mbaruar PMP – KU, 1 (një) vjet përvojë pune që kandidati e ka kaluar në punë pas arritjes me përgatitjen e kërkuar profesionale dhe leje të vozitjes të kategorisë B,;

Kandidatët krahas fletëparaqitjes (fletëparaqitje të shkruar me dorë) për vendin e punës për të cilin paraqiten duhet të dorëzojnë dokumente/dëshmi për plotësimin e kushteve të theksuara edhe atë:

- Diplomë ose dëftesë për arsimin e mbaruar me përgatitjen e kërkuar profesionale (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Kopje e leje të vozitjes të kategorisë B (kopje të vërtetuar në noter)

Afati për paraqitjen e kandidatëve është **5 (pesë) ditë** pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin dorëzohet në adresën e Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup – Drejtoria, rr. "Orce Nikollov" nr. 138, Shkup, përmes postës ose në arkivin e shoqërisë aksionare çdo ditë pune prej ora 8.30-16.30.

SHA për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup do të bëjë zgjedhjen e kandidatëve të paraqitur në afatin e paraparë ligjor, varësisht nga numri i fletëparaqitjeve të arritura.

Personi për kontakt: Z. Nedanovski. Tel. 02/ 2 633-833

Shoqata Tregtare "LUNA" SHPKTHP Shkup, në bazë të Vendimit për shitjen e pajisjeve përmes ankandit publik gojorë me nr. 02-103/13 të datës 11.01.2018, të Këshillit drejtues të NP "Parqe dhe gjelbërime", Vendim për dhënie pëlqim Vendimit për shitjen e pajisjeve përmes ankandit publik gojorë, të NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, nga Këshilli i Qytetit të Shkupit me nr. 27-853/1 të datës 31 janar të vitit 2018 dhe Vendimit për formim të komisionit me nr. 05-101/1 të datës 21.03.2018, Drejtuesi i "LUNA" SHPKTHP Shkup, shpall këtë:

SHPALLJE PËR SHITJE - Ankandit i parë publik gojor -

NJOFTOHEM të gjithë personat juridikë dhe fizikë se do të realizohet shitja e pajisjeve në pronësi të SHT "LUNA" SHPKTHP Shkup, për shkak të ndërprerjes afatgjatë të shfrytëzimit të tyre, me sa vijon:

- 352/012 – pajisja – ringëlshpili i vogël – verrie;
- 354/012 – pajisja – autodom i madh;
- 359/012 – pajisja – autodom i vogël;
- 360/012 – pajisja – raketodom.

Pajisjet mund të shihen në obrorin ekonomik dhe në magazinën e NP "Parqe dhe gjelbërime", në Bul. "Ilinden" nr. 104, Shkup çdo ditë pune nga dita e shpalljes deri në ditën para ankandit të përcaktuar publik, nga ora 8:00 deri në ora 14:00 (përkatesisht deri më 04.04.2018), pas përcaktimit paraprak të terminit në telefonin për kontakte.

Çmimi fillestar i pajisjeve është në shumën prej 317.675,00 denarë.

Çmimi i pajisjeve është pa llogaritjen e TVSH-së.

Zmadhimi i çmimit është i përkufizuar me etapa prej së paku 1000 denarë.

Shitja realizohet sipas parimit e "parë – e blerë", në tërësi (pajisjet nuk janë të ndashme).

Personat juridikë dhe fizikë të interesuar për blerjen e pajisjeve, për pjesëmarrjen në ankandin publik gojorë, më vonë një ditë para mbajtjes së ankandit të përcaktuar publik gojorë, përkatesisht deri më datën 04.04 viti 2018 deri në ora 12:00 duhet të realizojnë pagesën e shumës prej 6.000,00 denarë në trajtë të garancisë për pjesëmarrje në gjiro llogarinë e Shoqatës me nr. 30000001356969 në Bankën Komerciale.

Ankandi publik gojorë do të mbahet më datën 05.04. viti 2018 me fillim në ora 10:00 në "LUNA" SHPKTHP Shkup, në rr. 1732 nr. 10 Parku i qytetit, Shkup.

Në ditën e përcaktuar të ankandit publik gojorë, personat e interesuar nevojitet që me vete të bartin: dokumentin për identifikim ose autorizim për personin juridik me gjendjen rjedhëse për pjesëmarrje në ankandin publik gojorë dhe fletë pagesën si dëshmi për pagesën e shumës prej 6.000 denarë.

Blerësi është i obliguar që të paguajë shumën e përcaktuar të pajisjeve lëndë e ankandit, në afatin prej 5 (pesë) ditëve nga dita e shitjes, në të kundërtën ai do të humb të drejtën e kthimit të garancisë për pjesëmarrje.

Ofertuesve të tjerë, mjetet e paguara në emër të garancisë për pjesëmarrje do tu kthehen në afat prej 3 (tre) ditëve pas nënshkrimit të kontratës me blerësin.

Të gjitha obligimet që pasojnë nga shitja (TVSH-ja, tatimi i qarkullimit, verifikimi dhe shpenzimet tjera lidhur me shitjen) bien në barrë të blerësit.

Ankandin publik gojorë do ta realizojë Komisioni për ankandin publik gojorë i SHT "LUNA" SHPKTHP Shkup.

Për informacione më të detajuara, personat e interesuar mund të paraqiten në kontakt telefonin 02 3163 827.

"LUNA" SHPKTHP Shkup

Komisioni për ankandin publik gojorë



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësiror



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësiror e Republikës së Maqedonisë
SHPALLJE

Draft A-I.eje të integruar ekologjike

Për: NNT GRADBA PROMET DOO Kavadar, bazë e asfaltit

Instalacioni dorëzoi kërkesë deri të MMJPH për marrjen e A-lejes për harmonizim me planin operativ. Instalacioni sipas rregullores për caktimin e aktiviteteve të instalacione, i përkakt aktiviteteve nga shtojca 1 pika:

3.5 Bazat stacionare asfalti

Kapacitet i projektuar

60-70 t/h

Drejtoria për mjedis pranë MMJPH përgatiti draft leje të integruar ekologjike pasi që instalacioni i plotësoi të gjitha pikat e planit operativ:

DRAFT A-leje e integruar ekologjike

Për:

NNT GRADBA PROMET DOO Kavadar, bazë e asfaltit

Draft leja do të jetë e publikuar në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësiror www.moiepp.gov.mk

Informata në lidhje me lejen, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësiror në numrin e telefonit 076 456 717 ose në e-mail f.baliu@moiepp.gov.mk

Publiku i interesuar në afat prej 14 ditëve që nga dita e publikimit të mjetet e informimit mund të dërgojë vërejtjet e veta në lidhje me Draft lejen në formë të shkruar deri tek Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësiror në adresën në vijim: Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV-së), 1000 Shkup.



Nga AGIM RUSHITI

NJË LIGJ QË GARANTON KUALITETIN

Sigurimin e brendshëm të kualitetit është i obliguar ta realizojë vetë institucioni i arsimit të lartë, i cila ka për obligim, një herë në vit, të realizojë vetevaluim. Vetevaluimi i institucioneve të arsimit të lartë kryhet, në intervale në më së shumti tri vite, nga vetë institucioni, mbi bazë të Rregullores për standardet dhe procedurat për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim, të cilin e sjell Këshilli nacional i arsimit të lartë

Për funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë, Ligji i ri parasheh ekskluzivisht sigurimin e garancionit bankar, cila nuk hyn në pasurinë e falimentimit (duke eliminuar edhe mundësinë e garancionit në hipotekë, kërkesë kjo që ishte prezent deri më tani në dispozitat aktuale ligjore). Garancioni bankar shërben si garancë për mbulimin e mjeteve që studentët i kanë paguar në institucionin e arsimit të lartë, i cili është konstatuar se veç pushon së funksionari dhe për harxhimet tjera që do t'i ketë studentit gjatë transferit të tij në institucionin tjetër të arsimit të lartë.

Sistemi i sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe përparimit të arsimit të lartë realizohet përmes Këshillit nacional të arsimit të lartë dhe Agjencionit për kualitet të arsimit të lartë. Organe të agjencionit për kualitet janë: Këshilli për akreditim i arsimit të lartë, Këshilli për evaluim i arsimit të lartë dhe Drejtori i Agjencionit për kualitet të arsimit të lartë.

KËSHILLI NACIONAL PËR ARSIM TË LARTË

Këshilli nacional për arsim të lartë, si organ i pavarur me seli në Shkup, përbëhet nga 15 anëtarë, me mandat 4 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje (me përjashtim të përfaqësuesit të studentëve i cili zgjidhet me mandat dy vjeçar), të cilin e zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Gjashtë (6) anëtarët e këtij këshilli vijnë si propozim nga ana e Konferencës interuniversitare dhe janë profesor të rregullt në universitete, nga një prej secilës fushë shkencore-hulumtuese sipas Klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit; 6 anëtarë do jen nga radhët e profesorëve të rregullt në marrëdhënie pune në universitete, nga një prej secilës fushë shkencore-hulumtuese sipas Klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit të nominuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë; një anëtar me propozim të AMSHA (Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve) nga radhët e anëtarëve të AMSHA; një anëtar nga bashkësia e biznesit dhe një anëtar nga radhët e studentëve.

Këshilli nacional për arsim të lartë është i pavarur në punën e tij dhe vendos në kuadër të kompetencave të veta, mbi principin e profesionalitetit dhe kompetitivitetit, mbi këto çështje: E ndjek zhvillimin e arsimit të lartë dhe përputhshmërinë e tij me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe për të, një

herë në vit, dorëzon edhe raport në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, me propozim masa, vendime dhe sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë së arsimit të lartë; përgatit dhe propozon Programën nacionale për arsim të lartë për miratim nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë; i propozon Ministrin të arsimit dhe shkencës Rregullore për normativet dhe standardet për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, Rregullore për përmbajtjen e programeve studimore në përputhshmëri me ligjin, Rregullore për kushtet dhe kriteret për financimin e arsimit të lartë;

Rregullore për kushtet dhe kriteret për stimulimin e studentëve të talentuar dhe për stipendimin e studentëve të cilët arrijnë rezultate mbi mesataren përgjatë studimeve (të cilën e sjell Qeveria e Republikës së Maqedonisë); Rregullore për metodologjinë, standardet dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për akreditimin e programeve studimore; Rregullore për standardet dhe procedurat për evaluim të jashtëm dhe për vetevaluim; Rregullore për standardet dhe kriteret për themelimin e instituteve shkencore dhe për kryerjen e veprimtarisë shkencore-hulumtuese; Rregul-

lore për standardet dhe kriteret për financimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese;

Akt të përgjithshëm me të cilat rregullohen thirrjet profesionale dhe shkencore, në përputhshmëri me ligjin; propozon Komision amë për themelimin e institucionit të arsimit të lartë; e ndjek zhvillimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe përputhshmërinë me rrjedhat evropiane dhe ndërkombëtare, për çka, një herë në vit, edhe paraqet raport deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim masa, vendime dhe sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese; e përgatit dhe në pëlqim me Ministrin e arsimit dhe shkencës, e propozon për miratim Programin nacional për veprimtari shkencore-hulumtuese deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë; si dhe akte tjera që janë në interes të mbarëvajtjes së veprimtarisë së arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor, duke kryer edhe detyra tjera në përputhje me ligjin.

Këshilli për akreditim i arsimit të lartë është trup kolektiv i përbërë prej 15 anëtarëve, nga të cilët 12 janë nga radhët e profesorëve ordinar në marrëdhënie pune në universitet në Republika e Maqedonisë (nga të cilët 6 anëtarë janë të propozuar nga ana e Konferencës interuniversitare, kurse 6 tjerë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë), një anëtar e emëron AMSHA, një anëtar nga radha e studentëve i propozuar nga ana e Konferencës interuniversitare dhe një anëtar i emëruar nga Organizata më reprezentative e punëdhënësve.

Këshilli për akreditim i arsimit të lartë është i pavarur në punën e tij dhe vendos, mbi bazë të parimeve të profesionalizmit dhe të paanshmërisë, për çështje që janë të lidhura me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore që realizojnë ato, në të tri ciklet e studimit, duke pasur parasysh kontrollin mbi plotësimin e kushteve në aspektin e kuadrit arsimor dhe të hapësirës për zhvillimin e procesit arsimor e shkencor.

Këshilli për evaluim i arsimit të lartë është trup kolektiv i përbërë prej 15 anëtarëve, nga të cilët 12 janë nga radhët e profesorëve ordinar në marrëdhënie pune në universitet në RM (nga të cilët 6 anëtarë janë të propozuar nga ana e Konferencës interuniversitare, kurse 6 tjerë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë), një anëtar e emëron AMSHA, një anëtar nga radha e studentëve dhe një anëtar i emëruar nga Organizata më reprezentative e punëdhënësve.

KËSHILLI PËR EVALUIM I ARSIMIT TË LARTË

Ndjek veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të instituteve shkencore, të akredituara dhe të pajisura me vendim pune; Ndjek dhe e vlerëson kualitetin e kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese, artistike dhe profesionale të kuadrit arsimor dhe të realizimit të programeve studimore;

Propozon (deri te Këshilli nacional i arsimit të lartë) Rregulloren për standardet dhe procedurat për evaluim të jashtëm, si dhe kryen punë tjera në përputhje me Rregulloren për standardet dhe procedurat për evaluim të jashtëm dhe për vetevaluim dhe detyrime tjera të përkrahura në vetë këtë ligj.

Një sigurim i tillë i cilësisë në arsimin e lartë parashihet të realizohet përmes sigurimit të kualitetit të jashtëm dhe atij të brendshëm nëpër institucione të arsimit të lartë.

Sigurimin e brendshëm të kualitetit është i obliguar ta realizojë vetë institucioni i arsimit të lartë, i cila ka për obligim, një herë në vit, të realizojë vetevaluim. Vetevaluimi i institucioneve të arsimit të lartë kryhet, në intervale në më së shumti tri vite, nga vetë institucioni, mbi bazë të Rregullores për standardet dhe procedurat për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim, të cilin e sjell Këshilli nacional i arsimit të lartë.

Në domenin e sigurimit të kualitetit të brendshëm bien: Politikat për kualitet dhe procedurat për sigurimin e kualitetit; Lejimi, ndjekja dhe kontrollat periodike për sigurimin e kualitetit; Lejimi, ndjekja dhe kontrolli periodik i programeve dhe kualifikimeve; Vlerësimi i studentëve;

Sigurimi i kualitetit të arsimtarëve; Resurset arsimore dhe ndihma për studentët, që nënkupton resurse për mësimdhënie dhe hulumtim; Sistemi informativ dhe informimi transparent i publikut për veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë. Studentët do të vlerësohen përmes kriterëve, rregullave dhe procedurave të shpallura publikisht. Lënda e vlerësimit të studentëve do të jetë kompetencat, dituritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe aftësitë e nxëna dhe kapacitetet e krijuara te ata (studentët) përgjatë studimeve për aplikimin e tyre. Ky vlerësim, si pjesë e lirisë akademike, do ta merr parasysh kompleksitetin e shfaqjes, respektivisht të rezultateve të mësimit të studentëve, përgjatë një procesi kontinuitiv më të gjatë dhe mbi to t'i adaptojë metodat e njohura dhe të sprovuara të vlerësimit. Vlerësi-

mi i studentëve nuk guxon të jetë në kundërshtim me rregullat e ECTS dhe obligimeve për vlerësimin e aktiviteteve të përgjithshme të cilat studenti i realizon përgjatë studimeve. Sigurimi i kualitetit të mësimdhënësve sigurohet përmes kriterëve të përcaktuara dhe një metodologjie të definuar dhe të ndërtuar për kontrollin e kualifikimit dhe profesionalizmit të kuadrit të mësimdhënësve, kuadrit hulumtues dhe atij shkencor dhe i veprimtarisë arsimore të kuadrit mësues, veprimtarisë shkencore dhe asaj aplikative etj.

Në shumicën e vendeve evropiane, institucionet e arsimit të lartë ose programet e studimit janë subjekt i rishikimit të rregullt të jashtëm nga një agjenci e sigurimit të cilësisë. Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, EQAR (European Quality Assurance Register for Higher Education) është një regjistër i agjencive të tilla, duke renditur ato agjenci që kanë demonstruar pajtueshmërinë e tyre substanciale me një grup të përbashkët parimesh për sigurimin e cilësisë në Evropë. Këto parime janë të përcaktuara në Standardet dhe Udhëzimet Evropiane (ESG - Environmental, Social and Governance) për Sigurimin e Cilësisë. EQAR synon t'u ofrojë publikut informata të qarta dhe të besueshme për agjencitë e sigurimit të cilësisë që veprojnë në Evropë.

Sigurimi i kualitetit në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë bazohet në Komunikatën e Berlinit të vitit 2003, në të cilën ministrat e vendeve nënshkruese të Deklaratës së Bolonjës e thirrën ENQA, në bashkëpunim me Asociacionin (Shoqatën) Evropian të Universiteteve, EUA (European University Association - EUA është organizata, përfaqësuese e universiteteve dhe konferencave kombëtare të rektorëve nga 47 vende evropiane, e cila luan një rol vendimtar në procesin e Bolonjës dhe në ndikimin e politikave të BE-së në arsimin e lartë, në kërkimin shkencor dhe në inovacion dhe e cila siguron që zëri i pavarur i universiteteve evropiane të jetë i dëgjuar kudo që merren vendime që ndikojnë në aktivitetet e tyre), Asociacionin Evropian të Institucioneve të Arsimit të Lartë - EURASH (European Association of Institutions in Higher Education, përfaqëson institucionet e arsimit të lartë, kryesisht të shkencave të aplikuara dhe kolegjeve universitare, ku anëtarë të tij janë edhe asociacionet kombëtare dhe sektoriale të institucioneve të arsimit të lartë...

(vijon në numrin e ardhshëm)



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në bazë të pikës 2 nga pjesa III e Programit për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe inkurajimin e eficientë të energjisë për familjet për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 17/2018), Ministria e Ekonomisë

shpall

SHPALLJE PUBLIKE

për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për blerjen dhe instalimin e sistemeve termike diellore në shtëpitë për vitin 2018

1. Përshkrimi i thirrjes publike

1.1 Ministria e Ekonomisë me qëllim të stimulimit të shfrytëzimit të energjisë së diellit në Republikën e Maqedonisë, blerësve të sistemeve termike diellore (kolektorë, rezervuarë për ujë të ngrohtë dhe instalimi i nevojshëm), të cilët do të blejnë dhe do të instalojnë në shtëpitë e tyre pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje, përfundimisht me 31 gusht të vitit 2018, do ju sigurohet kthimi i mjeteve të shpenzuara për blerjen e sistemeve termike diellore deri në 30%, por jo më shumë se 300 euro në kundërvlerë të denarit me kusht që blerësi të mos ketë shfrytëzuar të drejtën e kthimit të mjeteve për blerje dhe instalimin e sistemeve termike diellore në shtëpinë e tij në bazë të shpalljeve të mëparshme publike të Ministrisë së ekonomisë për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për sisteme termike diellore të shpallur në vitin 2007, 2009, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017.

2. Kërkesa për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në këtë shpallje publike, kanë të gjithë blerësit të cilët kanë blerë dhe kanë instaluar sisteme termike diellore pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje përfundimisht me 31 gusht të vitit 2018 dhe të cilët do të dorëzojnë formularin për kërkesë për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim.

2.2 Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe dëshmi se kushtet nga pjesa 2.1 të kësaj shpalljeje janë plotësuar, kërkuar duhet të dorëzojnë në Ministrinë e ekonomisë dokumentet si në vijim:

1. Formularin e plotësuar për kërkesë i cili mund të ngrihet në arkivin e Ministrisë së ekonomisë apo të sigurohet përmes faqes së internetit të ministrisë: www.economy.gov.mk.
2. Dëshmia në origjinal se është kryer blerja e sistemeve termike diellore edhe atë
 - llogaria fiskale, apo
 - fatura me certifikatën nga banka afariste për pagesën e realizuar për produktin ose shërbimin, të lëshuara pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje.

Nëse blerësi dorëzon dëshmitë origjinale për shpenzimet e bëra për blerjen dhe instalimin e sistemeve termike diellore (llogari fiskale apo fatura me certifikatën nga banka afariste pas ditës së shpalljes së kësaj shpalljeje), këto do të merren parasysh gjatë përcaktimit të kompensimit të pjesës së shpenzimeve për sisteme termike diellore të blera dhe të instaluar në shtëpitë.

Një person mund të dorëzojë vetëm një kërkesë për marrjen e kompensimit.

Dhënia e kompensimit do të realizohet në bazë të principit „ai që arrin i pari shërbehet i pari”.

2.3 Me kërkesën duhet që kërkuar të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:

- Kopje nga letërnjoftimi i kërkuar
 - Të dhëna nga llogaria e transaksionit të kërkuar dhe
- 2.4 Blerësi i sistemeve termike diellore, kërkesën për shfrytëzimin e të drejtës për kompensimin e pjesës së shpenzimeve, së bashku me dokumentacionin e duhur, duhet të dorëzojë në ZARFË TË MBYLLUR në Ministrinë e Ekonomisë në adresën "Jurij Gagarin nr. 15" me postë apo në arkivin e Ministrisë së ekonomisë çdo ditë pune prej orës 9:30 deri në 15:00
- 2.5 Në këtë zarf duhet të qëndroj: SHPALLJA PËR KOMPENSIMIN E NJË PJESE TË SHPENZIMEVE PËR BLERJEN DHE INSTALIMIN E SISTEMEVE TERMIKE DIELORE NË SHTËPITË PËR VITIN 2018, EMRI MBIEMRI DHE ADRESA E KËRKUESIT.
- 2.6 Të gjithë personat që aplikojnë për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për blerjen dhe instalimin e sistemeve termike diellore në shtëpitë, duhet të azhurnojnë të dhënat e tyre personale në sistemin e-taksave (e-PDD) në faqen e internetit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike.
- 2.7 Ministria e ekonomisë mban të drejtën të kryej vizita në amvisërive të cilat kanë dorëzuar kërkesë.
- 3. Mënyra e realizimit të drejtës për kompensim**
- 3.1 Për zbatimin e aktiviteteve për realizimin e masës për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për sisteme termike diellore të blerë dhe të instaluar në shtëpitë, ministri i ekonomisë do të formoj Komisionin e cili do të përbëhet nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre.
- 3.2 Komisioni do të ketë për qëllim të vërtetojë plotësimin e kushteve për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për sisteme termike diellore, të blerë dhe të instaluar në shtëpitë në vitin 2018 nga dokumentacioni i dorëzuar dhe do t'i propozojë Ministrisë së ekonomisë miratimin e vendimeve për pagesën e kompensimit të caktuar.
- 3.3 Personat të cilët kanë parashtruar kërkesë, por të cilët nuk kanë dokumentacionin e rregullt dhe komplet nga pika 2.2 të kësaj shpalljeje nuk do të mund të realizojnë të drejtën për kompensim.
- 3.4 Paga mjeteve për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për sisteme termike diellore të blerë dhe të instaluar në shtëpitë në vitin 2018 do të kryhet në bazë të vendimit të ministrit të ekonomisë deri në shfrytëzimin e mjeteve të parapara për këtë qëllim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.
- 3.5 Në momentin kur të gjitha mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për këtë qëllim do të shfrytëzohen, Ministria e ekonomisë do të publikoj njoftim në faqen e internetit të ministrisë.
- 3.6 Lista e kërkuarve të cilët do të realizojnë të drejtën për kompensim do të shpallen në faqen e internetit të Ministrisë së ekonomisë më se voni deri më 31 tetor të vitit 2018.



Republika e Maqedonisë
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programin për zhvillim të turizmit për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018), Ministria e ekonomisë publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për zgjedhje të ideve më të mira të biznesit për turizëm të krijuara nga studentët e fakultetit për turizëm

1. Lëndë e thirrjes publike është zgjidhja e ideve më të mira të biznesit për turizëm të krijuara nga studentët e fakultetit për turizëm.

Projekti është realizuar në bashkëpunim me: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Fakultetin për turizëm (Ohër/Shkup/Shtip/Universitetin shtetëror të Tetovës – drejtimit turizëm) dhe Agjencinë për promovim dhe mbështetje të turizmit në Republikën e Maqedonisë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje kanë studentët e fakulteteve për turizëm në Republikën e Maqedonisë të moshës prej 18 deri në 30 vjet.

Secili pjesëmarrës në thirrjen publike ka të drejtë të aplikojë vetëm me një biznes ide. Me një biznes ide mund të marrin pjesë më së shumti dy (2) studentë.

3. Kusht për pjesëmarrje është që idetë e biznesit të jenë të përpiluara në pajtim Udhëzimit për përpilim të idesë së biznesit për turizëm (shtojcë e Thirrjes publike).

Aplikacionet mund të parashtrihen në gjuhën maqedonase ose në gjuhën shqipe (me përkthim në gjuhën maqedonase).

4. Kriteret për vlerësim dhe zgjedhje të ideve më të mira të biznesit për turizëm:

Kriteri	Vlera %
Pamja e ballinës	2
Rezyme	5
Përshkrimi i prodhimeve dhe/ose shërbimeve	10
Analiza e tregut dhe industrisë (sipas modelit të Majkell Porter)	13
SWOT analiza	8
Përshkrim të sistemeve të marketingut dhe distribuimit	8

Përshkrim i procesit prodhues/shërbyes	10
Menaxhim i resurseve njerëzore	8
Plani financiar	13
Realizueshmëria e biznesit	13
Inovacioni i biznesit	10

5. Të tria idetë më të mira të biznesit do të prezantohen para Komisionit për evaluim dhe zgjedhje të ideve më të mira të biznesit për turizëm.

6. Ideve më të mira të biznesit për turizëm do të ndalen pllaketa, vauçerë dhe çmime në të holla prej:

- Çmimi i 1 60.000 denarë
- Çmimi i 2 40.000 denarë
- Çmimi i 3 20.000 denarë

7. Thirrja publike për aplikim për ide më të mira të biznesit për turizëm do të zgjasë deri më **30.04.2018**.

Idetë e gatshme të biznesit për turizëm në **një kopje të shkruar** duhet të parashtrihen në arkivin e Ministrisë së ekonomisë me **shenjë**:

"Për zgjedhje të ideve më të mira të biznesit për turizëm"

Adresa: Ministria e ekonomisë Jurij Gagarin 15, 1000 Shkup **dhe në version elektronik** në adresën në vijim: tourism@economy.gov.mk Për informacione plotësuese dhe tel. (02) 3093 536; (02) 3093 543; (02) 3093 540

Koha, e premte 30 mars, 2018



Serbët pranojnë se Kosova "i ka futur" në telashe

Serbët kanë pranuar se mund të përballen me telashe të mëdha nëse ndjekin politikën për të shmangur përballjen me sportistët nga Kosova. Fundjavën e kaluar shteti i Serbisë ndërhyri duke ndaluar hendbollistët U-20 të Kosovës që të luanin në afërsi të Beogradit, ku është dashur të përballëshin me Serbinë, Norvegjinë e Sllovakinë, në eliminatore për botëror. Më pas Federata e Xhudos e Serbisë ua ndaloi

dy xhudisteve serbe paraqitjen në një kupë evropiane për juniorë në Sarajevë, për të shmangur përballjen e tyre me kosovaret. Serbia u përjashtua nga kualifikimet për botëror në hendboll, ndërsa pritet gjobë ndaj Federatës serbe. Të humbura dolën edhe xhudistet, ndërsa një sfidë për Serbinë pritet të jetë evropiani i karatesë që mbahet në këtë vend në muajin maj



FSHF dorëzon kandidaturën për Superkupën e Evropës 2020

Pas dështimit në kandidimin për të siguruar organizimin e Superkupës së Evropës për vitin 2019, pasi fituese u shpall stadiumi "Besiktas Arena" i Stambollit, Federata Shqiptare e Futbollit ka depozituar këtë të enjte aplikimin e saj në UEFA për organizimin e të njëjtit event, këtë herë për vitin 2020. Stadiumi ku mund të luhet kjo superfinale mes fituesit të Çampionit dhe atij të "Europa League", sigurisht do të jetë "Arena Kombëtare" e kryeqytetit. FSHF zyrtarizoi se grupi i punës për përfundimin e dosjes së plotë të dokumentacionit për këtë kandidaturë ka përfunduar praktikën e aplikimit dhe "Arena Kombëtare" është tashmë një nga impiantet kandidatë. Ideja për organizimin e këtij eventi të rëndësishëm në kalendarin e futbollit evropian vjen nga dëshira për promovimin e vlerave të mikpritjes shqiptare, si dhe nga ambicia për zhvillimin e emrit të mirë të kulturës sportive në vend, e nxitur kjo edhe nga përfundimi i shpejtë i "Arenës Kombëtare", punimet për të cilën vijojnë me intensitet shumë të lartë. Organizimi në kryeqytet i Superkupës Evropiane merr një rëndësi absolute, jo thjesht nga pikëpamja sportive, por mbi të gjitha edhe për imazhin e Shqipërisë, e sidomos Tiranës. Pas dorëzimit të dosjes zyrtare në UEFA, Federata Shqiptare e Futbollit falënderon të gjitha institucionet që bashkëpunuan me të për plotësimin e kriterëve të kërkuara nga UEFA, përfshirë këtu: Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkinë e Tiranës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intellektuale, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, "Tirana International Airport", Agjencia Kombëtare e Turizmit, si dhe të gjithë partnerët e tjerë që u angazhuan me këtë proces për të kërkuar sërish për herë të dytë organizimin e një finale Superkupe në Tiranë. Shumë shpejt "Arena Kombëtare" do të jetë gati si një vepër e madhe sportive kombëtare, dhe një kandidaturë potenciale për të organizuar një finale të një eventi evropian të futbollit në vendin tonë.

PESHËNGRITJE, KAMPIONATI EVROPIAN NË RUMANI

CALJA, KAMPIONI I TREFISHTË I EVROPËS

Calja ka varur në qafë 3 medalje të arta në Evropianin e shtangës që po zhvillohet në Bukuresht të Rumanisë, duke valëvitur flamurin kuqezi pas garës dhe në podium



Dita madhështore e Briken Caljes. Peshëngritësi shqiptar është shpallur dje kampion i trefishtë i Evropës në peshën 69 kg, duke triumfuar si në stilin e shkëputjes ashtu dhe atë të shtytjes e për pasojë edhe në dygarësh. Calja ka varur në qafë 3 medalje të arta në Evropianin e shtangës që po zhvillohet në Bukuresht të Rumanisë, duke valëvitur flamurin kuqezi pas garës dhe në podium. Pas të artës të fituar në stilin e shkëputjes, ku ngriti 146kg, Calja fitoi të artën edhe në shtytje, ku ngriti 175kg dhe e mbylli me 321kg në dygarësh, duke konfirmuar se mbetet një kampion, duke mbajtur premtimin për medalje. Pas paraqitjes së mirë që Calja bëri në stilin e shkëputjes, ku i realizoi me sukses të

tre provat, duke ngritur 141kg, 143 kg dhe në fund 146 kg, shtangisti nga Shtërmeni nuk zhgënjeu as në stilin e shtytjes, ku ishte favorit. Calja e nisi garën me 171 kg, kur të tjerët thuajse e kishin përfunduar atë dhe e realizon me sukses provën e parë. Por në të dytën shtangisti kuqezi dështoi të ngrrejë 175 kg, peshë të cilën e realizon me

sukses në provën e tretë, duke siguruar kështu medaljen e artë edhe në këtë stil. Në dygarësh, Calja renditet sërish i pari, me 321 kg në total, duke fituar kështu 3 medalje të arta në Evropian, duke qenë absolut në peshën 69 kg. Në peshën 69 kg garoi edhe peshëngritësi tjetër shqiptar Arbër Çerçizi, që pas vendit të shtatë në shkëputje (e

mbylli garën me 135 kg), në stilin e shtytjes u klasifikua në vendin e 12, me 156 kg, peshë të cilën e realizoi në provën e parë. Në provën e dytë tenton të ngrrejë 161 kg, por pa sukses, duke u tërhequr nga gara (nuk ngjitet në pedanë për provën e tretë), ndërsa në dygarësh, Çerçizi u rendit në vendin e 8-të, me 291kg në total.

KROACIA E TRANSFERON NË BURGUN ITALIAN

"Ballisti" i shpëton ekstradimit në Beograd

Ismail Morina, i ashtuquajtur "Ballisti" i dronit të Beogradit mbremjen e 14 tetorit të vitit 2014, duket se ka gjetur mënyrën për të shpëtuar nga ekstradimi në Beograd, ku akuzohet për nxitje urrejtie mes popujve. "Top Channel" ka mësuar se Ismail Morina është transferuar ditën e djeshme drejt një burgu në Itali, ku do të vazhdojë gjykimin për të fituar lirinë. Edhe pse jo zyrtarisht, kjo me sa duket është zgjidhja që avokati i tij kroat ka mundur të gjejë, duke hedhur poshtë kërkesën për azil në Kroaci, që ishte opsioni i parë



për të shpëtuar nga ekstradimi në Serbi. Italia është vendi ku Ismail

Morina është rezident prej shumë vitesh, së bashku me familjen e tij,

në mënyrë të ligjshme, duke qenë se edhe bashkëshortja e tij është italiane. Ai qëndroi në burgun e Zagrebit prej datës 10 qershor të vitit 2017, kur policia kroate në fillim zbatoi një kërkesë të shtetit serb, i cili kishte nxjerrë një urdhërrarrestit ndërkombëtar për ndalimin e "Ballist" Morinës, por pas disa seancash gjyqësore drejtësia kroate rezistoi, duke mos plotësuar kërkesën e drejtësisë serbe për gjykimin e Ismail Morinës në Beograd. Me transferimin e tij në Itali, duket se edhe lirimi përfundimtar për të është shumë pranë.



info@sborna.gov.mk | www.sborna.gov.mk

Në pajtim me Ligjin për shtetë dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16) dhe nenit 29 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënie me qira të hapësirës afariste e cila është në pronë dhe në cilën menaxhon Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup (nr. Ark. 02-2148/2 të datës 11.11.2015)

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime
BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup
 me seli në bul. 8-mi Septemvri nr. 13 Shkup
PUBLIKON
SHPALLJE nr. 03/2018
PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS AFARISTE PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është **DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS AFARISTE**, në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në pajtim me Pasqyrën tabelore në të cilin janë dhënë të dhëna për hapësirën afariste, nr. i parcelës kadastrale, sipërfaqe të hapësirës afariste, adresa, çmimi i përgjithshëm fillestar, garancia bankare, afati i parashtrimit dhe koha e ankandit publik.

Hapësira afariste e cila është lëndë e ankandit publik elektronik është në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, jepet për periudhë prej 3 (tre) vjet, me mundësi për vazhdim të marrëveshjes.

1. Hapësira afariste e cila gjendet në Vip Akua Park në kompleksin Qendra sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të parë).

Nr. r.	Numi i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1.	PK 328/4 KK Karposh LP 75268	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"kafe restorant" në katin e parë	126.35	22.442,00	4.488.331,00	89.767,00	07.04.2018	11.04.2018 10:00

Qiraja në marrëveshje për qiranë është dhënë në shumë neto – pa TVSH. Tatimi i vlerës së shtuar shënohet në vend të posaçëm në faturë.

Qiramarrësi obligohet që qiranë ta paguajë në afat prej një dite nga dita e marrjes së faturës.

Për mos pagesë në kohë të qirasë do të përllogaritet kamatë ndëshkuese ligjore.
 Mospagesa e 2 (dy) qirave të njëpasnjëshme mujore, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me qira, paraqet bazë për aktivizim e mjeteve për sigurim në ndërprerje të marrëveshjes nga ana e Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.

TË DREJTË PËR PJESEMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. **Subjektet fizike:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Subjektet juridike:** person juridik lokal, person juridik në pronësi të përzier, person juridik të themeluar nga personi fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa të cilët me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territor të Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESEMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Subjektet e interesuara fizike dhe juridike paraqiten në sistemin për shërbime dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk Dokumentet në formë me shkrim dorëzohen në Shoqërinë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në zarf të mbyllur me shenjë "Mos hap deri në përfundim të shpalljes".

Fletëparaqitja në internet portalin www.deloven-prostor.mk dhe në formën me shkrim duhet të kompletetohet në mënyrë identike me dëshmitë në vijim:

- Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumë prej (2%) të vlerës së caktuar) me afat të kohëzgjatjes prej 60 ditëve nga dita e ankandit publik vetëm në origjinal (të shënohet numri rendor nga pasqyra afariste dhe adresa ku gjendet objektet afariste).
- Për subjektet fizike certifikatë të shtetësisë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muj.
- Për subjektet juridike gjendje aktuale nga Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë (për ofertues të huaj dëshmi përkatës për regjistrim të subjektit juridik të dhënë nga regjistrin përkatës), në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muj.
- Pjesëmarrësi i interesuar regjistron në portalin www.deloven-prostor.mk me futjen e e-mail adresës së parashtruesit të fletëparaqitjes përmes së cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, sipas së cilës do të duhet të aktivizojë llogarinë përdoruese (Shih udhëzimin për shfrytëzuesit të www.deloven-prostor.mk).
- Deklaratë se në rast se oferta e tij zgjidhet si më e volitshme obligohet të paguajë mjeteve në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesi do të shpillohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurën për ankandin publik për jetësimin ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shpallimit të ndalesës.
- Gjatë dorëzimit të dokumenteve, ofertuesit të interesuar në fushën "Deklaratë" duhet të fusin në një dokument të gjitha dokumentet e nevojshme nga shpallja përveç Garancisë bankare, ndërsa në sferën "Garancia bankare" dorëzohet garancia e skanuar bankare.

SHENIM:

- Ofertuesit të cilët do të aplikojnë për hapësirën e shënuar me numër rendor 1 në pasqyrën tabelore me numër 1 të shënuar si "kafe restorant" në katin e parë, Lista pronësore 75265, PK 328/4, KK Karposh, që gjendet në Vip Akua Park në kompleksin e Qendrës sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup përveç dokumentacionit të shënuar më lartë, duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:
 - Të kryejnë veprimtaritë shërbim të ushqimit dhe pijeve (në fushë Deklaratë të bashkëngjitet si dëshmi DRD formular).
 - Të kenë të paguara të gjitha faturat ndaj shtetit: tatime, dogana etj. (në fushën Deklaratë të bashkëngjitet vërtetimi nga Drejtoria për të Hyra Publike dhe Dogana).

- Të kenë akumulim të qarkullimit prej 70.000.000 denarë dhe fitim jo më të vogël se 6.000.000 për 3 (trec) vitet e fundit (në fushën Deklaratë të bashkëngjitet si dëshmi bilanci i suksesit dhe bilanci i gjendjes).
- Të kenë certifikatë për HACCAP (në fushën Deklaratë të bashkëngjitet si dëshmi HACCAP certifikata).
- Të ketë të realizuar dhe të jenë të certifikuar për standardet për menaxhim me mbeturinat ISO 14001 (në fushën Deklaratë të bashkëngjitet si dëshmi deklarata për pëllim për shërbim të ushqimit dhe pijeve për numër maksimal prej 1000 vizitorëve në nivel ditor dhe të njëjtin ta pajisin me: strobë të mbuluar me panel prej 60 m², stol të ngrohtë, frigorifer të ekspozuar për sallatë dhe sandviç, frigorifer për ngrirje, frigorifer për mirëmbajtje, frigorifer nga rosfraj, konvektomat, shporet me furrë dhe tavolina pune të nevojshme për funksionim të objektit (në fushën Deklaratë të bashkëngjitet si dëshmi deklarata për pëllim për shërbim të ushqimit dhe pijeve për numër maksimal prej 1000 vizitorëve në nivel ditor dhe deklarata për pëllim për pajisje të hapësirës me inventar të theksuar)

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

AFATE

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen në s'voni në afat prej 10 ditë nga dita e shpalljes, gjegjësisht duke filluar prej 29.03.2018 deri më 07.04.2018 deri në ora 16:00 përmes mënyrës elektronike në internet faqen: www.deloven-prostor.mk

Ankandin publik do të mbahet në formë elektronike në internet faqen në vijim www.deloven-prostor.mk Ankandin publik do të fillojë në terminin e dhënë në pasqyrën tabelore, për secilin hapësirë afariste veç e veç.

PROCEDURA

- Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton kompletimin e dokumenteve në pajtim me kushtet në shpallje, pas së cilës do të informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.
- Parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në mënyrë elektronike e miraton pjesëmarrjen në ankandin publik pas së cilës informohen përmes mënyrës elektronike me e-mail, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar, komisioni nuk do të miratohet pjesëmarrjen në ankandin publik për çka do të informojë përmes formës elektronike për shkak të refuzimit.
- Ankandi do të mbahet nëse pjesëmarrësi i plotësojë kushtet e dhëna në shpallje.
- Ankandin publik do të mbahet edhe në qoftë se thirrjes së shpalljes i përgjigjet vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në shpallje.
- Ankandin publik do të fillojë me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht ta rinis çmimin e hapësirës afariste. Ankandin publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës, gjatë së cilës nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jep ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jep ofertë e re.
- Ankandin publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk pranohet oferta, gjegjësisht nuk jep ofertë më të lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste ulet për 2% pas së cilës pjesëmarrësit në ankandin publik sërish do të kenë mundësinë të pranojnë gjegjësisht të rinis çmimin e hapësirës afariste.
- Nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të pesë minutave të detyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht jep ofertë më të lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jep ofertë e re.
- Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga vlera e përgjithshme e hapësirës afariste. Ujja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste gjatë ankandit mund të jetë më së shumti deri në 30% e çmimit të caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht shuma e përgjithshme e vlerësuar për qiranë mujore të objektit afaristë nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të parë, pavarësisht sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik. Ujja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të dytë, mund të jetë së paku deri në 30% nëse në ankandin publik është paraqitur një pjesëmarrës i interesuar, ndërsa nëse janë paraqitur dy ose më shumë pjesëmarrës, ujja mund të jetë më së shumti 50% të vlerës së caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht të shumës së përgjithshme të vlerësuar për qiranë mujore të hapësirës afariste.

- Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përlipon procesverbalin për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet deri tek pjesëmarrësit në ankandin publik.
- Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri tek Komisioni, i cili vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës.

- Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit më të lartë të përgjithshëm, i cili paraqet çmimin më të lartë për qira të objektit afarist.
- Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje të paguajë mjeteve deri tek Komisioni të dorëzohet dëshmi, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare do të aktivizohet ndërsa ofertuesi do të shpillohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurën për ankandin publik për jetësimin ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shpallimit të ndalesës.
- Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në afat prej 5 (pesë) ditëve pas pagesës së realizuar të një qiraje mujore në shumë të arritur të çmimit në procedurë për ankandin publik do të lidhet marrëveshje për qira të hapësirës afariste me ofertuesin më të volitshëm.
- Tatimi i vlerës së shtuar bie në barrë të ofertuesit më të volitshëm.
- Marrëveshja për qira të hapësirës afariste solemnizohet në Noter në barrë të ofertuesit më të volitshëm, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga lidhja e marrëveshjes.
- Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për qira.
- Subjektet fizike, subjektet juridike të themeluesit i subjektit juridik, i cili në cilëndo bazë ka obligime të papaguara ndaj BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, nuk mund të merr cilësinë e qiramarrësit në BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.
- Qiramarrësi pas lidhjes së Marrëveshjes për qira në afat prej 7 (shtatë) ditëve duhet të sigurojë Garanci për sigurim të obligimeve që do të dalin në bazë të marrëveshjes së nënshkruar:
 - Shumë të 3 qirave mujore (gjegjësisht të njëjtat të paguhen në xhiro llogarinë e qiradhënësit) ose
 - Garancia bankare në shumë prej 3 (tre) qirave mujore.
- Tatimi i vlerës së shtuar bie në barrë të ofertuesit më të volitshëm.
- Kjo shpallje do të publikohet në dy gazeta ditore të cilat publikohen në gjuhën maqedonase, ndërsa dalin së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes: NOVA MAKEDONJA dhe VEČER dhe një gazetë ditore i cili botohet në gjuhën të cilën e fasin së paku 20% e qytetarëve që fasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e cyletës të cilat dhe qytetin e Shkupit në cilin rajon gjendet hapësira afariste lëndë e publikimit, ndërsa deli së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes – KOHA.
- Të interesuar hapësirën afariste mund ta vizitojnë çdo ditë pune prej ora 10:00 deri në ora 14:00.
- Informata më të detajuara mund të merren në selinë e BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në bul. 8-mi Septemvri nr. 13, tel. 02/3089 600.

Personat për kontakt:
 Oliver Kitanovski 076/361176 e-mail: oliver.kitanovski@sborna.gov.mk (për çështje juridike)
 Lupo Tomovski 076/361184 e-mail: lupo.tomovski@gmail.com (për çështje të tjera)

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup
 Kryetar i komisionit për realizim të procedurave për ankandin publik
Roberta Teova



Në bazë të nenit 20 – g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14 199/14, 27/16 dhe 35/18), nenit 22, paragrafi 1, pika 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 de nenit 23, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27/16), nenit 77 – g të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 dhe 11/18), Institucioni Publik Komunal – Biblioteka "Tane Georgievski" – Kumanovë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 01/2018

Për punësim të 6 (gjashtë) personave – ofrues shërbimesh me kohë të pa caktuar në Institucionin Publik Komunal – Biblioteka "Tane Georgievski" – Kumanovë, për këto vende pune:

- Niveli G3, shifra KUL 03 04 G03 002, emërtimi i vendit të punës Bashkëpunëtor i veprimtarisë letrare, Bashkëpunëtor për veprimtari letrare, thirrja e vendit të punës Bashkëpunëtor në Shërbimin profesional – Njësia e të rriturve I (një) realizues. Kushtet e posaçme: Shkolla e mesme – drejtimi i gjimnazit ose Shkenca e letërsisë/Arsimi – 240 EKTS, shkalla VII/I, me ose pa përvojë pune. Orari i punës prej të hënës deri të premtën, 40 orë pune në javë, orari i punës prej 07:00 deri në 15:00. Vlera monetare neto e vendit të punës është: 13.991,00 denarë me arsim të mesëm dhe 19.630,00 denarë me arsim sipëror.
- Vërejtje: Në përputhje me planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018, vendi i punës është paraparë për maqedonas/e.
- Niveli D3, shifra KUL 03 04 D03 001, emërtimi i vendit të punës Bibliotekar, thirrja e vendit të punës Bibliotekar në Shërbimin profesional – Njësia e të rriturve I (një) realizues. Kushtet e posaçme: Historia e artit, Shkenca e letërsisë ose Arsimi – 240 EKTS, shkalla VII/I, me ose pa përvojë pune. Orari i punës prej të hënës deri të premtën, 40 orë pune në javë, orari i punës prej 07:00 deri 15:00. Vlera monetare neto e vendit të punës është: 19.630,00 denarë.
- Vërejtje: Në përputhje me planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018, vendi i punës është paraparë për maqedonas/e.
- Niveli G1, shifra KUL 03 04 G01 005, emërtimi i vendit të punës Ndihmës bibliotekist i pavarur, thirrja e vendit të punës Ndihmës bibliotekist i pavarur në Shërbimin profesional – Njësia e fëmijëve I (një) realizues. Kushtet e posaçme: Shkolla e mesme – drejtimi i gjimnazit ose ekonomisë ose Shkenca e letërsisë – 240 EKTS, shkalla VII/I, më së paku dy vite përvojë pune në profesion. Orari i punës prej të hënës deri të premtën prej 07:00 deri 14:00 ose prej 12:00 deri 19:00 dhe të shtunën prej 07:00 deri 15:00, 40 orë pune në javë. Vlera monetare neto e vendit të punës është: 13.991,00 denarë, me arsim të mesëm dhe 19.630,00 denarë me arsim sipëror.
- Vërejtje: Në përputhje me planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018, vendi i punës është paraparë për shqiptar/e.
- Niveli G2, shifra KUL 03 04 G02 005, emërtimi i vendit të punës Ndihmës bibliotekar për materialin e bibliotekës në lëmin e shkencës, kulturës dhe sociologjisë, thirrja e vendit të punës Ndihmës bibliotekar në Shërbimin profesional – Njësia e të rriturve I (një) realizues. Kushtet e posaçme: Shkolla e mesme – drejtimi i gjimnazit ose Shkenca e letërsisë, Bibliotekari, dokumentacion dhe sociologji – 240 EKTS, shkalla VII/I, me ose pa përvojë pune. Orari i punës prej të hënës deri të premtën prej 07:00 deri 14:00 ose prej 12:00 deri 19:00 dhe të shtunën prej 07:00 deri 15:00, 40 orë pune në javë. Vlera monetare neto e vendit të punës është: 13.991,00 denarë me arsim të mesëm dhe 19.630,00 denarë me arsim sipëror.
- Vërejtje: Në përputhje me planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018, vendi i punës është paraparë për shqiptar/e.
- Niveli G2, shifra KUL 03 04 G02 005, emërtimi i vendit të punës Ndihmës bibliotekar për materialin e bibliotekës në lëmin e shkencës, kulturës dhe sociologjisë, thirrja e vendit të punës Ndihmës bibliotekar në Shërbimin profesional – Njësia e fëmijëve I (një) realizues. Kushtet e posaçme: Shkolla e mesme – drejtimi i gjimnazit ose Shkenca e letërsisë, bibliotekari, dokumentacion dhe sociologji – 240 EKTS, shkalla VII/I, me ose pa përvojë pune. Orari i punës prej të hënës deri të premtën prej 07:00 deri 14:00 ose prej 12:00 deri 19:00 i dhe të shtunën prej 07:00 deri 15:00, 40 orë pune në javë. Vlera monetare neto e vendit të punës është: 13.991,00 denarë me arsim të mesëm dhe 19.630,00 denarë me arsim sipëror.
- Vërejtje: Në përputhje me planin vjetor për punësim gjatë vitit 2018, vendi i punës është paraparë për maqedonas/e.

Kushtet e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive ta njohë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të jetë me shëndet të plotë për vendin e punës dhe
- Me Aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Afati i paraqitjes së kandidatëve është 15 ditë, duke mos e llogaritur ditën e shpalljes në gazetë ditore. Kandidatët e interesuar duhet të parashtrorin Fletëparaqitje për punësim duke ia bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm, origjinal ose të verifikuar të noteri.

Zgjedhja do të bëhet në përputhje me nenin 23, paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune, varësisht nga kandidatët e paraqitur. Kandidatët, dokumentacionin komplet me të cilin dëshmohet se i plotësojnë kushtet e shpalljes duhet ta dorëzojnë në formë letrë, në arkivin e IPK – Biblioteka "Tane Georgievski" – Kumanovë, në adresën: rr. Revolucionit Popullor" nr. 1, Kumanovë, me shenjë "Për konkursin publik nr. 01/2018". Kontakt telefoni 071 444 954, Dejan Boshkov.

Dokumentacioni i dorëzuar pas skadimit të afatit dhe i pa kompletuar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga Komisioni.

IPK – Biblioteka "Tane Georgievski" – Kumanovë



REPUBLIKA E MAQEDONISË
 AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 20/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Demir Kapisë“ për vendet e punës në vijim:

- UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për kontabilitet dhe pagesa dhe administrim me 1 realizues(ë)

tatimet, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/I, shkencat ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kal palë/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, fr

Ndryshe, SHBA do të jetë vendi i nëntë dhe klubi i shtatë, ku ai stacionohet në një karrierë, që filloi në vendlindjen e tij, Malme të Suedisë, në vitin 1999, për të vijuar në Holandë, Itali, Spanjë, Francë, Angli dhe tani në Shtetet e Bashkuara. Me 730 ndeshje dhe 421 gola mbi supe, Ibrahimoviç do të vazhdojë rrugën e tij në MLS, në kërkim të më shumë shifrave të tilla

Në Los Anxhelos, midis Oqeanit Paqësor dhe Holivudit, Zlatan Ibrahimoviç do të vazhdojë të luajë "filmin" e tij në futboll. "Unë jam i lumtur për të luajtur në ekipin më të mirë në Amerikë. Ndihehem mirë. Ky është vendi më i mirë për mua. Unë kam shpresa të mëdha, kam shumë për të dhënë dhe shpresoj ta ndaj lumturinë e fitoreve. Unë kam nevojë për të luajtur", – pranoi sulmuesi suedez, pasi nënshkrimi i tij me LA Galaksi u bë zyrtar. Në moshën 36-vjeçare, Zlatan është në MLS, për të vazhduar aventurën e tij me topin. Ndryshe, SHBA do të jetë vendi i nëntë dhe klubi i shtatë, ku ai stacionohet në një karrierë, që filloi në vendlindjen e tij, Malme të Suedisë, në vitin 1999, për të vijuar në Holandë, Itali, Spanjë, Francë, Angli dhe tani në

7 VENDE DHE 9 KLUBE NË 19 VITE KARRIERË TË GJIGANDIT SUEDEZ

"IBRA GALAXY"



Shtetet e Bashkuara. Me 730 ndeshje dhe 421 gola mbi supe, Ibrahimoviç do të vazhdojë rrugën e tij në MLS, në kërkim të më shumë shifrave të tilla. Sulmuesi suedez ka fituar 31 tituj në karrierën e tij të gjatë, në mes të Malmo, Ajaks, Juventus, Inter, Barcelona, Milan, PSZH dhe Mançester Junajted. Vetëm te Malme dhe Juventus (dy tituj me bardhezinjtë, 2005 dhe 2006, janë anuluar nga "Calciopoli") mbeti pa trofe. Në pjesën tjetër të skuadrave, ku ka luajtur, e ka bërë këtë gjë rregullisht. Ai nuk e ka fituar Ligën e Kampionëve, por është lojtari i vetëm, i cili ka luajtur për shtatë ekipe të ndryshme në

këtë kompeticion, me Karev dhe Mutu, një nga tre lojtarët, të cilët kanë veshur fanellën e 7 klubeve në Kupat e Evropës. Askush nuk ka fituar më shumë tituj (13) në katër vende të ndryshme (Eredivisie, Serie A, La Liga dhe Ligue 1). Zlatan është një lojtar i shkëlqyeshëm i sfidave të nxehta mes skuadrave të të njëjtit qytet. Ai ka shënuar në Derbin e Madoninës mes Milanit dhe Interit, në "El Classico" (mes Real Madridit dhe Barcelonës), në derbin e Mançesterit (Junajted-Siti), në "Le Classique" të Francës (PSG-Marsej), në "de Klassieker" e Holandës (Ajaks-Fejenord) dhe në klasiken angleze, mes Liverpoolit

dhe Mançester Junajtedit. Ndryshe, Zlatan është shënuesi më i mirë në historinë e kombëtares suedeze (62 gola në 116 ndeshje). Ai ka qenë edhe golshënuesi më i mirë i Seria A (dy herë) dhe i Ligue 1 (tri herë). Në 19 sezonet që ai ka qenë në elitë, vetëm në tre prej tyre nuk e ka tejkaluar kuotën e 10 golave. Një "kafshë" konkurruese, plot cilësi dhe temperament, i cili kërkoi që "Kulla Eifel" të ripërtërihej për PSZH-në, që u ndesh me Guardiola në Barcelonë dhe ishte idhulli i Interit dhe Milanit, në pjesë të barabarta. Në përvojën e tij të fundit te Mançester Junajtedi, pavarësisht lëndimit të rëndë në

NUMRAT E KARRIERËS SË IBRAHIMOVIÇ

1. Malme 1999-2001: 47 ndeshje, 18 gola
2. Ajaks 2001-2005: 110 ndeshje, 48 gola, 3 tituj, një Kupë dhe një Superkupë Holande
3. Juventus 2004-2005: 92 ndeshje, 26 gola
4. Interi 2006-2009: 117 ndeshje, 66 gola, 3 tituj dhe 2 Superkupa Italiane
5. Barcelona 2009-2010: 46 ndeshje, 22 gola, një titull, dy Superkupa Spanjolle, një Superkupë Evropiane dhe një Botëror për Klubet
6. Milani 2010-2012: 85 ndeshje, 56 gola, një titull dhe një Superkupë Italiane
7. PSZH 2012-2016: 180 ndeshje, 156 gola, 4 tituj, 2 Kupa, 3 Kupa të Ligës dhe 3 Superkupa Franceze
8. Mançester J. 2016-2018: 53 ndeshje, 29 gola, një Kupë Lige, një Ligë Evropiane dhe një "Community Shield"

gju, ai la një shenjë në Premier Ligë me 29 gola, duke qenë një "djall i kuq" më shumë. Derisa, MLS do të jetë sfida e parafundit e Ibrahimoviç. "Është një vend tjetër, por unë jam i njëjti Zlatan", – përmbodhi ai. Sulmuesi suedez dëshiron më shumë. Ai nuk ka luajtur që nga 26 dhjetori (Mançester Junajted-Barnli), por është i etur t'i rikthehet fushës së blertë. Pas triumfit në katër nga pesë ligat kryesore evropiane, fitorja e titullit në MLS është qëllimi i tij. Shfaqja për të vazhdon.

Sterling shpërblehet me kontratë të re

Mançester Siti ka nisur bisedimet me Raheem Sterling për rinovimin e kontratës së tij përpara fundit të këtij sezoni, kanë bërë të ditur burime pranë "ESPN". Kontrata e re e Sterling ka qenë prej muaj objekt diskutimesh, por tani duket se palët do të arrijë marrëveshjen në muajin e ardhshëm, menjëherë pasi Siti të ketë garancinë matematikore të titullit në Premier Ligë. Sterling, i cili shkëlqeu edhe në dy ndeshjet miqësore me Anglinë pak ditë më parë, ka qenë një nga futbollistët më të mirë të Mançester Siti në këtë sezon me 20 gola dhe 11 asistime, duke e ndihmuar këtë skuadër që krahas titullit në Premier të garojë për të fituar trofeun në "Champions League". Sterling, i cili u ble për 60 milionë euro nga Liverpool në verën e vitit 2015, është një nga futbollistët më të preferuar nga trajneri i Mançester Siti, Pep



Guardiola. Ka qenë pikërisht spanjoli ai që ka dhënë urdhrin për rinovimin e marrëveshjes me 23-vjeçarin, pasi ajo aktuale skadon në vitin 2019. Sterling do të bëhet automatikisht një nga futbollistët më të paguar në "Etihad Stadium" dhe mendohet se do të marrë rreth 300 mijë euro në javë, aq sa Kevin De Bruine dhe David Silva, që rinovuan në fillim të vitit 2018. Futbollistët e tjerë të Siti që kanë rinovuar në muajit e fundit kanë qenë Fernandinho dhe Nikolas Otamendi.

Publicitet

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m² së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m². Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 20-g dhe 20-d të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), si dhe pëlqimit me shkrim për punësim për kohë të pacaktuar të punës në shkollat fillore nr. 12-12701/8 të datës 25.01.2018 të parashtruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM, si dhe Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në SHFKM "Risto Jurukov" Koçan nr. 02-223/1 të datës 26.10.2015, SHFKM "Risto Jurukov" Koçan publikon:

SHPALLJE

Për punësim të 1 (një) personi i për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim

- Mirëmbajtës të higjienës..... 1 (një) realizues
- Arsimit fillor ose arsim të mesëm
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari ditor i punës: 8 orë (në 2 ndërrime)
 - Orari javor i punës: 40 orë
 - Neto pagesa fillestare: 12.000, 00 den.

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përcaktuara me nenin 31 të Ligjit për nëpunës administrativ (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 48/15, 05/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në SHFKM "Risto Jurukov" Koçan nr. 02-223/1 të datës 26.10.2015.

Dokumentet e nevojshme për paraqitje: fletëparaqitje; certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se gjashtë muaj; diplomë/dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, vërtetim mjekësor se personi ka aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës; vërtetim se me vendin të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Dokumentet e parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 (dyzetepesë) ditë pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet e nevojshme, kandidatët duhet t'i parashtrorjnë në adresën: SHFKM "Risto Jurukov" Koçan, rr. "Lupço Santov" pn Koçan, personi për kontakt – Elizabeta Gjeorgieva, numri i telefonit 070/346-141.

SHFKM "Risto Jurukov" Koçan
Drejtore:
Elizabeta Gjeorgieva

SHPALLJE

Shitet tokë në Shkup, e cila gjendet ne PK 11432, Vendi quajtur SARAJ e regjistruar në Fletë pronësi nr. 12477 për KK Saraj, në pronësi të Beganoviq Rexhep.

Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

GATI 30 MILIONË EURO NË VIT

MURINJO E DO RONALDON TE MANÇESTERI

Ekipi anglez është shumë i vetëdijshëm se duke pasur në përbërje një yll si KR7, do të rimarrë rrugën e fitoreve dhe titujve. Murinjo e ka bërë tashmë të ditur se ka përgatitur 30 milionë euro në sezon për të marrë shërbimet e bashkatdhetarit të tij

Raportet mediatike thonë se Ronaldo vazhdon të jetë i irrituar me presidentin e Realit, Florentino Perez, i cili ka refuzuar të sanksionojë një kontratë të re për 33-vjeçarin. Dhe "Djajtë e Kuq" shpresojnë të përfitojnë nga kjo situatë, duke i ofruar yllit portugez një kontratë tronditëse, prej 30 milionë eurosh në vit, për t'u rikthyer në "Old Trafford". Pra, Kristiano Ronaldo është kthyer. Pas disa muajsh, në të

cilët portugezi dha shenjat se e kishte përfunduar moshën e tij të artë në futboll, tani është rishfaqur nga hiri i vet dhe është bërë sulmuesi vdekjeprurës, i cili i ka dhënë Real Madridit kaq shumë. Ekipi anglez është shumë i vetëdijshëm se duke pasur në përbërje një yll si KR7, do të rimarrë rrugën e fitoreve dhe titujve. Rivali i drejtpërdrejtë në Premier Ligë, Mançester Siti, është gjithëpërfshirës dhe Pep Guardiola



ka në mendje të nënshkruajë me një, ose dy yje në verë, për të materializuar një projekt të frikshëm. Për këtë arsye, në "Old Trafford" duan të kundërpërgjigjen. Ata janë të vetëdijshëm se Kristiano Ronaldo është i lodhur te Reali, ndër të tjera

për shkak se ka pretenduar për muaj rritje page, që kurrë nuk ka ardhur deri tani. Siç theksohet nga mjedisi i tij rrethues, lojtari është i zhgënjyer me Florentino Perez për mosmbështetje në problemet e tij me akuzat për evazion fiskal. Hoze

Murinjo e ka bërë tashmë të ditur se ka përgatitur 30 milionë euro në sezon për të marrë shërbimet e bashkatdhetarit të tij. Një ofertë, që e përmirëson pagën e tij aktuale. Por, pyetja është: a mundet Mançester Junajted të përballlet me një operacion të tillë? Përgjigja është e qartë: po. Si? Duke i thënë faleminderit "Chevrolet". Marka që paguan për markën e makinave, që është e vendosur të marrë një galaktikë në Mançester. "Chevrolet", sponsori kryesor i Manchester Junajtedit, bashkë me "Adidas", është i gatshëm të vendosë shumë para në tryezë, për aq kohë sa KR7 dëshiron të kthehet në atë që dikur ishte shtëpia e tij.

Publicitet



Juventus i bashkohet garës për Paulinjon

Juventus i është bashkuar garës për sulmuesin e Vasko de Gama, Paulinjo, sipas "Calciomercato.com". 17-vjeçari ka dalë si një nga perspektivat më të nxehta të Amerikës së Jugut, me Barcelonën, Real Madridin dhe PSZH-në, që thuhet se janë të etur për shërbimet e tij, gjithashtu. Paulinjo ka një klauzolë lirimi prej 30 milionë eurosh, e cila mund të vihet në zbatim, nëse lojtari vazhdon trajektoren e tanishme. Drejtorët e Juventusit, Beppe Marotta dhe Fabio Paratici, e kanë identifikuar të riun e Vasko de Gama si një objektiv të mundshëm, përpara merkatos së transferimit të kësaj vere. Bardhezinjtë janë gjithmonë në kërkim të talentëve më të ndritshëm të futbollit botëror dhe këtë vit nuk do të jetë ndryshe. Në të vërtetë, sulmuesi 17-vjeçar po shfaqet si një nga lojtarët më emocionues në Amerikën e Jugut. I lindur në Rio de Zhaneiro, Paulinjo është duke tërhequr vëmendjen e mjaft klubeve të njohura evropiane. Pasi humbi betejat e nënshkrimit me lojtarë të tillë brazilianë, si Gabriel Barbosa, Gabriel Jesus dhe Vinicius Junior, në vitet e fundit, Juve është tani e kujdesshme ndaj rivalitetit, me të cilin do të përballlet, edhe pse do të vazhdojë ta monitorojë situatën e Paulinjo.

Relaksohu me 100GB internet me Vip Postpejd



HUAWEI
P9 lite mini
189 den./muaj
co Vip Neo M



HUAWEI
P10 lite
399 den./muaj
co Vip Neo M

Zgjedhni Vip Neo, aktivizoni faturë elektronike dhe fitoni 100GB internet shtesë për surfatje të relaksuar deri në fund të vitit. Me këto 100GB internet shtesë do të mund të surfoni pa ndërprerje gjithmonë kur do ta keni shfrytëzuar trafikun e internetit mujor të përfshirë në modelin Tuaj tarifor.

Shpejtoni, sasi të telefonave janë të kufizuara. Pagesa e telefonit në këste bëhet përmes kredisë konsumatore me 0% interes në 24 këste në bashkëpunim me NLB Banka dhe vlen për persona fizik.

Promocioni me 100GB internet vlen për shfrytëzues të ri dhe ekzistues, me zgjedhjen e modelit tarifor Vip Neo M ose Vip Neo L me lidhjen e kontratës së re ose ripërtirje të kontratës në 24 muaj. 100GB në promocion mund të shfrytëzohen deri më 31.12.2018.

Për më shumë informata, vizitoni faqen tonë të internetit www.vip.mk ose telefononi në 077 1234.

Më tepër për ju **vip**

DASHI 21. mars - 20. prill
Cjithçka duket e qetë, sot nuk do të ketë grindje dhe diskutime me partnerin/en. Megjithatë Marsi është duke u përpjekur për t'ju vendosur shkopinë në rrota. Beqarët do të kenë shumë mundësi për të bërë kontakte të reja me njerëz interesantë. Planetët ju japin mundësi të jashtëzakonshme për të përmirësuar gjendjen tuaj ekonomike. Kapini ato në ajër.

DEMI 21. prill - 21. maj
Sot, çiftet që kanë pasur probleme dhe diskutime, më në fund do të gjejnë një marrëveshje ose do të shkatërrojnë gjithçka. Nuk do të ketë kushte gjysma për askënd. Zemrat e vetmuara do të jenë gati të bien në dashuri, do të mirëpresin njohjet e reja. Këshilla e një mikru do t'ju ndihmojë të gjeni një rrugë që do t'ju japë shumë kënaqësi.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Një ditë bashkëpunimi për shumë të lindur të binjakëve që kanë përjetuar tensione në çift. Venusi ju jep momente të gëzueshme! Beqarët do të jetojnë veçanërisht emocione të bukura, shumë prej tyre do të gjejnë shpirtin e tyre binjak. Një ditë e plotë dhe intensive ju pret në punë, do të ketë shumë nryje që do të zgjidhen, por me Marsin favorit gjithçka do të jetë mirë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Mungesa e dialogut mund të shkaktojë pakënaqësi edhe në mesin e çifteve më solidë. Shmangni ndryshimin dhe përpikuni të zgjidhni gjithçka me diplomaci. Nëse jeni vetëm, kini besim në mundësitë për takime që do t'ju paraqiten sot! Ata që kërkojnë punë, sot do të kenë mundësi për të realizuar përvoja të reja.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Çiftet do të jetojnë një ditë të mbushur me romancë. Harmonia do të mbretërojë supremisht dhe do të jeni shumë të lumtur me ndjenjat e bukura që po përjetoni. Megjithatë, ata që janë vetëm, mund të llogarisin në disa raste për të takuar njerëz stimules dhe interesantë. Duke marrë parasysh propozimet e reja, vlerësoni të gjitha mundësitë e mundshme para se të vendosni.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Do të jetë një e enjte e bukur për ata që lindin nën shenjë të Virgjërshës. Ata që janë në çift për një kohë të gjatë do të gëzojnë një marrëveshje përyjet, të shoqëruar nga shpërthime të mëdha të pasionit. Yjet nuk do jenë favorizues për beqarët që duan të përjetojnë plotësisht gëzimet e dashurisë. Sot shumë nga ju do të jenë në gjendje të mbledhin konfirmime interesante rreth profesionit.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Marsi në opozitë mund të krijojë keqkuptime edhe në marrëdhëniet e gjata, por për fat të mirë do të jetë vetëm pak re në horizont! Fashionistë dhe joshës, beqarët do të adhurohen shumë, por dikush do të tërhiqet nga pamja intriguese nga ana tjetër! Më mirë për të shmangur polemikat me kolegët, kontrolloni veten tuaj në mënyrë që të mos keqësoni gjërat.


AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Trego veten të adaptueshëm, brenda kufijve që mund të pranoni, edhe nëse diçka nuk do të shkojë sipas dëshirës. Krenaria juaj do të vihet në provë, por dashuria do të jetë më e fortë se çdo gjë! Beqarët do të duhet të bëjnë një ndryshim të vogël në një projekt. Në punën e sotme do të bëni kaq shumë përpjekje që ju të meritoni sukses! Çdo qëllim do të duket i lehtë për t'u arritur.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Ju do të menaxhoni çdo detyrë me aftësi dhe siguri, duke zgjidhur edhe pyetjet më të mërzitshme. Në jetën private, mos kërkon dikë tjetër për atë që ende mund të jetoni me partnerin/en tuaj. Beqarët do të duhet të tregohen të hapur nëse duan të bëjnë për vete një person. Shumë projekte marrin formë në punë. Ambicjet tuaja vijnë të parat dhe më në fund mund t'i realizoni ato.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Hëna ju bën që të reflektoni për të pasur mendime të dyta, ndryshime mendimi dhe pikëpamje të reja. Ndoshta ju keni mëkatuar me besim të tepruar me të dashurit tuaj dhe tani ndjeni nevojën për të rikthyer hapat pas. Beqarët do të duhet të përipien disi nëse duan të ndryshojnë statusin. Ndoshta do t'ju duhet të rishikoni objektivat që kanë të bëjnë me qëllimet që duhet të arrini në punë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Lumturi në dashuri, ju do të rinovoni besimin tek i dashuri/a dhe madje edhe nëse do të ketë ndërhyrje të vogla ata nuk do të jenë aq seriozë sa të shqetësojnë balancën sentimentale. Beqarët do të bëjnë takime shumë të këndshme gati për të ofruar perspektiva të shkëlqyera në të ardhmen. Falë një qielli miqësor, sot do të jetë një ditë e mirë për t'i kushtuar veten biznesit dhe biznesit.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Një moment astral, i gëzuar dhe pozitiv, i denjë për program të veçanta. Dashuria është në krye të mendimeve tuaja dhe interesave tuaja. Beqarët nuk mund ta përjashtojnë dashurinë e papritur, ose ndonjë kthim nga e kaluara që troket në të tashmen. Profesionalisht do të keni sukses.



KOHA	HIT I KËNGËTARIT NË FOTO	ELEMENT KIMIK (N)	KOHA	LBERT AJNSHTAJNI	AZOTI	PËR (LAT.) KËNGËTAR AMERIKAN ('LOCKED UP')	KUSHËRI, FAREFIS
LANTANI			MALLKIMI KISHTAR I DIKURSHËM				
NJË KONTINENT					BUJTINË FUTBOLLISTI ANGLEZ, RUNI		
E TËRHEQ, MAGJEPS				KËNGËTARI AMERIKAN, STIVI ILM ME XHEJSEN STATAM			
LABINOT TAHIRI			ISH BOKSIERI, NORTON UJDHESË NË MALEZI			INTERNATIONAL BAR ASSOCIATION LOJA ME 64 FUSHA	
AUSTRIA		SOFTUER KOMPIMIMI FAJLLASH MONEDHA SHQIPTARE				ORGAN DREJTUES USHTARAK ZGAVËR E MADHE, SHPELLE	
KOHA	KËNGËTAR KOSOVAR BIZMUTI						
KRYEQYTETI I ZVICRES					E GJUAN Ë		SUEDIA
SHKO			QË TË ËPUT, KAPITES, RRASKAPITES				

ZGJIDHJET: ENOK, RËRA, LIQEN, KIST, KETI, LL, N, E, DHË, PRO, LA, ANATEMA, AZIA, KONAK, JOSH, UONDER, LT, KEN, IBA, A, ARJ, SHTAB, LUAN HAJRA, BERN, E HEDH, IK, KËPUTËS.

Shumë i lehtë *Sudoku* **mesatar**

			7				9		6					1	8	9
		5	9	3		7					8				3	
							6	1	3							
	6			9	7		2			4		6		5		
4			3		1			7					7	4	1	
	9		8	5			3			2	1			6		
2	4								9	6		5	1	2		
	8		7		2	9				3		6				5
3			6										9			

Shumë i lehtë: 831674259, 625913478, 974285361, 163497825, 458321697, 792856134, 247139586, 586742913, 319568742. Mesatar: 652734189, 719856234, 384921756, 143269578, 596387412, 827145693, 968512347, 431678925, 275493861.

VEPRA E VAN GOGH SHITET MILIONA EURO NË PARIS

Një peisazh i impresionistit holandez Vincent Van Gogh i shfaqur në Paris të mërkurën pritet të shitet nga 3 deri në 5 milionë euro kur të dalë në ankand në muajin qershor. Kjo do të jetë hera e parë që një vepër e Van Gogh shitet në Francë në më shumë se dy dekada. E realizuar në 1988-shin, në vitet e para të karrierës së artistit, piktura u frymëzua nga jeta në fshatrat rreth Hagës, ku Van Gogh kaloi një kohë të shkurtër, por shumë të rëndësishme për krijimin e stilit të tij artistik. Organizatorët e ankandit thonë se rëndësia e pikturës theksohet nga fakti se ajo kishte qëndruar e varur për 25 vjet, në muzetë me prestigje të botës. Si peisazhi i vetëm i realizuar nga artisti holandez gjatë kësaj periudhe në karrierën e tij, ajo përmban shumë elementë që më vonë do të bëhe-



shin simbole të punës së tij, përfshirë qiejt e veshur nga retë. Në një letër për vëllain e tij Theo, Van Gogh tregonte se sa shumë ishte impresionuar nga gratë

fshatare, të cilat pasqyrohen tekta lëvizin nëpër arat me kokat e mbuluara me shami. Ankandi do të zhvillohet në 4 qershor në kryeqytetin francez.



Dua Lipa në ballinën e British GQ: S'mund të gabojnë 1 miliard njerëz

Numri i ardhshëm i revistës britanike British GQ do ta ketë në ballinë këngëtarën shqiptare Dua Lipa. Ylli i hitit "New Rules" që ka marrë mbi 1 miliard klikime në YouTube ka bërë edhe një intervistë ekskluzive për këtë revistë, për të cilën thotë se, "1 miliard njerëz nuk mund të gabojnë". Ky numër me Dua Lipën në ballinën e GQ do të publikohet më 5 prill. Në një postim në Facebook këngëtarja me famë botërore ka falënderuar ekipin e kësaj reviste për mbështetjen që i ka dhënë që nga dita e parë.

Revista Playboy mbyll llogarinë në Facebook

Playboy ka njoftuar zyrtarisht se ka mbyllur llogarinë e saj zyrtare në Facebook. Ky vendim i revistës lifestyle për meshkuj vjen pas skandalit të privatësisë që ka përfshirë gjigandin Facebook së fundmi. Me 25 milionë ndjekës në këtë rrjet social, Playboy i është bashkuar nisimën globale për të mbyllur llogarinë në Facebook. "Lajmet e kohëve të fundit rreth keqadministrimit të dyshuar të të dhënave të përdoruesve në Facebook, kanë forcuar vendimin tonë për të pezul-

luar aktivitetin në këtë platformë për momentin", – njofton Playboy. Kompania thotë gjithashtu se nuk dëshiron të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të mundshme të privatësisë së 25 milionë fansave të saj në faqe të ndryshme të Playboy në Facebook. Ndërkohë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka nisur një hetim nga Komisioni Federal Amerikan i Tregtisë lidhur me praktikën e kontrollit të privatësisë nga Facebook.



C-CLASS I MERCEDES DO TË JU LE PA FJALË

Mercedes e ka rifreskuar të gjithë gamën e veturave kur bëhet fjalë për modelin "C-Class". Në panairin e veturave në Geneva, prezantoi modelin e rifreskuar të "C-Class", ndërsa ky prodhues gjerman në New York e prezantoi modelin kabriolet, duke e përfshirë edhe të fuqishmin C43 AMG. Të gjitha modelet e reja tani posedojnë drita LED, kanë ekran infotainment me madhësi 10,25 inch. Versioni Coupe dhe kabrioleti kanë motor turbo 2.0, i cili zhvillon 255 kuaj

fuqi (190 kWh), më saktësisht 14 kuaj fuqi më shumë se sa versioni i kaluar, gjithashtu ky lloj i Coupe arrin në 100 km në orë vetëm për 6 sekonda. Modeli C43 AMG vjen me një motor bi-turbo 3.0 V6 që ka 385 kuaj fuqi, ose 23 kuaj fuqi më shumë se versioni i mëparshëm. Ajo gjithashtu ka një transmetim automatik me 9 shpejtësi dhe me makinë të katër rrota.



1474 – Duka Sigismund van Tirol ndërpret kontaktet me Zvicrën.

1492 – Mbreti Ferdinand dhe Mbretëresha Isabella nënshkruajnë marrëveshje për dëbimin e hebrenjve nga Spanja.

1814 – Britania dhe aleatët e saj marshojnë në Paris pasi të mundin Napoleonin.

1822 – Kongresi ka bashkuar Floridën Lindore dhe Perëndimore në një territor.

1856 – Rusia nënshkruan Marrëveshjen e Parisit për Paqë, duke përfunduar Luftën e Krimesë.

1867 – SHBA blejnë Alaskën nga Rusia për \$7,200,000 (2 cent për ari)

1909 – Hapet Ura Queensboro që bashkon Manhattan dhe Queens.

1919 – Ushtria belge okupon Dizeldorf.

1925 – Stalini mbështet të drejtat e jo serbëve jugosllav.

2006 – Marcos Pontes është astronauti i parë brazilian në hapësirë

KALENDARI HISTORIK 30 MARS



A E DINI SE...

Elefantët përdorin veshët për të rregulluar temperaturën e trupit.



Monedhat e hedhura në Fontanën Trevi të Italisë përdoren për bamirësi.



Një copë letër nuk mund të palohet më shumë se shtatë herë.



Vajza e pispillosme

Vajza u vesh u pispillos..
Babi : ku po iken moj bije tani ne gjysme te nates..?
Vajza : ne banjo babi me duhet urgjentisht nje foto e re profili.

Plas sherri!

Ishin dy shokë dhe po shihnin një film...
Shoku i thotë shokut mbasi mbaron filmi un e kam parë këtë film..
Dhe aty plas sherri!
Kur u kthyen nga shkolla,shikuan që dikush ishte në shtëpi.
I thot shoku-shokut i ke pi ilaqet?
Ata jetuan të lumtur, që nga ajo ditë kërkohen nga policia...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Mrekullia nuk është në kundërshtim me natyrën, por vetëm në kundërshtim me atë që dimë për natyrën.

Shën Augustini